



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:240246  
Datë: 22.09.2023  
Numri i dokumentit: 04709388

PKR.nr.47/2022

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE P. DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, në përbërje nga gjyqtarët: Violeta Husaj-Rugova kryetare e trupit gjykues, Shaqë Curri dhe Leon Përlaska anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj në çështjen penale ndaj të akuzuarve M.Xh., I.M., E.Z., M.I.dhe J.A.për shkak të veprës penale në bashkëveprim dhe në vazhdimësi kanë kryer vepër penale “Trafikimi me njerëz” nga neni 165 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, i akuzuari M.I.për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe vepër penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe i akuzuari I.M. për shkak të veprës penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe vepër penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/I.224/2021 të datës 28.03.2022, pas shqyrtimit gjyqësorë mbyllur për publikun, të mbajtur me dt.21.11.2022, 16.01.2023, 01.02.2023, 14.02.2023, 21.03.2023, 22.03.2023, 24.04.2023, 08.06.2023, 09.06.2023, 17.07.2023, 19.07.2023, të mbajtur në praninë e prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj, të akuzuarës M.Xh. dhe mbrojtësi i saj sipas detyrës zyrtare av.Osman Lajqi, të akuzuarit I.M. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Sylë Lokaj, të akuzuarës E.Z. dhe mbrojtëses së saj sipas detyrës zyrtare av.Majlinda Kollçaku Lëbusha, të akuzuarit M.I.dhe mbrojtësi të tij sipas detyrës zyrtare av.Muhamet Ibraj, të akuzuarit J.A.dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Arbër Rustaj si dhe mbrojtësja e viktimave Zymreta Bashiq, palës së dëmtuar K.G.(e njëjta mungoj në dy seancat e fundit), me datë 24.07.2023 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 22.09.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**1.M. Xh.** e lindur me datë ..... në P., ku edhe J., rr. “N. V.” P. n., nga babai R. dhe nëna Z. e gjinisë G., e pa martuar, nën e .. fëmije, ka të kryer shkollën fillore, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., gjendet nën masën e arrestit shtëpiak DKR.PP.nr.186/2021 shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

**2.I.M.** i lindur me datë ..... në D., me banim në f. I., K. D., nga babai I. dhe nëna G. e gjinisë B., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., me numër të telefonit .../...-... gjendet nën masën e paraburgimit DKR.PP.nr.186/2021 shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**3.E.Z.** e lindur me datë ..... në P., ku edhe J., L. “J.”, rr. “M. B.”, h. ..., nr., kati .., nga babai I. dhe nëna H. e gjinisë K., e divorcuar, nënë e ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, e pa punë, e gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., gjendet nën masën e arrestit shtëpiak DKR.PP.nr.186/2021 shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

**4.M.I.** i lindur me datë ..... në D., me banim në f. I., K. D., nga babai A. dhe nëna F. e gjinisë M., i martuar, babë i .. fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., me numër të telefonit .../...-... gjendet nën masën e paraburgimit DKR.PP.nr.186/2021 shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**5.J.A.** i lindur me datë ..... në D., me banim në f. I., K. D., nga babai T. dhe nëna Sh. e gjinisë I., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion moler-gipser, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., me numër të telefonit .../...-... gjendet nën masën e paraburgimit DKR.PP.nr.186/2021 shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## JANË FAJTOR

**Të akuzuarit M.Xh., I.M., E.Z., M.I.dhe J. A.,**

### **Për shkak se:**

I.Nga data 12.10.2021, e në vazhdimësi gjerë me datën 16.10.2021, në vilat “G. ” në f. R. K. P., në bashkëveprim marrin pjesë në trafikimin e njerëzve ndaj të dëmtuarës K. G., duke e mashtruar, strehuar dhe duke e vënë në lajthim me qëllim të shfrytëzimit seksual për përfitime materiale në atë mënyrë që, fillimisht i pandehuri J. A. me dt. 12.10.2021 duke e mashtruar të dëmtuarën me pretendimin se kinse do ta marr për bashkëshorte, të njëjtën e vë në lajthim duke e marr në vendbanimin e saj në f. Ll. K. M. përderisa ishte i shoqëruar me dëshmitarin A.M.me veturën e tij xhip “N. ”, me ç’rast e dërgojnë në një vilë në M.dhe pasi që i pandehuri J. kryen marrëdhënie seksuale me të, të njëjtën ia vë në dispozicion edhe dëshmitarin A.M.pasi që paraprakisht e kishte paguar vilen i pandehuri J., e që më pas komunikon me të pandehurin I.M., me qëllim të strehimit të të dëmtuarës tek vilat “G. .”, për shfrytëzim seksual me qëllim të përfitimit material, ku paraprakisht ishin të vendosur të pandehurit I.M., E.Z., M. Xh. dhe M.I., e që me tu takuar që të gjithë përveç të pandehurës M. e cila kishte mbet në vila, në vendin e ashtuquajtur “H. K.”, në f. R. K. P., fillimisht nga i pandehuri I. sigurohen tableta qetësimi “Lexilium” për të dëmtuarën K. e cila tani më ishte në veturën e të pandehurit në fjalë dhe me të tjerët e më pas te njëjtën e dërgojnë tek vilat, ku nga aty e njëjta del duke e shoqëruar vetëm i pandehuri M., ku ky i fundit kërkon nga të pandehurat M. dhe E. që të sigurojnë klientë të ndryshëm nga nr. tel. ...-...-..., me ç rast këto të fundit e detyrojnë të dëmtuarën që të ketë marrëdhënie seksuale me pagesë me persona të ndryshëm, e në raste të caktuara edhe marrëdhënie seksuale në grup së bashku me të pandehurën M., në këmbim të të hollave në shuma prej 50 deri në 200€, të cilat janë dorëzuar tek të pandehurit M. dhe I., e më pas me të njëjtat janë bërë pagesat e vilave, ushqimit dhe transportit me kompaninë “L. T.” si dhe për nevoja personale, e që gjatë kësaj kohe i pandehuri J. komunikon nga numri i tij ...-.../... në telefonin i cili e kishte në posedim i pandehuri M., duke i udhëzuar me fjalët: *“diqka mane naj dit bone naj pare e qoni en mA.shev”* ndërsa me datë 16.10.2021 pasi që i pandehuri I. e shfrytëzon seksuA.sht të dëmtuarën K., kjo e fundit merr kërcënime nga e pandehura E. e cila ishte në lidhje me të lartcekurin, dhe e njëjta duke mos gjetur zgjidhje konsumon 20 (njëzetë) tableta të qetësimit, ku si pasojë i keqësohet gjendja shëndetësore

dhe po atë ditë i pandehuri M., së bashku me të miturat A.B.dhe J. K. si dhe me dëshmitarin P. E. si vozitës i kompanisë së lartcekur, e dërgojnë tek “M. T.” në M.duke e vendosur në një dhomë, ku më pas shërbimi i këtij moteli thërret kompaninë e sipërshtënuar që të kthehet e ta merr te dëmtuarën pasi nuk kishte arritur ta identifikonte, me ç’ rast e dëmtuara, më pas dërgohet tek shtëpia me një taksì privat, ku nga ana e familjarëve të saj dërgohet për kontroll mjekësore, meqenëse gjendja e saj psiko-fizike ka qenë jo e mirë.

-Me çka në bashkëveprim dhe në vazhdimësi kanë kryer veprë penale “trafikim me njerëz nga neni 165 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

### **I akuzuari M.I.**

#### **Për shkak se :**

II. Më parë dhe gjerë me datë 25.10.2021, rreth orës 14:00, në vilat “G. .” në f. R. K. P., i pandehuri në kundërshtim me nenin 4 par. 1 pika 1.1.9 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë: një pistoletë të llojit “B.....”, me nr. serik ....., kalibër . mm P..... dhe një karikator pa municion, në atë mënyrë që, ditën kritike pas një kontrolli të ushtruar nga ana e policisë sipas urdhrit të GJPP, i pandehuri në vendin e lartcekur dorëzon armën me të dhënat si më lartë, e cila ishte duke u mbajtur në pronësi në mënyrë të paautorizuar nga i lartcekuri.

- Me çka ka kryer veprë penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

III. Më parë dhe gjerë me datë 25.10.2021, rreth orës 14:00, në vilat “G. .” në f. R. K. P., përdor armën me gaz të lartcekur në kundërshtim me nenin 4 par.1 pika 1.1.9 (Ligji nr.05/L-022), në atë mënyrë që, përderisa i pandehuri ishte duke qëndruar në vendin e lartcekur, i njëjti ka përdorë armën duke shtëne me te njëjtën, me ç’rast nga ana e policisë gjatë kontrollit sipas urdhrit të GJPP janë gjetur gëzhoja të armës së lartcekur përgjatë oborrit të shtruar me kubëza si dhe përball hyrjes së vilave, ashtu që, 2 (dy) gëzhoja janë gjetur në veturën me targa ..-...-.. sipas dëshmisë #2, 5 (pesë) gëzhoja në hapësirën e jashtme të motelit sipas dëshmisë #5,6,7,8,9, si dhe 14 (katërmëdhjetë) gëzhoja brenda vilës nr. . sipas dëshmisë #11,12,13, 4 (katër) gëzhoja sipas dëshmisë #14,15,16 dhe 2 (dy) gëzhoja sipas dëshmisë #18,19, më pastaj 2 (dy) gëzhoja sipas dëshmisë D#25 tek hyrja e vilës nr. ., dhe një (1) gëzhojë tek banjo e vilës nr. . sipas dëshmisë #26 dhe kutia e armës sipas dëshmisë D#28 dhoma nr. ..

- Me çka ka kryer veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

### **I akuzuari I.M.**

#### **Për shkak se:**

IV. Më parë dhe gjerë me datë 25.10.2021, rreth orës 14:00, në vilat “G. .” në f. R. K. P., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë: një pistoletë të llojit “Ceska Zbrojevka”, kA.bër 7.65mm, me nr. serik ..... së bashku me një karikator të zbrazët, në atë mënyrë që, ditën kritike pas një kontrolli te ushtruar nga ana e policisë sipas urdhrit të GJPP, i pandehuri përderisa ishte duke qëndruar në vilën nr. . nga aty me të vërejtur prezencën e Policisë në oborrin e vilave në

fjalë, i njëjti hedh nga dritarja pistoletën cal. . mm, e cila ishte duke u mbajtur në pronësi në mënyrë të paautorizuar nga këtu i pandehuri.

- Me çka ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

V. Më parë dhe gjerë me datë 25.10.2021, rreth orës 14:00, në vilat “G. .” në f. R. K. P., përdor armën e lartcekur në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit për Armë (Ligji nr.05/L-022), në atë mënyrë që, përderisa i pandehuri ishte duke qëndruar në vendin e lartcekur, i njëjti ka përdorë armën duke shtënë me te njëjtën, me ç’rast nga ana e policisë gjatë kontrollit sipas urdhrit të GJPP janë gjetur gëzhoja të armës së lartcekur përgjatë oborrit të shtruar me kubëza si dhe përball hyrjes së vilave, ashtu që, dy gëzhoja janë gjetur sipas dëshmisë #4 dhe #21 tek hapësira e jashtme e motelit, një gëzhojë brenda vilës nr. . sipas dëshmisë #17, një gëzhojë në hapësirën e jashtme të motelit mes vilës . dhe . sipas dëshmisë #22.

- Me çka ka kryer veprën penale “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.

Ashtu që Gjykata në bazë të nenit 7, 17, 21, 22, 38, 39, 40,42,43, 69, 70,71,72, nenit 165 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, neni 366 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 367 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarit i

## **G J Y K O N**

### **1.Të akuzuaren M. Xh.**

Për veprën penale si në dispozitivin e parë (I)të cekur si më lartë, i përcakton dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri ) vite, dhe dënimin me gjobë në shumën prej 500€ (pesëqind euro).

Në dënimin me burg të akuzuarës i llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 25.10.2021 e gjerë me dt. 15.07.2022, koha e kaluar në paraburgim nga dt.01.02.2023 e gjer me dt. 28.04.2023 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 28.04.2023 e gjer me dt.27.06.2023.

Dënimi me burgim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në qofte se e akuzuara nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 50€ (pesëdhjetë) në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **2.Të akuzuarin I.M.**

Për veprën penale si në dispozitivin e parë (I)të cekur më lartë i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej 1.000€ (njëmijë euro).

Për vepër penale si në dispozitivin e katërt (IV) të cekur më lart i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 1.000€ (njëmijë euro).

Për vepër penale si në dispozitivin e pestë (V) të cekur më lart i shqiptohet dënim me burgim 1 (një) vit e 3 (tre) muaj.

Të akuzuarit I.M. i shqiptohet dënim UNIK me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite e 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.000 € (dymijë euro).

Në dënimin me burg i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.25.10.2021 e tutje.

Të akuzuarit i konfiskohet një pistoletë të llojit “C. Z.”, kalibër ....mm, me nr. serik ..... së bashku me një karikator dhe pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit e njëjta do të shkatërrohet.

Dënimi me burgim do të ekzekutohet menjëherë pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në qofte se i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron të paguan dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 100 € (një qind euro), nën emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100€ (një qind euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€(pesëdhjete euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### 3. Të akuzuaren **E.Z.**

Për vepër penale si në dispozitivin e parë (I) të cekur më lart i përcakton dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, dhe dënimin me gjobë në shumën prej 500€ (pesë qind euro).

Në dënimin me burg i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.25.10.2021 e gjer me dt.23.11.2021 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.24.11.2021 e gjer me dt.15.07.2022.

Dënimi me burgim do të ekzekutohet menjëherë pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në qofte se e akuzuara nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 50€ (pesëdhjetë) në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

#### 4. Të akuzuarin **M.I.**

Për vepër penale si në dispozitivin e parë (I) të cekur më lart i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 1.000€ (njëmijë euro).

Për vepër penale si në dispozitivin e dytë (II) të cekur më lartë i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 1.000€ (njëmijë euro).

Për vepër penale si në dispozitivin e tretë (III) të cekur më lart i shqiptohet dënim me burgim 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj,

Të akuzuarit M.I. i shqiptohet dënim UNIK me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vite, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.000 € (dymijë euro),

Në dënimin me burg i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 25.10.2021 e tutje.

Dënimi me burgim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit i konfiskohet një pistoletë pistoletë të llojit “B.....”, me nr. serik .....-....., kalibër . mm ..... dhe një karikator, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen.

Në qofte se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 100 € (një qind euro), nën emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100€ (një qind euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjete euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

#### 5. Të akuzuarin **J. A.**

Për vepër penale si në dispozitivin e parë (I) të cekur më lart, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, dhe dënim me gjobë në shumën prej 1.000€ (njëmijë euro).

Në dënimin me burg i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.26.10.2021 e tutje.

Dënimi me burgim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 (tre) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në qofte se i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

Oligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 100 € (një qind euro), nën emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100€ (një qind euro), si dhe

në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 50€(pesëdhjete euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-Pala e dëmtuara K.G. nga f. Ll. K. M.për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Të akuzuarve M.I., I.M. dhe J.A.me dt.24.07.2023 me shpalljen së aktgjykimit i është vazhduar masa e paraburgimit me aktvendim të veçantë PKR.nr.47/22.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore Departamenti i Krimeve të rënda në P., ka ngritur aktakuzën PP/I.224/2021 të datës 28.03.2022, ndaj të akuzuarve M.Xh., I.M., E.Z., M.I.dhe J.A.për shkak të veprës penale në bashkëveprim dhe në vazhdimësi kanë kryer vepër penale “Trafikimi me njerëz” nga neni 165 par.3 lidhur me par. 1 dhe nenin 77 të KPRK-së, i akuzuari M.I.për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe vepër penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe i akuzuari I.M. për shkak të veprës penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe vepër penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtim gjyqësorë të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre konform nenit 323 të KPPRK-së. Të akuzuarit secili veç e veç kanë deklaruar se i kanë kuptuar të drejtat e tyre dhe kanë kuptuar edhe aktakuzën, e lidhur me fajësinë kanë deklaruar se i kanë të qarta pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe secili vep e veç u deklaruan se nuk e pranojnë fajësinë për veprat penale që u vihet në baërrë sipas aktakuzës Trafikimi me njerëz” nga neni 165 par.3 lidhur me par. 1 dhe nenin 77 të KPRK-së, në barrë dhe pas kësaj gjykata ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor me procedurën e provave. I akuzuari I.M. ka deklaruar se nuk e pranon fajësin për vepër penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së. Ndërsa i akuzuari M.I.ka pranuar fajësin për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe vepër penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së. I akuzuari I.M. ka pranuar fajësinë për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me veprën penale të cilat të akuzuarit M.I.dhe I.M. e pranuan fajësinë prokurori dhe mbrojtësit e tyre kanë deklaruar se pajtohen me pranimin e fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit M.I.për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe vepër penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe të akuzuarit I.M. për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK- dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hüdhe të aktakuzës konform nenit 248 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar më procedurën e provave për veprat për të cilat të akuzuarit nuk e pranuan fajësinë, Gjykata fillimisht ka dëgjuar fjalën hyrëse dhe më pas ka administruar provat.

Në shqyrtim gjyqësorë është dëgjuar e dëmtuara në cilësi të dëshmitares K.G., janë dëgjuar dëshmitarët: H.J.A.M., H.S., M.S., B.T., A.M., R.B., P.E., P.T., L.G., N.Gj.A.

Janë administruar këto prova materiale siç janë:

- Deklarata e të dëmtuarës K.G.j të dhëna në stacion policor me datë 22.10.2021 si dhe në prokurori me datë 17.11.2021,
- Raporti mjekësor në emër të K.G.e datës 16.10.2021 i lëshuar nga QKMF në M.
- Deklarata e të pandehurit M.I.të dhëna në polici me datë 25.10.2021 si dhe në prokurori me datë 12.02.2022,
- Deklarata e të pandehurit I.M. të dhëna në polici me datë 25.10.2021, si dhe në prokurori me datë 12.02.2022.
- Deklarata e të pandehurës E.Z. të dhëna në polici me datë 25.10.2021, si dhe në prokurori me datë 13.02.2022.
- Deklarata e të pandehurës M. Xh. të dhëna në polici me datë 25.10.2021, si dhe në prokurori me datë 14.01.2022,
- Deklarata e të pandehurit J.A.të dhëna në polici me datë 26.10.2021, si dhe në prokurori me datë 13.02.2020,
- Deklarata e dëshmitarit P.T. të dhëna në polici me datë 01.11.2021, si dhe në prokurori me datë 16.12.2021,
- Deklarata e dëshmitarit P. E. të dhëna në polici me datë 27.10.2021, si dhe në prokurori me datë 16.12.2021,
- Deklarata e dëshmitares M. S. të dhëna në polici me datë 03.11.2021, si dhe në prokurori me datë 15.12.2021,
- Deklarata e dëshmitares së mitur J. K. e dhënë në polici me datë 02.11.2021,
- Deklarata e dëshmitares së mitur A. B. e dhënë në polici me datë 25.10.2021,
- Deklarata e dëshmitarit H. S. të dhëna në polici me datë 26.10.2021, si dhe në prokurori me datë 15.12.2021,
- Deklarata e dëshmitarit B.T. të dhëna në polici me datë 12.11.2021, si dhe në prokurori me datë 10.12.2021,
  
- Deklarata e dëshmitarit A.M.të dhëna në polici me datë 26.10.2021, si dhe në prokurori me datë 10.12.2021,
- Vërtetimet 1,2,3 mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të cilat nuk përmbajnë datë, raporti i oficerit B. M. #.... i datës 26.10.2021
- Raporti i datës 25.10.2021,
- Procesverbal mbi kontrollin e shtëpisë, banesës, lokaleve tjera dhe personave i datës 25.10.2021, lista e armëve të konfiskuara i datës 25.10.2021,
- Lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës me nr. ....-...-.....,
- Fotodokumentacioni si pjesë e shkresave të lëndës.
- Raporti i ekspertimit me numër .../....-.../...-.... i datës 31.01.2023, i cili ka të bëjë me ekzaminimin bA.stikë.
- Raporti i ekspertimit me numër .../....-... i datës 05.05.2021 i cili ka të bëjë me ekzaminimin e telefonave të sekuestruara nga ana e të pandehurve M. Xh., J.A.dhe I.M., i cili raport ka të bashkangjitur edhe raportet e oficerëve sa i përket të gjeturave nga ky ekzaminim.
- Raporti i hetuesit A. P. i datës 12.07.2022 i cili konkretisht ka sqaruar të gjeturat e ekzaminimit të telefonit i cili ka qenë i evidentuar në emër të M.Xh.,



-Raporti i oficerit A. P. i datës 27.05.2022 i cili i është dorëzuar Gjykatës si dëshmi të presionit dhe komunikimeve kontakteve që u kanë bërë familjes së të dëmtuarës nga familjarët e M.I.,  
-Dëshmitë të cilat janë dorëzuar nga ana e të dëmtuarës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 21.11.2022 e të cilat janë konstatuar në faqen 6 për 13 kur është dhënë fjala hyrëse e palëve dhe atë një porosi me zë, foto e siguruar nga rrjeti snap-chat të bisedës gjegjësisht të mesazheve të dërguara,  
-Raporti mbi ekzaminimin e viktimës nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore MT ... i datës 04.11.2021,  
-Foto e shkëputur nga moteli T. si evidencë e hyrje-dalje të taksit L. të datës 16.10.2021 dhe deklarata e të miturës L. K. e dhënë në polici me datë 25.10.2021,

Gjykata ka vendosur ti lexoj në procedurën e provave deklaratat e dëshmitarëve mitura J. K., L. K. dhe A. B. të dhëna në stacion policorë pasi që janë të mitura dhe janë pajtuar të gjitha palët në procedurë që të lexohen deklaratat e tyre dhe konform nenit 335 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së ku parashihen se provat e marruara më parë mund të administrohen si provë nëse palët pajtohen që të lexohen.

Video incizimi në CD nga baza e L. T. ku dëmtuara del nga një taksit dhe hyën në taksin tjetër nuk është propozuar të administrohet si provë individuale, edhe pse gjendej në shkresa të lëndës dhe është përdorur gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit P. H.. Andaj e njëjta nuk do të elaborohet si provë e veçant.

#### *Dëshmitë e dëshmitarëve të dhëna para gjykatës*

E dëmtuara K.G. në cilësi të dëshmitares para gjykatës në seancën e datës 21.11.2022 ka deklaruar se: J.A. e ka njohur në rrjetin social Tik-Tok. J. i ka shkruar së pari dhe i ka thënë a mundem me fol dhe a ki sna-pchat, e dëmtuara ia ka dhënë Snapin dhe J. i ka thënë se ka qef me u martu me të me marr për gru. Me J. kanë komunikuar dy ditë. Me datë 12.10.2021 ka qenë te shkolla në f. Ll. me vëllaun e vogël, ka ardhur J. dhe ia ka dhënë vëllaut 5 euro, ndërsa këtë e kanë marr me zor e kanë shtij në automjet, J. ka qenë me A.I., kanë qenë me xhip N., Kur ka ardh vetura ka dal A. dhe i ka thënë hyp në veturë se të shtij me zor, kjo është ulur në ulësen mbrapa dhe vetura i ka pasur katër dyer. Prej Ll. kanë shkuar në K. te furra A. dhe kanë honger bukë J. me shokun e vet, ndërsa e dëmtuara ka marr vetëm ujë dhe prej aty kanë shkuar në një motel në M. dhe kanë kryer marrëdhënie seksuale te dytë me të, pa dëshirën e saj. Fillimisht J. e pastaj edhe A.. Kur kanë shkuar në Motel ka qenë rreth orë 13:00 aty kanë qëndruar për rreth 3 orë. Motelin e ka paguar J., pasi që kanë kryer marrëdhënie seksuale me të e kanë marr dhe e ka dërguar në Gj. në një hotel rrugës për P. dhe aty ka qëndruar vetëm kjo. J. ka shkuar me A. në shtëpi, pastaj kah ora 24:00h ka ardh J. me E. dhe me I. dhe i ka paguar J. 15 euro, personA. sht nuk e ka par E. dhe I., por J. i ka thënë se erdha me E. dhe I., pasi i ka paguar paret J. më nuk ka ardh, ndërsa kjo ka qëndruar aty 24 orë në villa, të nesërmen kah ora 11:00 ka dal nga villat ka shku në këmbë diku rreth një orë për në stacion të autobusave në Gj. dhe nuk ka pasur me vete të holla e as telefon dhe ka shku me qëllim me shku te shtëpia e vet. Mirëpo në stacion i ka zatet të tret I., M. dhe E. me veturë, ka hyp në automjet me ta, pasi që M. i ka thënë “me bo mos me hyp në automjet të rrehi”, pasi që ka hyp në veturë kanë ardh rrugës për P. dhe kanë hy në një rrugë që nuk e dinë as vetë.

Ndërsa ka vazhduar dëgjimi i të njëjtës edhe në seancën e datës 01.02.2023 ka deklaruar se: qëndron prapa deklaratave që ka dhënë në procesverba. e datës 21.11.2022, mirëpo përveç se është shënuar gabim emri A.I. e duhet të jetë A.M., pasi që kanë shkuar nga P. dhe kanë hi në një rrugë që nuk e din se as ku, kanë përdor substanca narkotike, edhe kësaj i ka dhënë substanc

narkotike E. dhe prej aty nuk ka ditë asgjë. Kur është kthjell e dinë se ka qenë te villat G. në R. dhe me të kanë qenë I., M., E., M. dhe A.. E ka pa se është te villat G. pasi që kanë dal prej vilave për me shku me pi kafe e me hanger bukë te L., kanë shkuar me taksi. Të L. ka shkuar me E. dhe A.. Në vila kanë marrë drogë I., M., E., M.. Në vilat G.-. ka qëndruar nga dt.12.10.2021 e gjer me dt. 16.10.2021. Natën e parë kur e kanë qu në villa ka flejtë me I.n dhe E., një ditë kur ka qenë duke ndejtur M. e ka thirr një djalë me dal dhe person ka ardh dhe kjo-e dëmtuara ka dal me të, në Villat G. dhoma nr., fillimisht ky person ia ka dhënë 50 euro me krye marrëdhënie seksuale me të dhe është dashtë me prit ai me ia dërgu paret I.. Ka bërë marrëdhënie seksuale me të por nuk e ka bërë me vetëdëshirë e ka detyru M.. Paret pastaj ia ka qu I.t, ky person që ka flejtë me të ka qenë shoku i M.. E ka ditë që duhet me dal me të nga se një ditë përpara M. i ka thënë se E. dhe fol me të se duhet me dal me dikë. Me dal me dikë është që me kry maëdhënie sekuale. Një ditë I. e ka thirr shokun e vet për me dal me ktë me krye marrëdhënie seksuale në dhomën nr.5 dhe ai e ka pa se kjo nuk po ka dëshirë dhe ia ka dhënë 50 euro dhe ia ka thënë qoja I. por mos i trego se nuk kemi kryer marrëdhënie seksuale se të rre. Një natë M. i ka thirr dy shok të vet për me bo marrëdhënie seksuale, kur ka hy në dhomë që të katërtit nuk kanë bo marrëdhënie por ata M. ia kanë dhënë 200 euro dhe M. i ka marr këto pare dhe ia ka qu I.t dhe M.. Kur M. ka thënë me krye marrëdhënie të katërtit bashkë, kjo ka shkuar me marr ujë dhe i ka treguar I.t dhe aty ka ardhur M., pastaj erdhën edhe ata dy persona. Pastaj këtë dhe M. i kanë mbyll në banjo M. dhe I., dhe ata jon dal dhe janë rrok me fjalë me ata dy persona, dhe pronari i vilave iu ka thënë se po e thirri policinë. Pastaj të gjithë kanë ik dhe këta kanë shkuar te do vila në mal. Ka qenë edhe një rast tjetër që ka kryer marrëdhënie seksuale dhe ka qenë me pagesë shuma ka qenë 50 euro për person, nuk i kujtohet kush i ka paru ata persona, paret që ia kanë dhënë kësaj, kjo ua ka dhënë I. dhe M..

Më tutje e njëjta thekson se kur kanë shkuar te restorant te L., kjo ka mëndu me i thanë një kamerieri me ia dhënë telefonin e mi thirr të shtëpisë me ardh me marr, por nuk ka guxuar prej M. se ka pas kërcënime. Kur ka qenë duke nejt me I., A. dhe M., I. i ka thënë hajde po shkojmë te G. me flejtë e ka dërgu në dhomën nr. 1 dhe ka krye marrëdhënie seksuale këtë, këta të tjerët nuk e kanë ditë. Në dhomën nr.. kanë honger bukë zakonisht kanë porosit, ushqimin ju ka sjell një taksist me emrin Pëllumb. I. dhe M. kanë shkuar te familja e vetë dhe kanë shkuar ditën, ndërsa E. dhe M. kanë nejtë aty. E. ia ka dhënë do tesha për me hi me u pastru dhe i ka thënë se “ a e din që të vjerri qysh ki ba me burrë temin”. E. i ka thirr do persona dhe kanë bo marrëdhënie seksuale me këtë por asnjërin nuk i ka njohur, thirrjet janë bo prej telefonit të M.. J. e ka pa edhe një herë një natë në villë ka ardh dhe ka nejt me I. dhe M. dhe ka thënë du me dal edhe një herë me V., po nuk ka pasur diçka tjetër nuk ka dal mo. Nuk i kujtohet se si ka shkuar prapë në M., ngase ka pi hapa Leksium dhe ata hapa ia ka ble I.. Hapat i ka përdor për me shku sa më shpejt në shtëpi dhe kjo ka ndodhur me dt.16 dhe atë kur ka pasur marrëdhënie me I., pasi ka kryer marrëdhënien seksuale ka pi dhe atë 20 tableta. Pasi që i ka pi e ka hup vetëdijen dhe ka flejt deri në ora 4 dhe tani ka ardh një shoqe e tyre me flok të zeza e ka thirr taksin dhe e kanë pru në M.te një pronar A.M.. I kujtohet që ka hy në banjo dhe këta i kanë lon 5 ose 10 euro përmbi shtrat dhe kur ka hy pronari i ka thënë se këta të lan te na pronari që ka qenë brenda e ka thirr taksin tjetër dhe ai taksi e ka qu në shtëpi. Të nesërmen e ka vet nanën se çka është bo me mu ajo i ka thënë se ke qenë e shtrirë në korridor, e dinë që babi dhe vëllau e kanë dërgu në emregjencë dhe mjeku i ka pyetur se çka ka ata i kanë thënë se ka ardhur në shtëpi si e droguar dhe mjekët e kanë thirr policinë.

Me tej e dëmtuara ka deklaruar: serish konfirmon se nuk ka qenë e lirë me dal vetëm sepse nuk e kanë lënë, sepse i kanë thënë nëse del të rrahim këtë ia ka thënë M., ndërsa M. dhe E. kanë qenë të lira me dal. M. e ka rreh dhe duart me cigare ia ka djeg kur nuk ka pranuar me bo marrëdhënie seksuale me dikon. M. i ka thënë njëher se me bo me i thonë diçka J.t të kapi të

lidhi zhag prej P. deri në M.. E dëmtuara deklaroi se nuk ka pasur marrëdhënie të mira me M. sepse ajo ka thirr persona me bo marrëdhënie seksuale, mirëpo M. s'ka ushtruar dhunë ndaj të saj.

Me J.n është njoftuar me datë 10.10.2021 ndërsa me datë 12.10.2021 është takuar me të, këtë datë nuk e ka mbajtur mend, por nëna i ka thënë se me këtë datë ke dal prej shtëpisë dhe me datë 16.10.2021 është kthyer në shtëpi. Të njëjtën ditë kur është takuar me J. kanë shkuar në Gj., gjatë rrugës Prej Gj. në drejtim të P. edhe të dëmtuarës i ka dhënë narkotik në formë të cigares, por nuk e dinë çfarë lloji. Kur ka qenë duke biseduar një ditë në villa I. i ka thënë se na e paguajmë qiranë e vilave do thot I. dhe M.. E. e I. kanë qenë të martuar, atë ditë kur e kanë marr E. dhe I. e kanë marr me fletë me ta. Kur ka qenë në veturë me J., M. dhe E. në f. R. te Hotel K. .. i ka thënë se dua me ta gjet një punë, e dëmtuara i ka thënë jo, tani M. i ka thënë të rrehi, i njëjti i ka thënë se ki me dal me bo marrëdhënie seksuale dhe për këtë arsye e dëmtuara nuk ka pranuar punën, mirëpo ju ka dashtë me shku me ta, nuk ka qenë dëshirë e saj me nejt me ta. I. i ka thënë se mos mendo qe jemi pasanik, ndërsa E. dhe M. i kanë thënë se nuk je e para që bënë marrëdhënie seksuale me pagesë se ka pas edhe tjera nga Sh..

E dëmtuara ka deklaruar se pasi që është shty gjykimi me datë 21.11.2022 në ora 13:30 nëna e I.t bashkë me djA. e mixhës i kanë shkuar pas në lokal ku ka pi dhe kur janë shkuar në furrë dhe i kanë thënë: “ heke denoncimin “, “se e kan mashtriu djA. tim dhe po dojm me dit sakt se çka ka bo”. Kjo nuk ka pasur mundësi me e thirr policinë se nuk ka pasur telefon dhe s'ka mundur me hi me ja lyp telefonin dikujt. E dëmtuara gjatë deklarimit të saj sërish e deklaroi se kur e kanë dërguar në hotel D. në Gj. ka qëndruar nga ora 8 në aksham e ka qëndruar deri në 8 në mëngjes, prej aty ka shkuar në stacion të autobusëve, sa ka qëndruar aty derën e ka pasur të hapur ka mujt me dal, por nuk ka guxuar sepse ka qenë natë, pasi që ka ardh në stacion të autobusëve në Gj. pasi kishte ecur rreth një orë dhe duke hypur në autobus rastësisht kanë ardhur I., M. dhe E. dhe nuk e din se nga këta e kanë ditur se është në stacion të autobusëve. Gjatë sesish sharon se si i ka pi 20 hapa Leksium. E dëmtuara deklaroi se qëndron pranë deklaratave të dhëna në polici me datë 22.10.2021 dhe në prokurori me datë 17.11.2021. Pastaj thekson se atë ditë kur është takuar kanë dal dytë nga vetura edhe J. edhe A., mirëpo J. si ka dhënë paret vëllaut saj ka hy menjëherë në veturë, dhe është e vërtetë se J. i ka thënë “ se me bo vaki me i kallxu dikujt apo policisë dije veten të vdekur”. E dëmtuara po ashtu ka deklaruar se ka qenë e kërcënuar prej gruas së M.. dhe Gjykatës ia ka prezantuar dëshmitë tri fotografi të mesazheve në emrin F..

-Dëshmitari H.J. para gjykatës në seancën e datës 14.02.2023 ka deklaruar se: Në firmën L. T. në telefon i ka ardhur mesazhi me shku te villa G. nr.. në R. e ka pranuar mesazhin dhe ka shkuar, është ofruar një djalë para veturës së tij të parkuar dhe i ka thënë a bon me dërgu këtë vajzë në M., ky ju ka thënë se punon me orar deri në ora 13:00h dhe nuk mundet me e dërgu, i njëjti ka kontakt me bazën dhe i kanë thënë prano pasagjerin deri në bazë dhe tani e merr tjetri shofer e qon deri në M.për shumën prej 35 euro. Sa ka biseduar me atë djalë ai ia ka dhënë 50 euro dhe dëshmitari ia ka kthyer 15 euro, vajza ka hy në veturë, janë ndal pak se ajo nuk ka pasur papuqe në këmbë dhe një vajzë tjetër ia ka pru papuqet dhe kanë vazhduar deri në bazën e L. T. Aty kanë qenë edhe dy vajza tjera që e kanë shti atë vajzë në veturë nuk i kujtohet mënyra se si ka hy në veturë vajza. Nuk e ka pa kur e kanë shtijë vajzën në veturë pasi ka qenë në kontakt me atë djA. duke ia kthyer paret dhe nuk i kujtohet se si dukej ky djalë pasi që ka kontakt me 50 persona në ditë, pastaj kanë vazhduar në bazë. Gjendjen e të dëmtuarës e ka pa pasi ka arritur në bazë dhe bazisti i ka thënë merri 5 euro që e ka sjell vajzën deri në bazë, ndërsa shoferi tjetër që i kujtohet emri e ka pasur Pllumb ia ka dhënë 30 euro. Vajza ka qenë në gjendje si me qenë e pit, por ka dal vetë nga vetura dhe ka hy në veturë tjetër. Dëshmitari deklaroi se vajzën që e ka pasur në veturë mund ta rikujtoj pasi që e ka pa edhe në kamera që i kanë në bazë kur e kanë

thirr polici. Ndërsa personin që ia ka dhënë paret atë ditë nuk i kujtohet edhe pasi që kthehet nga personat që janë në sallë dhe i shikon nuk i kujtohet. Në polici kur i ka pa fotot e ka identifikuar M.I., mirëpo ka thënë se nuk është 100% i sigurt, por i duket se ky është personi që ia ka dhënë të hollat, atëherë është deklaruar ashtu sepse ka qenë më freskët.

-Dëshmitari A.M. para gjykatës në seancën e datës 21.03.2023 ka deklaruar se: me datë 16.10.2021 ka qenë në villa, ka ardh taxi L. dhe është vendosur në dhomën nr.. ngase villat janë me garazhda. Pagesën e ka bërë taksit te dritarja e shërbimit prej dhomës, e ka shtyp kuponin fiskal me regjistru klientin çështje minuta klienti-taksi është dal prej dhome dhe ka vazhduar. Pastaj ka vazhdu me shku te dhoma për çdo arsye se çdo klient që del duhet pastruar dhoma, kur ka shkuar në dhomë ka qenë një person femër, te dritarja e shërbimit i ka trokitur dhe i ka kërkuar letërnjoftimin, nuk ka pasur, pastaj e ka thirr taksin L. qendrën kryesore dhe i ka thënë që klienti që e keni sjell te villa T. brenda pak minutave duhet me ardh me marr për arsye se nuk ka pasur letërnjoftim dhe nuk i ka treguar se e ka lënë dikon në dhomë. Shkuar dhe e kanë marrë një taksit L. dhe një taksit tjetër. Brenda pak minutave kur ka hy në dhomë pasi ata e kanë marrë klientin gjithçka ka qenë në rregull dhe nuk ka pasur nevojë për pastrim. Sa ka zgjatur krejt kjo janë shënuar prej hetuesisë saktë. Targat kanë qenë të Taksit L. dhe taksit tjetër ka qenë me targa të M. dhe ai është R.. Pos shoferit të taksist dhe një djalë që ka qenë me këtë taksist. Atë djalë nuk dinë me përshkru por janë fotografit të cilat i ka marr policia kur i kanë nxjerr kamerat për targa. Prej kerit nuk ka dal ai djalë e as shoferi.

-Dëshmitari H.S. para gjykatës në seancën e datës 21.03.2023 ka deklaruar se: Vilat G. nga pronari V.A.i ka marr me qira me dt. 01.10.2021 dhe në këto villa ka punuar edhe më parë përafërsisht 10 vite, këtu i ka punuar edhe bashkëshortja e tij e kanë pas biznes familjar. Shtatë villa i kanë marrë me qera, funksionale kanë qenë villa ,,.. dhe .. Veturat të cilat kanë ardh në villa i kanë regjistruar vetëm targat e tyre, në momentin kur kanë ardh veturat të njëjtit kanë qëndruar në recepcion, dhe me villen që ka qenë në shfrytëzim është prej 70 metra deri 100 metra, dhe nuk ka mundur me kalu vetura pa e ditur sepse ka alarme. E njeh I.M., M.I., M. Gj., ndërsa J. A. dhe E.Z. i njeh vetëm mi pa emrat nuk ju dinë, ndërsa nuk është emër i njofshëm për të K.G.nuk e ka pa në vila. Peronat që i ka përmendur se i njeh i ka njohur te recepcioni ku rrin, kur dojn me bo pagesë vijnë deri aty dhe gjithashtu edhe pijet i marrin në recepcion kur dojn, dhe në këtë mënyrë i ka njohur. Villën nr.. e ka marr M. ka nejt dy ditë dhe ka shku pastaj kanë nejt 1 javë, numri .. ose . i ka marr I. me një shoqe të vetë emri nuk i kujtohet, por me pa i kujtohet, ndërkohë dy ditë tri I. e ka marr edhe një dhomë tjetër. Kur e ka marr me ndejtë 24 orë M. e ka paguar 15 euro, kurse I. ka ardhur vetëm në mbrëmje ai i ka paguar 10 euro. Kur ka shkuar I. dhe ka hy brenda në dhomë ndonjëherë e ka que edhe atë femrën me pagu që do të thotë ka paguar edhe E.. M. gjatë asaj kohe ka qëndruar në villen nr... Këta persona ka pas edhe vetura njëra ka qenë në villen nr., e M.t ka qenë ngjyrë e zezë dhe tjetra ka qenë ngjyrë e kuqe ka qenë e I. Në atë villë që është vendosur I. aty e ka pas edhe veturën varësisht ku ka qëndruar p.sh. në villen nr... Këta persona që kanë qenë aty kanë mujt me lëviz, shumë herë kanë lëviz me taksit London edhe me gjip të I. kur kanë shkuar në bjeshkë me punu, ushqimin ia ka pru taksit L. një herë dy herë në ditë. Në villa tjera kanë ardhur edhe persona tjerë me femrat e tyre. Ato ditë M. e ka pasur ditëlindjen ngase e kanë sjell një torte me e lanë në frigorifer dhe ekziston mundësia që kanë qit me armë, por dëshmitari si ka parë asnjëherë, mund të ketë ndodhur kur ky ka shku në restorant L. me marr ushqimin. Aty ka qenë edhe një femër tjetër e zezë e që nuk është e pranishme në sallën e gjykimit, kjo femër ka qenë e vendosur me M.n në një dhomë. M. e ka paguar dhomën nr.6 dhe ka qenë aty me këto dy vajza, por çdo të dytën ditë ose tretën e kanë marrë një dhomë tjetër dhe pse ai e ka paguar ai e ka ditë arsyen pse e ka marrë kur ka shkuar prej mA.t o lodhë. Në villa I. nuk ka pru asnjëherë dru, por ai i ka treguar se po shkon në mal dhe vinte i lodhur.

Më tej deklarohet se gjatë kësaj kohe të qëndrimit në villa të M., I., M., E. dhe personave tjerë që kanë qenë gjithsej 5 persona të cilët në villa nuk kanë ardhur përnjëherë, nuk i kujtohet se kanë ardhur dy meshkuj të tjerë me veturë L. R.. Për këta persona që kanë qëndruar në villa më vonë e ka kuptuar se janë prej I. Teshat e tyre i ka marr ia u ka la dhe ia ka sjell të pastra dhe nuk është takuar asnjëherë me K.G.. M.G.e nje e njëjta është shoqëruar me M. dhe ka ardhur me M. dhe ton kohën ka ndejt aty deri sa ka qenë aty, në pyetjen e parashtruar se aty në villa M. është rreh nga personat tjerë dhe dëshmitari nuk e ka thirr policinë, dëshmitari ka deklaruar se nuk është e vërtetë se nuk kish guxu aty dikush me rreh. Kur E., I. dhe M. nuk kanë qenë aty dhe kanë qenë në mal, M. ka ardhur dhe ia ka kërkuar këtij 30 euro borxh ka shkuar në P. është kthyer, nuk ka mundur dikush me ndal me zor. I. ka qëndruar në villë kohë pas kohe. I. e ka pasur veturën në parking, vetura ka qenë ngjyrë të kuqe, kur ka shkuar I. e ka marr veturën me vete. Nuk e din se në villë janë ofruar shërbime me pagesë. Data kur këta persona kanë marr villat ka qenë mbas 1 Tetorit të vitit 2021. M. ka qendru me dy femra në dhomë dhe ketë e dinë sepse ato femra kanë ardh me marr ujë e langje. Këto vajza E., M. dhe ajo vajza tjetër me flokë të zeza askush nuk i ka ndal me zor në villa kanë qenë të lira me shkue e me dal.

-Dëshmitarja M.S. para gjykatës në seancën e datës 21.03.2023 ka deklaruar se: Në villat ish G.-. ka punuar kur ka qenë duke u përfunduar pandemia e ka zëvendësuar burrin prej orës 11:00 deri në ora 14:00, do të thotë ka qenë 3 orë aty. Personat të cilët i ka identifikuar

kanë qenë aty, sepse herë pas here kanë ardh me marr pije, përveç këtyre personave nuk kanë qarkulluar persona tjerë. Këta persona i kanë marr dy vila, ndërkaq një tjetër e kanë marr kur ka ardhur një person me pushu ngase ka ardh prej mA.t dhe ai që ka shkuar në mal ka qenë I.. Villat i ka pagu të vetat M., I. të vetat. Ndërsa këto vajzat nuk e din a kanë pagu, kjo kohë që i kanë pagu ka qenë përafërsisht 10 ditë, nuk i kanë regjistruar askund këta persona sepse tri villa ishin të ndreqme dhe tri ishin të nxane, dhe vetëm një prej vilave ka qenë e lirë. Këta persona sa kanë qenë në villa kanë dal jashtë vilave me L. t.dhe edhe buka iu ka ardh me taksi. I kanë pasur dy gjipa të parkuar, njëri ka qenë i prishur e tjetri që e kanë pas ka shku me bajt dru me to. Personat që kanë hy me veturë në villa nuk kanë mund me i pa se nuk i kqyrin, ndërsa vetura shkon drejt në garazhd. Ditën kur ka ardh policia M. ka qenë te recepcioni duke i marr do pije, policia ka shku vetë te villat ndërsa kjo e ka lajmëru bashkëshortin H. dhe ai ka ardhur, policia përveç personave ka gjetur edhe sende të kundërligjshme si gëzhoja. Vilat i kanë pastru vetë, ndërsa kjo me bashkëshortin e saj ju ka dërguar vetëm havlijat dhe navllakat. I. në mal më shumë ka shku mbas dite dhe ka shku me gjip. M. tërë kohën në villa ka nejt me M.. I.M. e ka pa në villë vetëm me E.. M.n e identifikon si person i bardh me sy të kaltër dhe dallohet nga ai tjetri së është më i zi dhe ua përziën emrat. M. nuk e ka pa ndonjëherë tu dal nga villat me ndonjë person. L. t.kur ka ardh në villa e ka sjell ndokënd, ju ka pru bukë nuk e kanë verifikuar asnjëherë pra nuk e kanë regjistruar.

-Dëshmitari B.T. para gjykatës në seancën e datës 21.03.2023 ka deklaruar se: me datë 15.10.2021 ka qenë në P. bashkë me nipin V. O. kanë ardhur në P., gjatë rrugës nipi i tij ka biseduar me telefon me M. përmes telefonit të tij, meqë ky e ka pas numrin e telefonit, ai nuk e ka njohur dhe ka pas merak me dal me një femër. Ka biseduar me M. gjatë rrugës nuk e di çka ka biseduar, pastaj nipi i ka thënë se duhet me e dërgu në villat në R. dhe e ka dërgu te villat G.-.. Villen e ka paguar 10 euro, kanë nejt në vila veç dëshmitari dhe nipi i tij 10-15 minuta, pastaj ka ardh M. me një shoqe të vet dhe nipi i tij i ka thënë shoqes së M. mundesh mu largu se je e mitur dhe mbas disa minutave është largu edhe M.. Sa i kujtohet nipi ia ka dhënë M. afër 200 euro. Pasi nuk është kthyer M. ky ka dal dhe e ka pa M. tu hy në villë tjetër përmbi 10 metra, ka trokit në dritare të asaj vile dhe kanë dal bashkëshatarët e tij I. me M., pastaj aty i kanë

shndërruar disa fjalë me tone më të nalta dhe kanë pasur një përlëshje të fjalëve. V. gjatë komunikimit ka qenë në anën e majtë. M. e ka pasur një mjet si në formë thike dhe V. ua ka marr atë mjetë. Dëshmitari e identifikon të dëmtuarën që gjendet në sall se ajo ka qenë atë ditë në vila. Numrin e M. e ka siguruar pasi që njëherë te U. e R. e ka pa M. dhe e ka pyetur shitësin a po e njeh i ka thënë po dhe ia ka dhënë numrin e saj, nuk ka pas komunikim me të. Pas 4-5 muajve ju ka kujtuar numri i saj. I njëjti para gjykatës thekson se kanë dasht veç me nejt në vila me të, mirpo kur ballafaqohet me deklaratën e dhënë në polici dt.12.11.2021 faqe 2 r nga rreshti 14 nga fundi e gjithësejet 7 rreshta ku kishte theksuar se *“jemi marr vesh me kry seks me to, nuk e ka pa kur Veshitirmi ia ka dhënë paret M. a jo, por fjala është për 200 euro por unë nuk e kam pa sa ja ka dhanë, po V. i ka than se ty po ti jepi M. se me ty dojm me pas punë marrëdhënie në treshe, e kjo vajza e re pasi që koka e e re spo dojm me pas punë me të let del nga villa dhe o qu ajo qika e re o dal nga villa se di ka ka shku ma nuk e kam pa , në vil mbetëm unë Veshitirmi dhe M., V. hini me u la edhe unë dola me pi cigare te garazhda edhe M. ka dal dhe e kam pyet ku po shkon, tha po shkoj me marr kondom edhe nuk o kthy ma.....”*. Pasi që i lexohet kjo dëshmitari deklaroi se *“ është e vëretë ajo që mu laxua ashtu e kam thënë”*.

Më tej deklaroi se të pandehurit i njeh se i ka bashkëfshatar kanë punuar në bjeshkë, kanë punu me trupa, dru në R., P., M.janë bjeshkë të fshatit I.. Të nesërmen ka bisedu me I.,se e ka llogaritur si vëlla të vogël, mbasi ia njeh edhe vëllezërit e tij dhe ka qenë me vëllaun e tij L. në shkollë dhe shoqëria ka vazhduar deri më sot. I ka thënë se është prerë në besë dhe është ndier keq, ndërkaq çka i ka thënë ai nuk i kujtohet. Për I. dhe M. nuk e din se kanë punuar në këto punë dhe nuk ka pasur dyshime që i kanë marr këta dytë, ngase M. ka punuar në këto punë te një njeri tjetër dhe ka pru trupa te ky-dëshmitari.

Po ashtu edhe me M. ka pas raporte familjare e po ashtu edhe I. i ka pru trupa, sharrën e ka pasur dhe akoma e ka në I.. I. se ka thirr asnjëherë mi thonë hajde ta qes një femër dhe e njeh që nga mosha 2 vjeçare.

-Dëshmitari A.M.para gjykatës në seancën e datës 21.03.2023 ka deklaruar se: qëndron pranë deklaratave të dhëna në polici dhe në Prokurori, I njeh J., I. dhe M. me J. ka nejt më shumë, ndërsa M. dhe E. nuk i njeh, ndërsa K.G. e ka njohur pasi që J. e ka pasur femër, ka shkuar me J. në M.e kanë marr dhe kanë shkuar në hotel diku në M.. Ka hi J. ka pushu me të (ka kryer marrëdhënie seksuale), pastaj ka fol me J. ashtu që edhe dëshmitari me pushu me të, J. i ka thënë po hi po foli me të. Pastaj dëshmitari ka kryer marrëdhënie seksuale me të, pastaj e kanë quar në Gj. e kanë lënë te disa vila. Të nesërmen ka ardhur K. në I. ka pyetur njerëz dhe ka ardhur te shtëpia e J.. J. e ka thirr dëshmitari për me qu këta në shtëpi të vetë, J. nuk ka pasur veturë dhe ia ka kërku dëshmitarit veturën ky i ka thënë se nuk ka veturë se po shkon në bjeshkë. Ka qenë hera e parë atë ditë që e ka pa J.n me K. dhe ai i ka thënë se e ka femër. Atë ditë kanë shkuar me bo qef K. e ka pyetur sa vjet i ka ajo i ka thënë 18 vjet e gjysmë, hotelin e kanë paguar pak J. pak dëshmitari. Pas kësaj dite dëshmitari ka shkuar në bjeshkë ka nejt 10 ditë, ngase atje i ka delet dhe lopët dhe merret me bujqësi. Pas hotelit në M. K. e kanë dërgu në vilat në Gj. që janë quajtur 007, J. ia ka paguar villen për një natë.

-Dëshmitari R.B. para gjykatës në seancën e datës 22.03.2023 ka deklaruar se: është me profesion taksist privat është i licencuar, në vitin 2021 i kujtohet kur kanë ardh policët hetues të M. dhe ju ka kujtuar se e ka dërguar një vajzë në f. Ll.. Atë ditë ka qenë në renditje në parking të taksistëve në M., kanë ardhur dy persona në këmbë dhe e kanë pyetur sa kushton për Ll. i ka thënë 5 euro, tani i kanë thënë me shku te villa T., e kanë një udhëtare me marr, aty ju ka lyp 2 euro. Kur është nis me shku me marr e ka vërejtur se ata kishin qenë me një taksit tjetër që ka qenë me targa 03. Ka shku te villa T. ka hy në oborr krejt brenda në garazh të vilave, taksit tjetër me ata dy persona

nuk e dinë se ku ka mbete. Vajza ka qenë e re nuk ka biseduar asgjë, ata djemtë i kanë thënë se ke me dërgu për në Ll. dhe atje e ka dërgu. Gjatë rrugës vajza i ka thënë a mundesh me e ndal te Marketi K. se ka deshtë me ble cigare, ia ka ndal veturën e ka ble një paketë cigare ka hy në makinë dhe e ka dërgu deri në f. Ll.. E ka ndal te një shitore i ka thënë se sa i ka borxh, ky i ka thënë se nuk ki nevojë asgjë se e kanë paguar ata djemtë. Vajza sa ka qenë në veturë të taksit nuk ka komunikuar me telefon me këta djem, dhe këta djem kanë qenë të ri me moshë. Vajza nuk ka qenë e frikësuar apo duke quajtur në momentin kur ka hyp në veturë apo edhe gjatë rrugës.

-Dëshmitari *P.E.* para gjykatës në seancën e datës 22.03.2023 ka deklaruar se: qëndron pranë deklaratave që ka dhënë në polici dhe në prokurori, gjatë tërë vitit 2021 ka qenë i punësuar si shofer në L. t.ka punuar vetëm në ndërrim të natës ndërrimi i natës ka filluar pas dite prej orës 5 ose 6 dhe gjatë gjithë natës. Të pandehurit që janë të pranishëm deklaror se i njeh si figurë dhe çdo shërbim që ata e kanë kërkuar iu ka bërë. Këto shërbime si me ju dërgu bukë etj. Iu ka dërguar aty ku kanë ndejt në f. R. te villa G. ose ku kanë pasur nevojë, kush i ka marr shërbimin ia ka kryer edhe pagesat, këto kërkesa kanë zgjatur një muaj ose më tepër nuk e din saktë, menaxhmenti nuk e ka ndal asnjëherë me e verifiku. Në pyetjen se me datë 16.10.2021 sipas shkresave të lëndës dhe sipas video incizimeve të nxjerra nga kamerat e sigurisë ku ju punoni me këtë datë e keni pranuar një klient për të dërguar në M.? Dëshmitari ka deklaruar se po, ketë vajzën e ka pranuar prej baze, ndërsa M. e ka marr te villat G., apo ka ardhur me veturë te baza nuk e din dhe ka qenë kërkesa e

M.t për me dërgu këtë vajzën në M.. Gjendja e klientës nuk ka qenë fort e mirë ka qenë si e mërztur më tepër nuk din, ketë vajzën e ka dërguar në periferi të M. te vilat emri nuk i kujtohet, dhe e kanë vendosur direkt në vilë, mbasi e ka kryer shërbimin është kthyer në P..Vetura që e kam kryer këtë shërbim ka qenë e bardh T. dhe tabelat kanë qenë ..-... dhe kësi lloj automjeti kanë qenë 2 ose 3. Nuk i kujtohet se a është kthyer prapë me marr atë vajzën te vilat. Për me dërgu deri te villa G. – prej qendrës shërbimi ka qenë 5 euro.

Dëshmitari më tej ka deklaruar se ka shkuar në f. R. te villat e ka marr M. A. dhe një vajzë tjetër e cila është nga Lagja J., kur ju ka dërguar ushqim te villat G.-. i ka parë këta persona aty tek villat ata persona që kanë porosit ushqim dhe kur kanë dal me i marr, i kujtohet deklarata e dhënë në prokurori në faqe 5 që ka thënë se M. ka qenë nervoz dhe i kujtohet se ka thënë se “jam kanë tu ja pa sherrin ta dërgojmë deri në M.”, Kërkesën për me shku në M. e kanë marr nga baza dhe bashkë me M. kanë shku.

-Dëshmitari *P. T.* para gjykatës në seancën e datës 22.03.2023 ka deklaruar se: I.. e njeh më shumë se i ka ra me punu me të në sezone në bjeshkë, vëllain e J. e ka pasur shok dhe në gjeneratë dhe M. e njeh se është i fshatit I.. Villat G.-. e din që janë në f. L. apo R. kah të vjen për P. dhe ka qëndruar në afërsi të këtyre vilave por jo brenda. Kishte shkuar aty ngase i ka ble drut prej I. dhe ka shku me ia dërgu të hollat-borxhin që ia ka pasur. Pasi nuk ka mundur me u taku në I. e ka thirr në telefon e ka pyetur ku është ai i ka thënë në L. ose në R. dhe i ka thënë ndalu aty ku je dhe e ka kryer obligimin e vet dhe pastaj ka shku në shtëpinë e vet në I.. Kur ia ka dhënë të hollat ka qenë te vetura e tij ku ai ka ardhur ,a ka dhënë dhe ka shkuar në punë të vet. Për të janë të panjohur emrat M. dhe E. apo nofkat M. dhe G..

-Dëshmitari *L.G.* para gjykatës në seancën e datës 24.04.2023 ka deklaruar se: K.G. e ka motër, në vitin 2021 vëllau i tij G. ka shkuar në shkollë, shkolla prej shtëpisë së tyre është 500 metra apo afërsisht 800 metra. Në vitin 2021 K. ka jetuar me ta, vëllau i tyre është përcjellë për në shkollë nga K., pastaj K. ka munguar 4 ditë të qenit prezent në shtëpi, e kanë kërkuar nëpër M., nëpër shoqet të saj, pas katër ditëve nuk e ka pa kush e ka sjell, po ka trokit në derë dhe kur ka

dal te dera e ka pa ratë në tokë. Në fillim i ka bërtit i ka thënë çka je tu bo këtu, sepse ka qenë ratë dhe gjendja e saj ka qenë si pa vetëdije nuk ka mundur as me fol, i ka bërtit qou hinë brenda, o mundu me u qu ka ra prapë nuk ka mundur. E ka shti brenda e ka thirr policinë e M. dhe i kanë thënë qo në emergjencë e ka qu direkt në emergjencë, e kanë kontrolluar dhe ia kanë dhënë një infuzion dhe e kanë thirr policin edhe emergjenca. Kanë ardhur dy polic kanë thënë se nuk mundën me bo kurgjo pa kon policet femra ato janë në pushim, e ka marr infuzionin dhe e ka pru në shtëpi, të hënën kanë ardhur policet femra e kanë marrë, nuk e dinë a e kanë dërguar në shtëpi të sigurt apo jo, por mbas dy jave ka ardhur prap në shtëpi. K. nuk ka fol dy tri ditë sidomos ktë sepse i ka ardh marre.

Kur kishte ardhur iu ka dok se është mbi dozë, për shkak se edhe më përpara e ka pa një shok se ka qenë mbidozë. K. më herët nuk e ka pa në këtë gjendje deri atëherë, e njëjta ka pasur telefon por e ka pas të ndalur. Mbas këtij rasti ka ardhur një burrë dhe dy gra të shtëpia dhe i kanë thënë me tërhejk akuzën, këta i kanë thënë se aktakuza është në polici dhe në Gjykatë duhet me u zgjedh. Të njëjtit kanë shku te miqt e vëllaut, te do shokë, te një bashkëfshatar i kanë thënë me tërhejk akuzën paret iu jepin sa të dojnë Nuk e kanë ditur prej nga janë veç e kanë ditur se janë kënde j kah P.. Në këtë kohë kur kanë ardhur këta persona K. nuk ka qenë duke jetuar me ta, ka qenë e martuar, te burri K. ka pasur shqetësime nga këta persona sa kanë qenë te ne dhe i kanë dërguar mesazhe edhe këtij edhe K. që më tërhejk akuzën. Ky iu ka thënë se i dërgoi në Gjykatë. Kur nuk e kanë gjete K. nuk e ka lajmëruar policinë nga se ky ka qenë rasti i parë që ajo ka munguar në shtëpi. Këtij K. nuk i ka treguar asgjë, veç nënës së saj i ka treguar.

-Dëshmitarja N. Gj.-A. para gjykatës në seancën e datës 24.04.2023 ka deklaruar se: e njuh vetëm J. A. ka mesi i muajit Tetor 2021 ka qenë në shtëpi, në atë kohë ka ardhur një vajzë në shtëpi e ka kërkuar J., J. ka qenë në gjumë e ka zgjuar dhe ka dal J. ka biseduar me të, pastaj dëshmitarja ka hy brenda në shtëpi nuk e din se çka ka ndodhur, nuk e din a e njuh vajzën me pa tash por e din se ka pasur një duks me kapuq në krye dhe nuk e njuh. Është njerka e J. dhe J. në bashkësi familjare me J., J. i ka dy motra të martuara dhe vajza e dëshmitares është në shtëpi në vitin 2021 e njëjta i ka pasur 15 vjeç dhe vëllezërit e J. jetojnë në shtëpi, e kanë një veturë që punojnë. Ajo vajza që ka ardhur në shtëpi atë ditë ka qenë e dobët në dukje, J. atë ditë ka biseduar me të dhe është kthyer në shtëpi e ka marr jaknen dhe është kthyer dikur vonë, nuk e ka pa kur është kthyer se ka qenë pak pa qef, për atë vajzë nuk e ka pyetur J.n se i ka ardhur rëndë.

#### *Mbrojtja e të akuzuarve*

E akuzuara M.Xh. në mbrojtën e saj ka deklaruar se i njuh I.n, E., M., J. dhe K.G.. Prej datës 12.10.2021 e gjerë me datë 16.10.2021 ka qëndruar në vila G. edhe pse nuk ka dashtë me qëndru ka qenë e detyruar prej M.. Në polici nuk ka dashtë me fol se është tut ka qenë e kërcënuar se me bo me fol, diçka ka me i tregu familjes së të akuzuarës dhe ka me u hakmarrë në të dhe vajzë. Te villa G. ka shku pasi e ka thirr J.K. i ka thënë a dA.m me pi kafe, në atë moment nuk e ka ditë që M. është liruar me kusht, por është ardh te mahalla pak më poshtë me një golf të kuq, aty ka qenë M., J. edhe ka qenë një shok i tij R., mandej J. i ka thënë se M. po donë me fol me ty me ja hjek aktakuzën për rastin e parë që ka qenë në burg kur ka qenë e mitur. E akuzuara i ka thënë se për ata më ki thirr dhe ti po don me u taku unë me personin që më ka mbajt në vila me zor. Pastaj e ka qu në një vend si mal nuk ka qenë asnjë person e ka pasur një thikë me veti dhe e ka kërcënuar se ti nëse nuk ma hjek aktakuzën ti je e vdekur prej meje. Ndërkaq te vila G. kanë shkuar nuk i kujtohet data por kanë shkuar me veturë. Në vila M. e ka kërcënuar dhe i ka thënë se ki me dal me njerëz ki me bo pare, maksimumi 10-15 veta kanë ardhur në ato vila G., e akuzuara nuk i ka thirr, telefonin e ka mbajt M., J., nganjëherë kur vike e në disa raste M. ia jepte



E. telefonin duke i thënë e bonja terminët, kështu edhe kaq pare i du sonte. Me para që i ka fituar M. prej saj kanë ble substanca narkotike, është e vërtet që P. iu ka sjell ushqim, P. shkonte te Gj. të cilin e ka pasur shok të shpirtit, binte kokain deri te vila M. delke e bojke pagesën sa ka kushtuar dhe transportin sa e ka pru dhe shërbimin e ka pasur 5 euro. Telefonin e vet e akuzuara se ka përdor e ka përdor grupi M. në raste E., J. kur vinte ndonjëherë L. K. ka qenë dashnorja e M.. Me K.G. i ka pas raportet shumë të mira shumë herë e ka mbrojtur kur ka dashtë M. me e rreh, e vërtetë është kur M. i ka thënë K.G.se edhe ti ki me dal njëjtë si M. qysh i bim na persona të ndryshëm me

dal dhe me pas marrëdhënie seksuale me ta. K. e ka pa që nuk ka qenë në gjendje jo të mirë atë natë kur e kanë pru për herë të parë e ka pa se i kanë dhënë bari, por nuk e din se çka ka përdor. Ka hi ndërmjet M. kur ka dashtë me e rreh K.. E akuzuara ka mbet shtatzënë e ka marr vesh pas tre muajve dhe nuk e din me kënd ka mbet shtatzënë. M. e ka rreh shumë edhe kur ka qenë shtatzënë, ndonjëherë e akuzuara nuk ka dashtë me dal me persona dhe M. e ka rreh pse nuk ka dal, ka ndodhur që e ka ngreh zhag e ka gjuajt me karrige dhe e ka humbur vetëdijen edhe kur ka qenë pa vetëdije e ka rreh dhe e ka shti M. me pi edhe substanca narkotike.

Më tej deklarom se telefoni jem kur ka ardh policia ka qenë te M. dhe L.. Personat që kanë ardhur në vila ia kanë jep 50 ose 100 euro pasi ka kryer marrëdhënie ia ka dorëzuar paret M., prej vilave shpesh ka tentuar me ik, por është tut se M. e ka kërcënuar, dhe ka qenë e detyruar me ndej. Vilat i ka paguar M. ku ka ndej e akuzuara, A., E. ka ardh ndonjëherë, J. e cila e dojke M.n dhe L. të dyjat kanë qenë të dashurat e M.. Por L. gjithmonë ka pasur marrëdhënie me M.. I. ka qenë dashnor i E., I. ka bajt dru në bjeshkë i ka sjell te vilat dhe ka shku ka flejë me E., përveç I. ka ardh edhe R. që është nga fshati I. dhe Luftoni të cilët kanë qenë shok të M.. J.A.ka qenë një apo dy herë dhe atë e mban në mend vetën kur është sjell K. dhe ju ka thënë bëni çka doni me të dhe ka ardhur edhe një herë tjetër ka fol diçka me M. dhe I. dhe është larguar ai nuk ka nejt në vila nonstop. H. dhe gruaja e tij e kanë ditë se çfarë po bohet dhe çfarë po sillet, shpesh herë kanë ardhur nëpër dhoma. Xhipin që e ka ble M. e ka ble me pare që ka përfituar prej saj. Edhe K. e kanë obligu me pas marrëdhënie me personat e tjerë. Kur B.T. ka shkruar, në telefon të akuzuarës ai ka shkruar me M. dhe nuk e ka ditë që po shkrun me M. por ka menduar se po shkruan me të akuzuarën.

Është e vërtet që prej B. i ka marr 200 euro dhe kur kanë ardhur ata dhe kanë thënë se janë në vilen nr.3. M. i ka thënë merre K. për dore dhe shko te ky numër, mësoje çka me bo, e akuzuara i ka thënë M. se nuk është mirë kështu, përveç që po më maltretoni mua pse ja boni kësaj vajze, sepse me shëndet nuk është mirë. Janë shku me K. te dhoma ka qenë B.T. dhe një pak i shëndoshë, të njëjtit kanë kërku me bo marrëdhënie të katërtit dhe e akuzuara i ka thënë B. jo me bo me këtë çikën se nuk është mirë me shëndet. Kjo i ka thënë K. shko në dhomë kishe me marr kondoma veç se me largu K. prej dhome mos me pas marrëdhënie me ta dhe K. është kthy sepse M. i ka thënë pse nuk ki nejt me M., pastaj këta ia kanë dhënë 200 euro, 100 euro për K., 100 euro për M.. Kur i ka marr pare ia ka dorëzua M. dhe i njëjti nuk i ka lon me dal këto. B. dhe ai tjetri kanë ardh te dhoma 4 ose 5, kanë kërkit në xham, kanë thirr M.n, është dal M. dhe I. M. e ka pasur një thikë në dorë dhe kur e ka pa M. B.n i ka thënë të mos keqkuptohemi, ai tjetri ka thënë që nuk duron asnjë minutë e ka nxjerr alltin, janë ofru M. dhe I. kanë folur me B. dhe pastaj B. është shku që të mos bahet kjo punë e madhe se i njuh këta djem dhe merrem vesh ndryshe me ta. Këtë ngjarje M. e ka pa nga dritarja. Pastaj H. i ka thënë M. se B. iu ka thënë se qetash ua thirri policinë. Pastaj H. i ka thënë M.t banu gati e ikni prej këtu derisa të qetësohet situata, pastaj krejt grupi jon hyp në kerr dhe jon shku rrugës kah vilat L. në R. dhe me telefon të M. M. dhe I. kanë shkruar me B. duke i thënë qetësoju. B. iu ka thënë se nuk ka me lon me kaq se më keni pre në besë, mandej H. e ka thirr në telefon M.n hajde se policia nuk kanë ardh dhe dhomën e kanë

pastru. Pastaj M. si për hangarë gjuajke me allti dhe ka pasur plumba shumë nëpër dhomë, alltia njëra ka qenë e M. e tjetra e I.. Me datë 25.10.2021 kemi qenë në Villat G.-. më saktësisht në

villen numër ., kamë qenë unë e A. në villen numër ., ndërsa në villen nr.. ka qenë M., L., E. dhe I., telefoni i saj ka qenë .../...-..., mirëpo telefonin non stop e ka pas grupi. M. dhe L. telefonin ia kanë gjetur policia kur kanë hy kontroll, pastaj A. ka dasht me gjuajt prej dritares kokainën e kanë parë policia që A. është e droguar, e njëjta ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni se J. K. që figurojnë si L. K. dhe A. B. se kanë qenë të mitura.

E akuzuara më tej deklaorn se nuk ka pasur mundësi me e lajmëru policin se ka qenë e kërcënuar nga M., mirëpo K. ka pasur mundësi. Ajo i ka përdor disa hapa, mirëpo nuk ka pasur mundësi me dal jashtë vilave përveç nëse ka shku A., E. me to apo dikush tjetër. K. te villat e ka sjell J. e ka lënë jashtë vilave dhe aty ka qenë M., I., E., A. të cilët kanë hyp në gjip, ndërsa e akuzuara ka qenë në dhomën nr., veç kur e ka pa se pe shtin brenda K. dhe M. i ka bërtit e ka malltretu njëjtë si këtë dhe i ka thënë ti ki me bo qashtu qysh bon M.. K. e ka pas që nuk është mirë psiqikisht apo me shëndet nuk ka qenë në rregull dhe se e ka dalluar se i kanë dhanë bari, sepse ata non stop e kanë pijë barin dhe kokain. M. paret që i ka marr i ka përdor kur iu ka prish kerri por edhe me ble substanca narkotike dhe krejt ato përfitime i ka pas nga M.. I. çdo natë ka qëndru te villat, në mëngjes ka shku në bjeshkë, në mbrëmje ka flejë me E. ka honger ka pi qaty dhe shumë herë I. e ka mbrojt M.n nga M. mos me rreh. I. e ka përdor telefonin e saj vetëm në rastin me B.T. mo jo. M. i ka thënë E. përdore telefonin e bon termin me personat se K. nuk po din me u marr vesh me ta. Me M. njihet prej moshës kur ka qenë 16 vjeçare, kur ai është dënuar për shkak se kjo ka qenë e mitur dhe ai e ka mbajtur me vjet, ka pas shumë probleme me të ka qenë e kërcënuar prej tij dhe është tut mos po e mbyt. Gjatë kohës sa M. ka qenë në burg M. ka qenë e kërcënuar prej tij, gruas së tij dhe babit të gruas së tij. Ka shkuar te shtëpia e M. në f. . sepse R. e ka thirr në telefon kanë shkuar bashkë me R.n te shpija e M.t ai ka dal dhe e ka rreh qaty për qaty ka hyp në taksidhe ia ka hi boks edhe taksistit dhe ka dal edhe gruaja e tij e ka kërcënuar. Për katër ditë sa ka qenë K. në ditë kanë ardhur 10-15 veta dhe e kanë paguar 50 euro ose 100 euro. Personat që M. ka dal, M. i ka marr paret, shumicën e kohës M. ka qëndru te villat e ka përcjell situatën ka ardh i ka marr paret, ndonjëherë ka dal me i ndreq gjipat, ndonjëherë ka shku në shtëpi. Me armë kanë gjuajtur M. dhe I. kanë gjuajtur pa lidhje por më shumë ka gjuajtur M., I. e ka paguar vetë villen dhe ka ndej me E., nuk e din se kush ia ka jep K. narkotik, mirëpo ajo i ka lyp vetë hapat dhe i ka pi.

I akuzuari I.M. në mbrojtën e tij ka deklaruar se qëndron pranë deklaratave të dhëna në polici me datë 25.10.2021 dhe në prokurori me datë 12.01.2022. M.I.dhe Je. A. i njeh prej se ka qenë në shkollë dhe e njeh edhe M. Gj. dhe E.Z. që tri vjet, nuk kanë pasur ndonjë bisedë për organizimin e ndonjë ndenje apo për ushtrimin e ndonjë veprimtarie. Ka qenë te vilat ku ka ndejt edhe M. ka shku me pa M. dhe ka ndejtë me të 5 minuta. Në ato villa ka flejt bashkë me E. të njëjtën e ka pasur të dashur, ndërsa M. vetëm shoqe dhe e ka njohur para E.. K.G. e njeh e ka pa te villat dhe tash e njeh në gjykim. Me K. është takuar diku një javë para se mu arrestu dhe është takuar te pompa në R. “ A. G.” e njëjta ka qenë me J. dhe babin e J.. I.n ka qenë në bjeshkë kur e ka thirr J. i ka thënë se një qik i ka ardh te shtëpia a mundesh me ardh me marr me qu te shtëpia e vet në M.se kerrin ia ka marr baba i vet e nuk ka kerr, i ka shkarkuar drut dhe para se me shku te pompa A. G. e ka lënë nafti. Pastaj e ka thirr J. i ka thënë se e ka lon nafti se ska me çka vjen e mundesh me ardh me i pru naftë, ai i ka thënë po e marr gjipin e babës dhe po vij po ta bij do naftë ka hy me pi kafe te K. Hotel dhe aty e ka thirr M. i ka thënë se është me E. tu e prit J.n me ardh me ia pru naftën. Pastaj ka ardhë M. ka ardh J. me babën e vet e me K. dhe ia kanë pru 5 litra naft, jon mundur me dhez kerrin ja ka lëshu bateria, pastaj e kanë dhezë me klema, e kanë marr atë qikën pra K. e kanë hyp në kerr. Pastaj J., E., K. dhe M. kanë shkuar për me qu në M., babai i J. është

kthyer para se me shku në M.janë ndal te rrethi U. që është furra dhe kanë hij me marr diçka me honger. Tu shku rrugës para se mu kyq në autostradë J. dhe K. janë grindur në mes veti, K. i ka thënë J. se ti duhesh mem qu në shtëpi dhe mi tregu vllaut tem se ti më ki marr dhe ti duhesh me ma bo qarën. Pastaj I. i ka thënë J. a don me qu në shtëpi a të kthena se jam lodhur e ka kthyer kerrin bashke te pumpa dhe janë kthyer për në P..

K. ka thënë se është e sëmur prej nervave dhe i duhen me i ble do hapa ia ka ble dhe tani jon shku te villat në R. i ka lënë këta e ka lënë K. dhe M., J. e ka qu në shtëpi. Pastaj me E. ka dal në P. me shëtit. Të nesërmen në mëngjes kur ka shku në bjeshkë e ka pa K. në vila. Nuk ka marr pare me krye marrëdhënie dikush me K. e ka paguar villen 10 euro ku ka flejt vetë dhe në mëngjes ka shku në bjeshkë. E. e ka marr gjeth me veti në bjeshkë, ndoshta dy tri herë e ka lënë në villa gjatë dy muajve, nuk ka pasur marrëdhënie me K., e ka pasur femër E., ndërsa K. ka qenë femra e J.. Para pranon nga vëllezërit që i punojnë jashtë si dhe nga drut që i merr në bjeshkë. M. dhe J. i njeh janë nga i njëjti fshat dhe i kanë raportet e mira. I njeh edhe B.T., P.T. dhe A.M., po ashtu e njeh edhe M. I.-K., R. dhe Luftonin janë nga i njëjti fshat dhe se i njeh krejt I. dhe ka raporte të mira. Në muajin tetor 2021 policia e ka gjetur duke fjetur në vilë dhe i kanë sekuestruar armën e cila ka qenë në posedimin e tij si dhe një karikator i armës i cili ka qenë i zbrazët, te vilat nuk ka gjuajtur por ka gjuajtur në bjeshkë dhe i ka marr gëzhajat me veti në xhep, pastaj ato janë gjetur në krevat. Gëzhajat që janë gjetur të vilat kanë qenë të M. nuk kanë qenë të tijat. I akuzuari ka deklaruar se nuk është e vërtetë se atë natë kanë flejtë bashkë në dhomë me K. dhe E..

Më tej deklararon se B.T.n e njeh dhe është takuar me të te villat G.-, M. është fjalosur me të dhe rastësisht i ka pa, ngase ka qenë në një villë tjetër, me B. për këtë çështje janë sqaruar në telefon. Pasi që i prezantohet një foto me një veturë me targa ..-...-.. që është e vendosur në villen nr., i njëjti deklararon se gjipi është i ti, por nuk ka qenë në villen nr.. por ia ka dhënë gjipin M. kur ai ka pasur nevojë, ngase e ka pasur shok dhe nuk ia ka ndal. Nuk është konsumues i substancës narkotike dhe se A. B., J. K. dhe L. K. nuk i njeh. A. e ka pa vetëm kur është arrestuar, që është arrestuar ajo dhe L. e njeh është nga S. dhe ka qenë në shkollë me të në D.. Për herën e parë prej M. K. e ka pru A.. J. ndonjëherë e ka marr me veti në bjeshkë, ndërsa a ka qenë J. gjatë kohës sa K. ka qenë në vila i akuzuari deklararon se nuk e ka pa, ndërsa deklararon se është e vërtetë se M. ka ushtru dhunë ndaj M. dhe i ka pru persona të ndryshëm për me krye marrëdhënie dhe ai ka qenë i dënuar për ketë punë e për K. nuk e dinë. Nuk është marr kurrë me këto gjëra ka punuar në bjeshkë dhe nuk i përket asaj familje, ndonëse është shoqëruar me M., por lidhje me trafikim nuk ka pasur, e ka pasur femër E. vetëm dy muaj dhe nuk ka pasur të bëjë diçka tjetër.

E akuzuara E.Z. në mbrojtën e saj ka deklaruar se me I. është njohur katër muaj para rastit, janë njoftuar përmes shoqërisë, I. ka punuar me dru, ngase familjen e ka pasur në bjeshkë.Me K.G. është njoftuar kur ka qenë në bjeshkë me I., J. e ka thirr I. i ka thënë se është me një femër a mundesh me ardh me e que deri në M.,

ngase nuk ka pasur kerr. Janë kthyer bashkë me I.n prej bjeshke, ka ardhur M., pastaj ka ardhur J. me K., kanë shkuar me xhip të I.t. Gjatë rrugës për me dërgu K. janë kthyer për P., K. e kanë lënë në villa në oborr. K. është pastruar i ka veshur rrobat e E. dhe ka ra me flejt. Në villa kanë flejtë I. e E. sepse kanë shku në bjeshkë dhe iu ka ra me u kthye herët në mëngjes dhe mos me i shqetsu familjen nuk kanë shkuar në shtëpi, por kanë hy në villa kanë pushu. Në muajin Tetor kanë shkuar në bjeshkë me marr dru sepse në ketë muaj lejohet me marr dru, e njëjta në pyetjen e parashtruar ka deklaruar se as nuk e dinë se ku është stacioni i autobusëve në Gj. dhe gjatë

muajit tetor 2021 nuk ka pasur telefon personal. Ditën kur policia ka hy në vila e njëjta ka qenë me I. në gjumë.

Është nënë e tre fëmijëve. Mn dhe M. i njeh para I., J. e njeh pak para rastit. K. kur e kanë marr me veturë e njëjta ka biseduar me E. i ka thënë se nuk don me shkue në shtëpi të vet dhe ka kqyrë vetëm qysh me ndej dhe i ka thënë se jam e dashuruar në këtë e në atë, pastaj K. e kanë dërguar në Villat G.-. E akuzuara ka deklaruar se A. B. e njeh dhe mendon se i ka pasur 17 vjet. E njëjta ka deklaruar se numri i telefonit të saj ka qenë .../...-..., mirëpo në atë kohë nuk ka pasur telefon dhe nuk iu ka caktuar terminë me telefonin e saj dhe se nuk është e vërtetë se P.E. e ka thirr dhe e ka përdor taksin L.. K. ka dal të nesërmen në restorant në R. me taksi L. dhe se nuk e ka përdor numrin e telefonit të M.. J. e njeh e ka familjare, ndërsa J. e ka L. familjare dhe e ka ditur moshën e tyre dhe se kanë qenë të mitura, po ashtu e njeh edhe B.T.. Me M. ka pasur raporte normale dhe nuk ka qenë në dijeni se ajo ka thirr persona të ndryshëm me ardhë në vila. M. i ka treguar se M. ushtron dhunë ndaj saj, mirëpo vet me sy nuk e ka pa. Nuk e din se ka pasur shumë klient te vila G.-., sepse kjo ka ndej me I. dhe nuk ka nejt shumë në vila me këqyr kush po hyn e kush po del. Familjet e kanë ditë që janë bashkë dhe kanë fletur edhe në shtëpi të I.. Me K. është takuar për herë të parë në atë moment kur e ka pa me J. dhe janë nisur për M.dhe nuk është e vërtetë se e kemi marr K. në Gj. ajo vetë ka ardhur këtu. K. ju ka duk e trullavt dhe si e habitur dhe i ka ndërruar fjalët dhe për këtë ka menduar se nuk është mirë psiqikisht, një njëri që është në rregull nuk rrin me njerëz që nuk i ka pa kurrë. K. ka pas firk prej saj se i ka bërtit, sepse ajo e shprehke dashnin për I.n dhe kjo i ka bërtit prej gjelozisë, i ka thënë shko në shtëpi, ajo nuk ka shkuar dhe nuk ka pasur shanc me shkue. Nuk e din kush e ka pagur vilen për K.. Është e vërtetë që me I.n ndonjëherë kanë konsumuar substanca narkotike, ndërkaq K. nuk e ka pa.

I akuzuari *M.I.* në mbrojtën e tij ka deklaruar se qëndron pranë deklaratave të dhëna në polici me datë 25.10.2021 dhe në prokurori me datë 12.01.2022. I.n dhe J.n i njeh i ka të fshatit dhe ka punuar në mal me ta. Edhe M. Xh. dhe E.Z.n e njeh përafërsisht që tri vjet, edhe të dëmtuarën K.G.e njeh, ketë e njeh veç prej kohës sa është në burg, ndërsa jasht nuk e ka njohur. E ka njohur si person me emër Vale si femra e J.. Ka qenë duke pirë kafe në një restorant në P. ka ardhur I. me J., G. dhe V., I. ia ka bo me dorë ju ka afruar xhipit dhe i ka thënë po shkoj në M.a po vjen po shkoj me qu këtë femrën e J. te shtëpia në M.. Kanë shkuar për M.kah P., K. nuk ka pranë me shku në shtëpi thojke du me nejt me J. dhe janë kthyer në K. këtë e kanë qaty ku e kanë marrë e këta kanë shkuar për me qu J. në shtëpi, K. ka shkuar me ta. I akuzuari ka deklaruar se punon në mal dhe ka qu dru afër vilave G.-. dhe ka pasur rast ka qëndruar aty, ngase iu ka dashtë me shkue në gjysmë të natës mos me i shqetësuar familjen. I njëjti ka deklaruar se asnjëherë nuk ka marr para në këmbim nga

ndonjë klient për K.. Në mal ka shkuar ndoshta çdo ditë, ka pasur rast që ka shkuar edhe me I. për me punu.

Më tej deklararon se për herën e dytë e ka qu K. në M., ngase i ka thënë I. dhe për shkak të shoqërisë që ka pasur me I. e ka quar, me të ka qenë taksisti P.E., J. K., dhe A. B.. K. e kanë dërguar te vila T. në M.dhe ka qenë kërkesa e saj me e dërgu në M.. I akuzuari ka deklaruar se është nga f. I. dhe është i martuar. Vetura të cilën e ka pas në posedim është e llojit F. E. A. me të cilën ka shkuar në mal dhe kjo veturë është gjetur nga ana e policisë në villen nr... Kjo veturë ka qenë e pa regjistruar dhe jo funksionale dhe iu ka prish dy tri ditë para se me arrestu policia. Vilën G.-. e ka marr me qera, ka pasur raste që villen e ka marr për 24 orë apo vetëm natën, ka pasur raste kur e ka marr villen për G. sepse e ka pasur si motër. Kjo ka ndodhur kur nuk ka qenë I. aty, ndërsa ka qëndruar aty edhe M. por për të nuk ka paguar dhe para një kohe ka qenë në lidhje me

M., në vila kanë qëndruar shoqërisht. Dëshmitari R.B. është paguar 7 euro nga ana e të akuzuarit M. për me marr K. nga Vilat T. ku është lënë për me e dërgu në f. e saj, këto shërbime për I. i ka kryer sepse e ka pasur si vëlla I., është rrit me të. Ai i ka ndihmuar ky i ka ndihmuar atij. Policia e ka gjetur te villat G.-. me datë 25.10.2021 dhe aty ka qenë edhe e mitura L. K. dhe është në lidhje me të, pra me datë 25.10.2021 në villen nr.5 është gjetur M.I.dhe L. K.. Këtij i është sekuestruar një armë dhe një karikator i zbrazët. Nuk është e vërtetë që i ka siguruar klient K., dhe nuk ka ushtruar dhunë ndaj K.. Për M. nuk e din sa kohë ka qëndruar në vila dhe se kush ia ka paguar vilen dhe nuk është në dijeni se M. ka thirr njerëz për me krye marrëdhënie seksuale me K..

I njëjti ka deklaruar se nuk është e vërtetë që M. e ka mbajtur në vila dhe ta ketë keqtrajtuar dhe përfutur prej saj. Kur është takuar atë ditë me I., I. nëse nuk gabon ka qenë në villen nr.. ka shkuar ka fol me I. i ka thënë po shkoj në mal a po vjen, i ka thënë se është shumë i lodhur sot nuk mundet, i ka thënë a mundesh me ma bo një nder a po e merr V. e qo në M., dhe i akuzuari M. i ka thënë po. Valja nuk ka qenë në vill me I. por ka qenë vetëm, K. nuk i ka thënë asgjë se I. e ka shit e ka rreh apo diçka tjetër. I akuzuari ka deklaruar se ka qenë i rrezikuar prej personave që e kanë shtirë M. me fol keq për të vazhdimisht. K. ka qenë mirë atë ditë kur ka hy në veturën e të akuzuarit dhe të njëjtën e ka parë në vila dy herë apo tri herë.

I akuzuari J. A. në mbrojtën e tij ka deklaruar se se qëndron pranë deklaratave të dhëna në polici me datë 25.10.2021 dhe në prokurori me datë 13.01.2022. I akuzuari ka deklaruar se I.M. e njeh, M.I.e njeh sepse i ka të fshatit, me I. i ka raportet e mira. Ndërsa M.Xh. dhe E.Z. nuk i njeh, E. e ka njohur veç se e ka pasur I. femër. A.M.e njeh ka raporte familjare e ka kushëri, edhe të dëmtuarën K.G.e njeh, fillimisht ka folur në snap me të dhe e kanë lënë takimin me dal në M.në ora 12:00-13 .00 të ditës dhe ka shkuar me A., kanë hyj në oborr të shkollës në f. Ll. tuj prit. E ka hap dritaren e kerrit dhe i ka thënë çka po bon a je mirë dhe e njëjta ka hyp në veturë, nuk është dal prej veture as i akuzuari J. as A., A. veç e ka shoqëru rrugës. Pastaj me K. ka shku në villa, kanë hy i akuzuari, A. dhe K. në vila kanë pushu pesë minuta apo 10 A. ka dal jashtë në grazhd, pastaj me K. i akuzuari ka kryer marrëdhënie me dëshirë, pastaj e ka thirr A. me hy mbrenda. Ka hy A. edhe ai ka bo marrëdhënie seksuale me K., iu ka dok shumë absurde që një vajzë po kryen marrëdhënie me të dhe me A., shumë e pa moralshme vetëm për K.. Pastaj kur kanë dal prej vilave kanë shëtitur njo 10 minuta në M.pastaj kanë hyjë në një furrë buke, pastaj i kanë thënë K. me e qu

në shtëpi ajo ju ka thënë se nuk don me shku në shtëpi. Kanë ngrënë bureka që të tretë, pastaj kanë shetitë edhe pesë minuta janë mundu me e qu në shtëpi, por nuk ka pranë dhe ka thënë se nuk muj me shku në shtëpi, dhe i ka thënë me e qu te një shok i babit të saj në Gj.. Prej M. e kanë prurë në Gj., pastaj ju ka thënë se nuk mundet me ndejt këtu, vetëm ka bo hajgare. Pastaj i ka pa do vila në Gj. dhe e kanë lënë aty mos me lënë në rrugë dhe ia ka paguar villen për 24 orë, pastaj me A. janë ardh në f. I.. E ka qu A. në shtëpi pastaj ka shku edhe vet në shtëpi.

Më tej thekson se të nesërmen njerka e njoftuar se po të thirr një qik dhe është dal e ka pa K., i ka thënë se qysh je ardh deri këtu, i ka thënë se ka ardh me autobus deri në D. dhe kur ka ardhur në I. ka pyetur njerëz nëpër rrugë se ku e ka shtëpinë J.. Pastja e ka thirr A. i ka thënë a po vjen ta dërgojm K. në shtëpi të vet në M.. A. i ka thënë se nuk ka kohë është duke shkuar në bjeshkë. E ka thirr I. i ka thënë edhe ati se K. i ka ardh në shtëpi dhe don me qu në shtëpi të vet në M.. I. i ka thënë po, tu ardhë e ka lënë nafti, pastaj i ka thënë babit të vet a po më qon deri në R. me ja qu do naft një shoku dhe e ka dërgu deri në R. e ka marr naftin dhe ia ka qit. Janë nis I., E. dhe K. për me e dërgu në M.gjatë rrugës e kanë marr M. në një kafe dhe janë nisur me dërgu në M. K. gjatë rrugës ka thënë se badihava shkojm në M.se nuk shkoj në shtëpi, pastaj janë kthyer në K. Kur janë kthyer M. K. e ka nal në R., ndërsa I., J. dhe E. kanë shkuar dhe J. e kanë dërgu në

shtëpi dhe nuk ka pasur kontakt më me K.. I. e ka pyetur për K. se qysh është, mirë i ka thënë se është, sa i përket mesazhit të bërë screen shot në telefonin e tij ky shkruan “ merrne boni naj pare veç mos i boni diçka, pastaj qoni në M.” i akuzuari ka deklaruar se ky mesazh nuk është i tij, dhe se asnjëherë nuk e ka trafikuar K.G.. Në rrjetin social snap ka komunikuar me K. para se mu taku 4-5 ditë ose 1 javë dhe të dytë kanë qenë me emër dhe mbiemër në snap, ky e ka pasur IPHONE . ose .. dhe numri i tij i telefonit ka qenë .../...-..., qëllimi i bisedës me K. ka qenë veç mu njoftu , por nuk i ka premtuar asgjë asnjëherë. Atë ditë që është takuar, te vila në M.K. ka pasur gjendje të mirë shëndetësore. Nuk i kujtohet se gjatë rrugës kah kanë shkuar në M.apo kah janë kthyer të jetë ndalur dikush mi ble hapa.

### *Fjala përfundimtare*

*Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka bërë përmirësimin përshtetësor të dispozitivit nr. I të aktakuzës, duke bërë përmirësimin e përshtetësorit faktik me shkrim dhe ka bërë rikualifikimin e veprës penale e që duhet të jetë “ me çka në bashkëveprim dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale “Trafikim me njerëz” nga neni 165 par.1 e lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së”. Më tej ka theksuar se: në shqyrtim gjyqësor janë vërtetuar faktet të cilat konsistojnë në reA.zimin e figurës së veprave penale për të cilat është ngritur aktakuza dhe të njëjtat i paraqesim si në vijim: të akuzuarit I.M., M.I.dhe J. Ahmatxhekaj, janë nga fshati I., K-Deçan, të akuzuarit janë bashkëvendës dhe po ashtu shokë pothuajse të njëjtës gjeneratë dhe mbajnë raporte te mira. F. I., K-D. është në distancë prej . km nga vilat “G. .” të cilat janë në f. R., K.P.. Dëshmitarët A.M., P.T. dhe B.T. janë po ashtu nga f. I., K-D.. Të njëjtat njihen me të pandehurit. Të miturat A.B, L.K dhe J. K, po ashtu ishin të njohura për të pandehurit dhe në veçanti shoqe me te pandehurën E.. I pandehuri M.I.dhe I.M. janë recidivist sipas aktgjykimeve në shkresat e lëndës. E pandehura M.Xh. ka qenë si e mitur, viktimë e të pandehurit M.I.për veprën penale “Mundësim apo detyrim në prostitucion”, nga neni 231 par. 3 e lidhur me par. 1 të KPRK-se (Aktgjykimi nën shenjën PKR nr. 121/21 i datës 13.08.2021, nga GJTH-P. Departamenti për të Mitur ).Viktima K.G., referuar data bazës së Prokurorisë Themelore në P. -programit SMIL, nuk ka të kaluar kriminale dhe nuk ka ndonjë rast të hapur penal përveç si viktimë në rastin e fundit për vetëvrasje. E njëjta ishte vetëm 18 vjeç (që i bie madhore e re). I pandehuri J. A. merr të dëmtuarën K. nga f. Ll., K. M., përderisa ishte i shoqëruar nga dëshmitari A.M., nën mashtrim duke e venë në lajthim se kinse J. do të krijoj martesë me të. I lartcekuri kryen marrëdhënie seksuale me të, e më pas ia mundëson edhe dëshmitarit A.. E dëmtuara nuk posedonte telefon me vete, të holla apo çantë me gjëra personale. E njëjta më pas nga J. dërgohet tek i pandehuri I.M. dhe te pandehurit e tjerë. Dy të lartcekurit se bashku edhe me te akuzuarit M. dhe E. dërgojnë te njëjtën tek vilat “G. .” në f. R.,E njëjta gjithnjë shoqërohet nga te tjerët dhe nuk i lejohet dalja e vetme. I akuzuari M.I.dhe I.M. posedonin armë për te cilat nuk kishin leje, përderisa ishin duke qëndruar në vilat “G. .”, Të njëjtat i përdorin armët duke gjuajtur për rreth oborrit te vilave. Të akuzuarit M., I., E. dhe M. vendosen në vilat “G. .”, për pothuajse më shumë se dy muaj.*

Që të gjithë janë të pa punë dhe nuk reA.zojnë të ardhura. Të njëjtat paguajnë vilat duke rezervuar pa ndërprerë 3 prej tyre. I pandehuri I. dhe E. janë përdorues të substancave narkotike. Gjatë kontrollit është gjetur substancë narkotike të cilën e ka pasur e mitura A.B., ku për këtë të fundit është duke u udhëhequr procedura pranë GJTH-M.. Në vendin e ngjarjes janë gjetur një numër i madh gëzhgojash si dhe tableta te cilat janë përdorur nga e dëmtuara. Tabletat janë blerë nga i akuzuari I.M.. Nga menaxhmenti i vilave nuk është konstatuar hyrje dalje te klientëve. Të akuzuarit janë shërbyer me kompaninë taxi “L.” si për transport, gjera ushqimore dhe nevoja te tjera disa herë brenda ditës dhe natës. Kjo kompani ka marrë thirrjet për shërbime gjithnjë nga numri i njëjtë i cili ka qenë me sim kartelë *Ipko*. Në vilen nr.. - në garazh gjendet vetura e të

pandehurit I.M., po ashtu në vilen numër . edhe vetura e të pandehurit M.I.. Dëshmitari B.T. së bashku me një familjar te tij paguajnë shumën prej 200€, për të pasur marrëdhënie seksuale me viktimën K. dhe te pandehurën M.. I lartcekuri takohet me të pandehurin I. dhe M. dhe aty lind një konflikt verbal dhe fizik në mes tyre. Dëshmitari B. të nesërmen e sqaron situatën e krijuar me të pandehurin I. në telefon. E akuzuara M. posedon numrin .../...-..., në telefonin i cili është gjetur në dhomën ku kishte qenë i akuzuari M., nga i cili janë bërë komunikimet nga te gjithë te pandehurit për sigurimin e klientëve dhe shërbimeve te tjera. E dëmtuara K.G.ka qenë gjithë kohën nën kontroll duke e shfrytëzuar për përfitime materiale nga të lartcekurit. E lartcekura dërgohet në M.në një gjendje të keqe shëndetësore nga i akuzuari M.. E njëjta vendoset përsëri në disa vila në M.e vetme. Transporti kryhet me kompaninë “Taxi L.”. Kompania në fjalë detyrohet që të kthehet dhe ta merr te dëmtuarën pasi që menaxhmenti i vilave “T.” e sheh si te kundërligjshme vendosjen e te njëjtës. Më pas sigurojnë një taksì privat duke e dërguar në shtëpi ashtu te dërrmuar. E njëjta dërgohet për trajtim mjekësorë nga familjaret. Më pas dërgohet në strehimore për shkak të sigurisë duke qëndruar aty për një periudhë kohore.

E akuzuara M.Xh. në mbrojtjen e saj të dhënë me datë 24.04.2023, ka deklaruar se: *“atë ditë kur ka ndodhur rasti me K. unë kam qenë në vila dhe e di kur e kanë marrë për dore dhe e ka shti në vilë dhe atë M.”*, më pas ka shtuar se, vilat “G. .” i ka paguar M., e ka paguar një vilë ku rrisa unë, A., E., vint kaniher J. ngase e dojke M. dhe L., te dyjat kanë qenë te dashurat e M., por L. gjithmonë ka pasur marrëdhënie me M.. Po ashtu ka deklaruar, ...”J. A. ka qenë një herë apo dy dhe atë e mbaj mend vetëm kur është pru K. dhe ju ka thënë që merrni boni qa te doni me te, dhe ka ardhur edhe një herë tjetër dhe pat fol diçka me M. dhe I. dhe është larguar”....., po e kanë obliguar ka pasur rast qe i kam thënë K. mem ndigua mua largohesh nga këtu, i kanë thonë K. se ki mu bo gati, kur M. i vjen klienti do te

bëjmë bashkë me dy meshkuj dhe do te shkosh edhe ti me te,, e vërtetë qe unë prej B. i kam marrë 200 euro, M. me ka thënë merre K. për dore dhe shko te qeky numër mësoje çka me bo, sa i përket numrit te telefoni ...-.../... non stop e ka pasur grupi, M. dhe L. telefonin ia kanë gjetur përfundi jastëkut kur kanë hy policia në kontroll,, K. nuk ka pasur mundësi me dal jashtë vilave përveç nëse është shku A., E. me to apo dikush tjetër,, K. e ka pru te vilat J., e ka lanë jashtë vilave dhe aty ka qenë M., I., E., A., të cilët kanë hyrë në gjyp,, dhe me duket se M. i ka bërtit, e ka malltretu,, .

Në pyetjen se, për katër ditë sa ka qenë K. sa para i keni fituar, e akuzuara ka deklaruar: *“ nuk e di por 10-15 veta kanë qenë në ditë dhe personat kanë paguar 50 euro ose 100 euro”*.

Po ashtu ka deklaruar se: *“po te dytë kanë qitë edhe M. edhe I., kanë gjuajtur me armë, kanë gjuajtur për pA.dhje por më shumë ka gjuajtur M. pik en terun”*.

*Sa i përket pretendimit se e njëjta po ashtu ka qenë viktimë, këtij pretendimit te të akuzuarës i propozoj Gjykatës qe mos t'ia fal besimin, meqenëse e njëjta ka pas mundësi qe te lëviz lirshëm dhe ka pas njohuri lidhur te me të pandehurit, meqenëse e njëjta kur ka qenë e mitur është shfrytëzuar nga i akuzuari M. për prostitucion, ku edhe eshte dënuar për këtë vepër penale, njeherit nëse ka gene e kërcënuar*

I akuzuari I.M. në mbrojtjen e tij te dhënë me datë 08.06.2023, ka deklaruar se: *“të pandehurën M. e njoh qe 3 vjet por me E. jam njoftuar nja 3 muaj para se me hi në burg”*, po ashtu deklararon se: M. M. e ka njohur shumë moti, për J. nuk e di sa e ka njoft,, me tutje ka deklaruar se: K. ka qenë me J., me babën e J. kur janë takuar,, po ashtu ka deklaruar: K. i ka thënë J. ti me ke marrë duhesh mem çu në shtëpi, duhesh me ardh te vëllai i jem me i kallëzu qe ti me ke marrë dhe me

duket se ja ka hi J. por nuk i kam pa bash mirë”, si dhe ka shtuar se i ka blerë hapa. Ndërsa në raport me 4 gëzhojat te cilat janë gjetur te vila numër 7 dhe hapësirat, i akuzuari ka deklaruar e di që gëzhojat janë gjetur në krevet, i kam marrë dhe i kam shti në gjep, te vilat nuk kam gjuajtur. Më tutje ka shtuar: “ e mur M. dhe kanë hy në vila, nuk e di ngase i kam qu J.n bashkë me E.,,, po ashtu ka shtuar se është konsumues i substancës narkotike. Kjo vërteton se biseda që është bërë nga telefoni i te pandehurit J.A. është me te pandehurin M., meqenëse edhe i pandehuri I. ka deklaruar se nuk e di se a njihen në mes vete M. dhe J., po ashtu vërteton faktin se ky se bashku me te pandehurën E., te pandehurin M. dhe te pandehurin J. e kanë dërguar tek vilat “G. A”, dhe po ashtu vërtetohet fakti se e dëmtuara është vënë në lajthim nga i pandehuri J. kur e ka marrë në M..

I propozon gjykatës që mos t’ia fal besimin mbrojtjes se te pandehurit I., meqenëse e njëjta është bere me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale për veprat penale te cilat i vihen në barrë si dhe është kundërthënëse dhe më poshtë do i konstatojmë pjesërisht disa te gjetura, ku fillimisht me deklaratën e tij te dhënë në prokurori me datë 12.01.2022, ku i njëjti në faqe 4, pyetja e parë ka deklaruar:- “siç thash bashkëjetoj me E. në shtëpinë time në f. I. dhe punoj së bashku me te, e kjo për një periudhë kohore që nëntë muaj, gjersa para gjykatës ka deklaruar se e njeh 3 muaj para se me hy në burg (26.10.2021),- në kundërshtim me deklaratën e te bashkëpandehurës M.Xh. te dhënë para gjykatës me datë 24.04.2023, faqe 14, pyetja e katërt, rreshti i parafundit ku në përgjigjen e saj ka deklaruar: “,,,(J.) ka ardhur edhe një herë tjetër dhe pat fol diçka me M. dhe I. dhe është larguar. Ai nuk ka nejt në vila nonstop, “gjersa i pandehuri I.M. në deklaratën e tij te dhënë para gjykatës me datë 08.06.2023, faqe 11, pyetja e dytë ka deklaruar se: “,,,ndërsa a ka qenë J. gjatë kohës

se sa K. ka qenë në vila unë nuk a kam pa”,- në kundërshtim me deklaratën te dëmtuarës K.G.te dhënë para gjykatës me datë 01.02.2023, faqe 11, pyetja e parafundit ku ka deklaruar: (J.) “ka qenë edhe një natë, në vilë dhe ka ardhur me nejtë me I. dhe M. dhe ka thënë se du me dal edhe një herë me V., me mu”, e që kjo pjesë e deklaratës se te dëmtuarës gjënë mbështetje edhe me deklaratën e te pandehurës M.Xh.. Po ashtu në kundërshtim edhe me pjesën e deklaratës te dëmtuarës ku e njëjta në seancën e lartcekur, faqe 10, në pyetjen e parë ka deklaruar: “ një ditë I. e ka thirr shokun e vetë për me dal me mu me kry marrëdhënie seksuale ne dhomën numër 4 dhe mi dha 50 euro dhe me tha qoja I.t por mos ta din që nuk kemi kry marrëdhënie seksuale,” gjersa i akuzuari I.M. në mbrojtjen e tij të dhënë me date 08.06.2023, faqe 5, në pyetjet e mbrojtësit dhe atë pyetja e fundit se: a ka ndodhur ndonjëherë që dikush me ardh me kërk shërbime te femrave dhe ti ke marrë te holla prej dikujt me kry marrëdhënie me K., ku i akuzuari ka deklaruar: “jo, unë kam marrë për punën teme në sharrë që kam qu dru”.- në kundërthënie me deklaratën e dëshmitarit H. S. te dhënë ne prokuroria me datë 15.12.2021, faqe 6, pyetja e dytë ku ne pyetjen e prokurorit se: a mund te na tregoni se vilat a janë paguar gjithmonë nga M. dhe I. apo edhe nga femrat?, dëshmitari ka deklaruar se: “po ka ndodh që te paguhen edhe nga femra e I.t, gjersa i akuzuari I. para kësaj gjykate me datë 08.06.2023 ka deklaruar se “po kam paguar vilen teme kur kam fletë, 10 euro”, po ashtu ne prokurori me datë 12.01.2022, faqe 6, pyetja e tretë ka deklaruar : “unë kam paguar vetëm një vilë dhe atë në shumë prej 10 euro për mua dhe E.”.

Deklarata e të pandehurit I. është në kundërthënie me deklaratën e te bashkëpandehurës E.Z. te dhënë në gjykate me datë 09.06.2023, faqe 2, pyetja 3, ku e njëjta ka deklaruar se I. e kam njohur 4 muaj para rastit, e po ashtu sa i përket deklarimit te të njëjtës se K. është vendosur atë natë në vila dhe se ka qëndruar-flejtë në një dhomë bashkë me te dhe te akuzuarit I., ku i njëjti është deklaruar se nuk është e vërtetë .- në kundërthënie me deklaratën e te bashkëpandehurit J.A.te dhënë në gjykatë me datë 09.06.2023, faqe 12 , pyetja e tretë ku i njëjti ka deklaruar : “po kam



pyetur, kur e kam pa në katund I. dhe i njëjti me ka thënë se mirë është”, po ashtu edhe në polici me datë 26.10.2021 fq.2, në pyetjen e gjashtë ka deklaruar se: “me I.n kam fol me vet se a është mirë ajo vajza dhe a ka shku në shtëpi apo ku ishte, ku I. me tha se këtu është dhe mirë është dhe kaq”, gjersa i akuzuari I. në gjykatë me datë 08.06.2023, faqe 11, pyetja e tretë ka deklaruar se: “jo”, gjersa në prokurori e ka deklaruar te kundërtën dhe atë faqe 6, në deklaratën e datës 12.01.2022, pasuesi i fundit ka deklaruar: “po është e vërtetë që me ka thirr” (J.). - në kundërthënie me deklaratën e te bashkëpandehurit M.I.te dhënë në gjykatë me datë 09.06.2023, faqe 21, pyetja e shtatë ku është përgjigjur: “ndonjëherë kam shkuar me I.n dhe ndonjëherë kam shkuar edhe vetëm”, gjersa i akuzuari I. në gjykatë me datë 08.06.2023, faqe 11, në pyetjen e parë të parashtruar nga mbrojtësi i te akuzuarit M.I.se : “ju thatë se prej vilave keni shkuar në mal, a keni shkuar ndonjëherë në mal me M.?” , i njëjti ka deklaruar: “jo kurrë, veç unë kam shkuar në mal”.

Po ashtu dëshmia e tij pjesërisht është kundërthënës edhe me dëshmitë e dëshmitareve të tjerë.- në kundërshtim me listën e dëshmimeve e cila vërteton se dëshmitë-gëzhojat janë gjetur jo në dhomën ku ka qenë i njëjti apo në gjepin e tij siç ka deklaruar por janë gjetur në hapësirën jashtë motelit në oborr si dhe në hapësirat ndërmjet vile nr.. dhe ..

-E akuzuara E.Z. në mbrojtjen e saj te dhënë me datë 09.06.2023, ndër të tjera ka deklaruar se: “I.n e kam njohur 4 muaj para rastit,, *kemi qenë unë me I.n kur jemi kthyer prej bjeshkës ka ardhur M. pastaj ka ardhur J. me K.,, K. e lam në*

*vila në oborr,,* po ashtu ka deklaruar se: te K. nuk ka pa asgjë qe ka pasur me vete, as çantë, as telefon,,*K. e kemi gjetur në vila me M.n dhe M., K. ka lyp me u la dhe pastaj unë e kam marrë te dhoma ku kemi flejt na, është la, është ndru ka pushuar nja dy orë dhe ka shkuar prap në dhomë të kta,* me tutje kur ballafaqohet me përgjigjen e dhënë në polici me datë 25.10.2021, faqe 2, se ju keni deklaruar se: “një natë ka flejtë me mua dhe I.n, natën tjetër me A. B.,” e njëjta deklaron se po përgjigje është e njëjtë,,,, po ashtu e pohon faktin se ka qenë në njohuri për J.K, L.K, A.B, se janë te mitura,,,, po ashtu në pyetjet e gjykatës ka deklaruar se: “*mu ka duk si e trullavt dhe si e habitur dhe i ndrojke fjalët dhe për ketë kam menduar se nuk është mirë psikikisht*”,,, si dhe ka shtuar se njeriu nuk është në rregull te rrin me do njerëz që nuk i ka pa kurr.

Gjersa ka shtuar në fund se ajo dhe I. kanë konsumuar substanca narkotike dhe se K. ka pasur frikë prej saj, i ka bërtit,- Deklarata e të akuzuarës E. po ashtu është kundërthënëse edhe me vetë deklarimin e te njëjtës, ku e njëjta para gjykatës me datë 09.06.2023, faqe 4 , në pyetjen e parë të parashtruar nga mbrojtja ka deklaruar: “ne kemi flejtë ne vila sepse na kemi shkuar në bjeshkë dhe na ka ra me u kthy herët, kah rrethi i sabahut, mos me i shqetësu familjen na nuk jemi shkuar në shtëpi,, gjersa në po te njëjtën datë, në pyetjet e prokurorit faqe gjashtë, pyetja e parafundit e njëjta ka deklaruar se: “kemi shkuar për dru dhe familjen e ka pasur në bjeshkë”.- Kjo deklaratë pjesërisht është kundërthënëse me deklaratën e te dëmtuarës K.G.e cila ne gjykatë me datë 01.02.2023, faqe 11, në pyetjen e nëntë ka deklaruar se: “(E.) i ka thirr do persona dhe personat kanë ardh dhe kanë bo marrëdhënie seksuale me mu mirëpo unë asnjërin prej tyre nuk i kam njohur”, gjersa e pandehura E. në deklaratën e saj te dhënë në gjykatë me datë 09.06.2023, faqe 4, në pyetjen e pestë të parashtruar nga mbrojtësja e saj ka deklaruar se: “kjo nuk është e vërtetë”, - Njëkohësisht është në kundërshtim edhe me deklaratën e te miturës A.B te dhënë në polici me datë 25.10.2021, ku kjo e fundit ka deklaruar se: “po unë e di qe i thojnë Vale dhe sa me kujtohet e kam takuar në qytet ne P. diku në një lokal te parku i vogël, unë kam qenë se bashku me shoqen time G., ku me te njëjtën kemi pirë kafe”, gjersa është në kundërshtim me deklaratën e te

akuzuarës e cila ka deklaruar në gjykatë me datë 09.06.2023, në faqe shtatë, pyetja e fundit : “JO”.- Deklarata e saj është kundërthënëse edhe me deklaratën e dëshmitarit P. H., i cili ka deklaruar në prokurori me datë 16.12.2021, në faqe 5, pyetja e dytë se a mund te na tregoni se kush i ka bërë pagesat e këtyre shërbimeve, i njëjti ka deklaruar se: “te njëjtat i kanë bërë M. dhe M. por ka ndodh edhe E.”, - Më pastaj në pyetjen se a mund te na tregoni se a jeni komunikuar nga një numër telefoni apo te ndryshëm i njëjti është përgjigjur: “thirrjet gjithnjë kanë qenë nga një numër dhe ai ka qenë nga kompania *ipko* ... dhe qe te tre te lartcekurit thirrjet i kanë bërë nga ky numër”, gjersa

e akuzuara E. para gjykatës me datë 09.06.2023, faqe shtatë, ka deklaruar se: “nuk është e vërtetë”.- Është kundërthënëse me deklaratën e te akuzuarës M.Xh., te dhënë në gjykatë me datë 24.04.2023, faqe 12, në pyetjen e tretë, në rreshtin e katërt kah fundi ku ka deklaruar: “në disa raste M. ia jepke E. telefonin, bonja terminët, kështu dhe kaq pare i du sonte”, gjersa e akuzuara e ka mohuar në mbrojtjen e dhënë para gjykatës me datë 09.06.2023.

I akuzuari J.A.në mbrojtjen e tij te dhënë me datë 09.06.2023, ndër te tjera ka deklaruar se: “arsyeja e takimit ka qenë me dal me te njëjtën me u njoftu, gjersa ka deklaruar se K. ishte vetëm, nuk ka pasur telefon dhe se dëshmitari A. ka qenë me te vetëm për ta shoqëruar, si dhe e ka thirr I.n për me ardh me marrë K. me dërgu në M.e më pas janë kthyer dhe janë nal në R. ku edhe e kanë lënë K. me M.” i njëjti po ashtu ka pohuar se telefoni Iphone .. ka qenë i tij dhe numri i tij ka qenë .../...-..., si dhe ka pasur te instaluar rrjetet sociale si *snap*, *whatsapp*. -Deklarimi i tij është në

kundërthënie me raportin e AKF-së për ekzaminimin e telefonave te datës 05.05.2021, dhe me njoftimin e te gjeturave nga ky ekzaminim i datës 01.07.2022, duke pas parasysh se ky raport është i besueshëm dhe i pa kontestueshëm sa i përket rezultateve të këtij ekspertimi dhe në raport me mbrojtjen e te akuzuarit J. dhe të tjerëve, kjo provë e bënë te pa qëndrueshëm mbrojtjen e te njëjtëve.- Deklarata e të akuzuarit J.A.ka kundërthënie me deklaratën e të dëmtuarës K. te dhëna në te gjitha fazat e procedurës sa i përket marrjes se të njëjtës nga M. si dhe shkuarjes në motele për të kryer marrëdhënie seksuale me te njëjtin dhe me dëshmitarin A., po ashtu sa i përket shkuarjes në vilat “G. .”.-Deklarata e tij është kundërthënëse edhe me deklaratën e dëshmitarit A. M. të dhënë në gjykatë me datë 21.03.2021, në faqe 23, pyetja e pestë ku dëshmitari ka deklaruar se ka kërkuar nga J. që te kryejë marrëdhënie seksuale me K. si dhe ne po te njëjtën datë dhe faqe ka deklaruar se kanë shkuar në hotel me kry punë dhe me bo qef, gjersa i akuzuari J. ka deklaruar në mbrojtjen e tij se vetëm kur ka dal prej banjos e ka kuptuar se A. ka kryer marrëdhënie seksuale me K.. Po ashtu ka kundërthënie edhe me pagesën e vilave.- Deklarata e të akuzuarit J. është kundërthënëse edhe me deklaratën e te akuzuarit I.M. të dhënë para gjykatës me datë 08.06.2023, i cili në raport me atë se a e ka thirr J. për ta pyet për K. gjatë kohës sa ajo ka qenë në vila ka deklaruar se “JO”, gjersa i akuzuari J. para gjykatës me datë 09.06.2023 faqe 12, në pyetjen e tretë ka deklaruar te kundërtën duke pohuar faktin se e ka pyetur I..

I akuzuari M.I.në mbrojtjen e tij te dhënë me datë 09.06.2023, ndër te tjera ka deklaruar se: “i njeh te pandehurin I. dhe J., është rrit me ta si dhe përafërsisht qe 3 vjet i njeh edhe te pandehurën M.Xh. dhe E.Z.”,,,, po ashtu ka pohuar se ka marrë një vilë për 24h si dhe në raste edhe një vilë tjetër për E.,,, ka pohuar se në këto vila ka qëndruar edhe e pandehura M.,,, gjersa e mohon qe ka zbritur me K. tek vilat “G. .”, ndërsa sa i përket dërgimit te të njëjtës në M.me taxi “L.” e pohon si te vërtetë, mirëpo kjo ka qenë me kërkesë te I., më pastaj e mohon se është takuar tek vilat me dëshmitarin B.T.,,,Kjo deklaratë është në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit B.T., te akuzuarit I.M., te akuzuarës M.Xh., te akuzuarës E.Z., si dhe të akuzuarit J. A., sa i përket ndaljes tek vilat “G..” së bashku me K., po ashtu se i njëjti me dëshmitarin B.T. ka pasur kontakt dhe konflikt përderisa ka qenë duke qëndruar tek vilat, sa i përket posedimit dhe shfrytëzimit te telefonit i cili ka qenë në emër te të akuzuarës M. dhe që është përdorur për komunikim dhe

sigurime të klientëve për të kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën K., për transport dhe sigurim të gjërave ushqimore.

Referuar të lartcekurave, mbrojtjet e të bashkë akuzuarve janë kundërthënëse në mes vete e po ashtu edhe me të gjitha provat e përshkruara si më lartë dhe të njëjtat janë bërë vetëm me qëllim të ikjes së përgjegjësisë penale dhe si të tilla i propozojmë gjykatës që të mos t'ia falë besimin. Prandaj, nga të lartcekurat mbetet në tërësi pranë aktakuzës të përmirësuar në fillim të kësaj seance gjyqësore si dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarit t'i shpallë fajtorë duke iu shqiptuar dënimit e merituar në raport me përgjegjësinë penale për veprat penale për të cilat janë akuzuar. Gjykatës po ashtu i propozoj që, me rastin e matjes së dënimit si rrethana rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, të marrë për bazë: Shkallën e lartë të dashjes; Prezencën e dhunës ose kanosjes në kryerjen e veprës penale; Viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pa mbrojtur apo e ndjeshme, meqenëse në raport me të akuzuarit të cilët posedonin armë me vete dhe ishin në numër me shumë, Moshë e viktimës (madhore e re), Shkallën e dëmit të shkaktuar viktimës apo familjes së saj dhe E kaluara kriminale e të akuzuarve. Ndaj të akuzuarve të merret aktgjykim dënues konform nenit 365 të KPP-së, për shkak se, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë

se me veprimet e të pandehurve qëndrojnë elementet e veprave penale të përshkuara si më lartë, andaj i propozoj Gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit të dënimit të aplikoj premiset e përcaktimit të dënimit sipas *Udhëzimit të Politikave Ndëshkimore të Gjykatës Supreme vitit 2018*, i cili parasheh pikënisjen e matjes së dënimit.

Mbrojtësja e viktimave në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështetë fjalën përfundimtare të prokurores së shtetitj.

Mbrojtësi i të akuzuarës M. Xh. *av. Osman Lajçi* në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka deklaruar: se me provat e administruara gjatë seancave gjyqësore është vërtetuar se e akuzuara M.Xh. nuk është kryese e veprës penale me çka në bashkëveprim dhe në vazhdimësi kanë kryer veprën penale Trafikim me Njerëz nga neni 165 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 77 të KPRK-së, E akuzuara M. . nuk ka pas mundësi që të merret me Trafikim me Njerëz pasi që edhe vetë personA.sht ka qenë objekt i Trafikimit, e njëjta ka qenë në lidhje edhe më parë me të akuzuarin M.I.me të cilin ka qëndruar edhe gjatë kohës prej datës 12.10.2021 deri me datë 16.10.2021. Gjatë kohës së qëndrimit në villa është përdorur një telefon të cilin e ka pas e akuzuara M. Xh. dhe ky telefon është përdor nga grupi e që kjo është vërtetuar edhe gjatë seancave kryesore. Akatkuza e ka ngarkuar se ka siguruar klient të dëmtuarës K.G.përmes telefonit të saj që të ketë marrëdhënie seksuale e në raste të caktuara edhe marrëdhënie seksuale në grup së bashku me të akuzuarën M.Xh. në këmbim të të hollave në shumë prej 50-200 euro, prandaj vet aktakuza e Prokurorisë Themelore në P.-Departamenti për krime të rënda e përshkruan se edhe vet e akuzuara M. Xh. ka qenë objekt i cili ka kryer marrëdhënie seksuale në këmbim të hollave dhe këto të holla ka qenë i detyruar tija dorëzoi të akuzuarve tjerë. Gjatë seancave gjyqësore e dëmtuara K.G.ka deklaruar se e akuzuara M. Xh. e ka detyruar të kryej marrëdhënie seksuale me njerëz, Gjykata nuk mund tija falë besimin një deklaratë të saj për arsye se duke u bazuar në provat për përcaktimin e fajësisë gjykata nuk mund të shpall fajtor të akuzuarin duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo prove e cila nuk mund të kundërshtohet, asnjë dëshmitare dhe asnjë prej të akuzuarve nuk e ka ngarkuar të akuzuarën M.Xh. se është kryese e veprës penale të Trafikimit me njerëz si e ngarkon aktakuza. Prandaj në mungesë të provave e akuzuara M.Xh. të lirohet nga aktakuza PP/I.nr.224/21 e datës 28.03.2021 në mungesë të provave.

E akuzuara M.Xh. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.M. *av.Sylë Lokaj* në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka deklaruar: se Prokuroria ka dështuar që të përshkruaj dhe të argumentoj në mënyrë të qartë dhe juridikisht të qëndrueshme bazën e dyshimit të mirë që i pandehuri I.M. të ketë kryer veprën penale në bashkëkryerje trafikimi me njerëz nga neni 165 par.3 lidhur me par.1 dhe neni 77 të KPRK-së. Prokurori në shqyrtim kryesor ka dështu që të argumentoj, në mënyrë të qartë, të saktë dhe juridikisht të qëndrueshme figurën e veprës penale dhe kuA.fikimit ligjorë. Në rastin konkret duhet të anA.zohen dy çështje kryesore e para nëse veprimet me të cilat ngarkohet i akuzuari formësojnë figurën e veprës penale për të cilën akuzohet dhe e dyta nëse provat mbi të cilat mbështete aktakuza mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet me aktakuzë. Me asnjë provë të vetme nuk është provuar se i akuzuari I.M. në çfarëdo forme ta ketë bërë rekrutimin, transferimin, strehimin ose pranimin e viktimës së pretenduar. I vetmi veprim i të akuzuarit I. në raport me të dëmtuarën K.

ishte fakti se shoku i tij J. kërkoi nga ai që tija kryen një shërbim me veturë, për ta dërguar në shtëpinë e vet një vajzë me të cilën ai një ditë më parë ishte njoftuar me të e ajo kishte ardh në shtëpi të tij e krejt me qëllim që ajo të krijon lidhje martesore e që J. nuk ishte i pajtimit. Me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar pretendimi i Prokurorit që të akuzuarit janë organizuar si grup, përkatësisht kanë themeluar një grup me qëllim të kryerjes së veprës penale të trafikimit me njerëz sikur që përcakton paragrafi 3 i nenit 165 të KPK-së, Mbrojta parashtroi se në këtë çështje penale nuk është provu se është përmbush standardi i vërtetimit të gjendjes faktike përtej dyshimit të bazuar, e me një standard të tillë nuk mund të ketë aktgjykim fajësues sepse nuk plotësohen asnjë nga elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet i akuzuari I.M.. Gjithashtu në shqyrtim kryesor nuk është provuar se i akuzuari ta ketë përdorë armën sikur që akuzohet, i propozon Gjykatës që në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së të bie aktgjykim liruës. Meqë i akuzuari I.M. në të gjitha fazat e procedurës penale e ka pranuar fajësinë për veprën penale mbajta në pronësi, kontroll të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPPK-së nuk ka dyshim se ai e ka kryer këtë vepër penale. Në raport me të akuzuarin nuk ka pas rrethana rënduese dhe fakti se ai e ka pranuar fajësinë për këtë vepër, është i penduar, i propozon Gjykatës që me rastin e vendosjes për dënimin ti ketë parasysh këto rrethana dhe ti shqyrtoi një dënim sa më të butë.

I akuzuari I.M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: nuk qëndron fakti se është recidivist ashtu siç tha prokurorja, e mbështetë fjalën e avokati. Nuk ka asnjë provë që dëshmon se kam kryer vepër penale asnjë dëshmitar nuk ka thënë që unë kam kryer vepra penale.

Mbrojtësja e të akuzuarës E.Z. *av. Majlinda Kollçaku Libusha* në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka deklaruar: se Përshkrimi i dispozitivit të aktakuzës tregon se bashkë të pandehurit kanë marr të dëmtuarën tek Stacioni i autobusëve në Gj. dhe se një përshkrim i tillë i prokurorisë i pa mbështetur në asnjë provë materiale përcjellëse gjatë shqyrtimit gjyqësor për këtë pretendim, gjithashtu është vërtetuar se e dëmtuara ka shkuar vetë në shtëpi të akuzuarit J. dhe se ka shkuar vet nga Gj. në f. I., është dëgjuar edhe njerka e të akuzuarit J., dëshmitarja N. Gj. A. ku vërteton edhe pretendimet e mbrojtësve se e dëmtuara ka shkuar në shtëpi të të akuzuarit J. dhe e ka kërkuar, i njëjti ka qenë në gjumë dhe se dëshmitarja e ka zgjuar nga gjumi dhe ka dalur për ta takuar, e më vonë gjatë deklarimeve edhe vet të të akuzuarit ky pretendim është vërtetuar se e dëmtuara ka shkuar vetë në shtëpi r jo sipas përshkrimit të aktakuzës ku të njëjtit kinse e kanë takuar dhe marr tek Stacioni i Autobusëve në Gj.. Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të propozuar nga Prokuroria gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dhe nga vetë deklarata e

bashkakuzuarve në procedurë dhe vetë të dëmtuarës e mbrojtura ime E.Z. nuk është përmendur asnjëherë për ndonjë veprim eventual inkriminues të së njëjtës e për të cilat veprime të saja eventuale do të krijonin figurën e veprës penale për të cilën dyshohet trafikim me njerëz nga neni 165 par.3 e lidhur me par.1 dhe nenin 77 të KPRK-së. Gjithashtu sipas prokurorisë e njëjta ka pas për detyrë të siguroi klient që të ketë marrëdhënie seksuale me pagesë për të dëmtuarën, ky pretendim i prokurorisë gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk është vërtetuar me asnjë provë materiale nga fakti se asnjëri nga dëshmitarët, bashkë akuzuarit si dhe vetë e dëmtuara të dëgjua gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk e kanë përmendur që ndonjëherë ndonjëri nga ta ka pasur kontakte telefonike me të mbrojturën e saj E., përkundrazi gjatë shqyrtimeve gjyqësore të gjithë dëshmitarët kanë potencuar faktin se as që e njohin të mbrojturën e saj e as që kanë pasur ndonjëherë ndonjë kontakt telefonik me të, me çka është vërtetuar pretendimi i mbrojtës së e akuzuara E. nuk ka poseduar telefon. Nga të gjitha këto prova të cekura dhe të elaboruara me padysim është vërtetua se e mbrojtura e saj E.Z. në këtë çështje penale nuk ka të bëjë fare me veprimet për të cilat akuzohet sipas aktakuzës, andaj kërkohet që bazuar në nenin 364 par.1 nën par. 1.3

të merret aktgjykim lirues ndaj të akuzuarës E.Z., ngase gjatë gjithë procedurës nuk është provuar se e akuzuara ka kryer vepër penale për të cilën akuzohet.

E akuzuara E.Z. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtëses së saj, beson qe K. nuk i ka pi hapat për të

Mbrojtësi i të akuzuarit M. I. *av.Muhamet Ibraj* në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka deklaruar se: Prokuroria ka dështuar të ofroj prova si për organizimin e grupit po ashtu edhe për veprat e kryera nga ky grup i supozuar. Prokuroria në tërësi e ka bazuar akuzën në deklaratat e të dëmtuarës K.G.e cila në çdo deklaratë të dhënë është kontraverse dhe jo e sigurt në atë çka deklaron, në deklaratat e saj në asnjë rast të vetëm nuk vërtetohen faktet se i mbrojturi i tij M.I.ta këtë detyruar të dëmtuarën K.G.për të kryer marrëdhënie seksuale me ndonjë person dhe në këmbim të kësaj M. të ketë marr para. Në seancën e datës 09.06.2023 Prokurorja e çështjes e ka njoftuar Gjykatën se Prokuroria ka pranuar një raport informues se dëshmitarja- e dëmtuara kishte tentuar të bëjë vetëvrasje për shkak të problemeve me familjen, e dëmtuara-dëshmitarja K.G.vazhdimisht në deklaratat e saj supozon se parat mund ti kenë pranuar I. dhe M., por asnjëherë të vetme nuk ka thënë se këtë ditë në ora kaq ia ka dhënë vet ose dikush tjetër tu këtë dhënë një shumë të caktuar të mbrojturit të tij M.I.. Gjatë gjithë shqyrtimit kryesor është vërtetuar se i mbrojturi i tij është personi i fundit që e ka njohur të dëmtuarën dëshmitaren K.G.dhe kategorisht e mohon që të ketë sjellë ndonjëherë ndonjë person apo ti ketë thënë dikujt tjetër për ta sjellur ndonjë person për të kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën e as të ketë pranuar para nga e dëmtuara apo dikush tjetër. Mbrojta e të akuzuarit konsideron se asnjë nga provat nga shkresat e lëndës dhe dëshmitë e dëshmitarëve në ndërlidhje me të drejtën materiale nuk e vërtetojnë dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari M.I.ka kryer veprën penale nga pika 1 e aktakuzës, andaj i propozojnë Gjykatës që me rastin e vendosjes sipas kësaj çështje penale juridike ta refuzoj aktakuzën e Prokurorisë si të pa bazuar dhe të mbrojturin e tij ta liroj nga pika I e aktakuzës. Ndërsa sa përket veprave penale nga pika II “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe pika III “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 366 par.1 të KPRK-së i mbrojturi i tij M.I.i ka pranuar që nga fillimi i procedurës për çka Gjykatës i propozon që praniam i fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

I akuzuari M.I.në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.A.*av.Arbër Rrustaj* në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim ka deklaruar se: Gjatë kësaj procedure gjyqësore nuk është vërtetuar me prova të administruara se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe dëshmitarëve të dëgjuar nga të gjithë këto është vërtetuar se aktakuza e Prokurorit të shtetit nuk është e bazuar në prova qofshin ato materiale dhe personale, porse vetëm në deklaratat e të dëmtuarës të cilat nëse shikohen dhe anA.zohen janë tërësisht kontradiktore mes vete dhe thellësisht të pa mbështetshme me ato të cilat i ka dhënë në polici apo prokurori dhe në Gjykatë. Në shqyrtim gjyqësor janë dëgjuar shumë dëshmitarë dhe po të shikohen deklaratat e dëshmitarëve veç e veç të dhëna në polici dhe në prokurori të H. e M. S., B.T., A.M., P.T., H. J., P. H., A.M. dhe R.B. të cilët disa janë dëgjuar në polici dhe prokurori nuk e inkriminojnë J.n në kryerjen e kësaj vepre penale. Pronari i vilave ka deklaruar që as nuk e njeh J.A.dhe as që e ka parë ndonjëherë në vila, shoferat që kanë kryer porosi të ndryshme nuk e njohin dhe as që kanë thënë që J. ka bërë ndonjë porosi ndonjëherë, bashkë akuzuarit tjerë kanë deklaruar që

J. nuk ka qenë në vila para kohës së veprës penale dhe pas saj, andaj cila mendje e shëndosh dhe cili jurist profesional mund ta bindë kjo aktakuzë se ku thekson se J.A.ka vepruar si anëtarë i grupit të supozuar nga prokuroria ku i njëjti as që është parë në ato vila. Po të kishte pasur qëllim që ta trafikonte të dëmtuarën nuk do të kishte tentuar së pari që ta dërgonte në shtëpinë e saj në M., por ta dërgonte tek vilat, gjithashtu edhe pse me kërkesën e të dëmtuarës për ta dërguar në Gj. i akuzuari J. po të kishte qëllim ta trafikoj do ta dërgonte tek vilat.

I akuzuari J.A.në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

\* \* \*

Gjykata duke marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarve I. e M. për disa vepra penale siç është cek me larët dhe gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të aktakuzës dhe pretendimeve të prokurores, mbrojtjes së të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, dëshmisë së të dëmtuarve si dhe të provat tjera materiale, të cilat i ka vlerësuar veç e veç dhe në ndërlidhje logjike dhe faktike me njëra tjetrën, si dhe konform nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoi këtë:

#### *Gjendje faktike e vërtetuar*

-Të akuzuarit njiheshin në mes vete dhe atë i akuzuari M., I. dhe J. ishin nga i njëjti fshat ndërsa me të akuzuarat M. Gj. dhe E.Z. ndiheshin të akuzuarit M.I.dhe I.M. dhe dhe kishin një kohë që rrinin me të njëjtat, kishin marrë me qera vilat G.-A, ku dhe qëndronin për një kohë. Ndërsa të akuzuarat M. dhe E. e njiheshin edhe me të akuzuarin J., të cilin e njihnin nëpërmes të akuzuarve I. dhe M..

Të akuzuarit M.Xh., M.I.dhe I.M., E.Z., J.A.nga data 12.10.2021, e në vazhdimësi gjerë me datën 16.10.2021, në vilat “G. ” në fsh. R. K. P., në bashkëveprim marrin pjesë në trafikimin e njerëzve ndaj të dëmtuarës K.G.j, duke e mashtruar, strehuar dhe duke e vënë në lajthim me qëllim të shfrytëzimit seksual për përfitime materiale në atë mënyrë që, fillimisht i pandehuri J.A.me dt. 12.10.2021 duke e mashtruar të dëmtuarën me pretendimin se kinse do ta marr për bashkëshorte, të njëjtën e vë në lajthim duke e marr në vendbanimin e saj në f. Ll. K. M., përderisa ishte i shoqëruar me dëshmitarin A.M.me veturën e tij xhip “N. ”, me ç’rast e dërgojnë në një vilë në M.dhe pasi që i pandehuri J. kryen marrëdhënie seksuale me të, të njëjtën ia vë në dispozicion edhe dëshmitarit A.M.pasi që paraprakisht e kishte paguar vilen i pandehuri J., e që

më pas komunikon me të pandehurin I.M., me qëllim të strehimit të të dëmtuarës tek vilat “G.”, për shfrytëzim seksual me qëllim të përfitimit material, ku paraprakisht ishin të vendosur të pandehurit I.M., E.Z., M. Xh. dhe M.I., e që me tu takuar që të gjithë përveç të pandehurës M. e cila kishte mbet në vila, në vendin e ashtuquajtur “H K.”, në f. R. K. P., fillimisht nga i pandehuri I. sigurohen tableta qetësimi “Lexilium” për të dëmtuarën K. e cila tani më ishte në veturën e të pandehurit në fjalë dhe me të tjerët e më pas te njëjtën e dërgojnë tek vilat, ku nga aty e njëjta del duke e shoqëruar vetëm i pandehuri M., ku ky i fundit kërkon nga të pandehurat M. dhe E. që të sigurojnë klientë të

ndryshëm nga nr. tel. ...-...-..., me ç rast këto të fundit e detyrojnë të dëmtuarën që të ketë marrëdhënie seksuale me pagesë me persona të ndryshëm, e në raste të caktuara edhe marrëdhënie seksuale në grup së bashku me të pandehurën M., në këmbim të të hollave në shuma prej 50 deri në 200€, të cilat janë dorëzuar tek të pandehurit M. dhe I., e më pas me të njëjtat janë bërë pagesat e vilave, ushqimit dhe transportit me kompaninë “L. T.” si dhe për nevoja personale, e që gjatë kësaj kohe i pandehuri J. komunikon nga numri i tij 043-727/568 në telefonin i cili e kishte në posedim i pandehuri M., duke i udhëzuar me fjalët: *“diqka mane naj dit bone naj pare e qoni en mA.shev”* ndërsa me datë 16.10.2021 pasi që i pandehuri I. e shfrytëzon seksuA.sht të dëmtuarën K., kjo e fundit merr kërcënime nga e pandehura E. e cila ishte në lidhje me të lartcekurin, dhe e njëjta duke mos gjetur zgjidhje konsumon 20 (njëzetë) tableta të qetësimit, ku si pasojë i keqësohet gjendja shëndetësore dhe po atë ditë i pandehuri M., së bashku me të miturat A. B. dhe J. K. si dhe me dëshmitarin P.E. si vozitës i kompanisë së lartcekur, e dërgojnë tek “Motel T.” në M. duke e vendosur në një dhomë, ku më pas shërbimi i këtij moteli thërret kompaninë e sipërshënuar që të kthehet e ta merr të dëmtuarën pasi nuk kishte arritur ta identifikonte, me ç’ rast e dëmtuara, më pas dërgohet tek shtëpia me një taksì privat, ku nga ana e familjarëve të saj dërgohet për kontroll mjekësore, meqenëse gjendja e saj psiko-fizike ka qenë jo e mirë.

-Me çka në bashkëveprim dhe në vazhdimësi kanë kryer veprë penale “trafikim me njerëz nga neni 165 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së,

I akuzuari M.I.: më parë dhe gjerë me datë 25.10.2021, rreth orës 14:00, në vilat “G. A” në f. R. K. P., i pandehuri në kundërshtim me nenin 4 par. 1 pika 1.1.9 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë: një pistoletë të llojit “.....”, me nr. serik .....-....., kA.bër . mm ..... dhe një karikator pa municion, në atë mënyrë që, ditën kritike pas një kontrolli të ushtruar nga ana e policisë sipas urdhrit të GJPP, i pandehuri në vendin e lartcekur dorëzon armën me të dhënat si më lartë, e cila ishte duke u mbajtur në pronësi në mënyrë të paautorizuar nga i lartcekuri.

-Me çka ka kryer veprën penale “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari M.I.: më parë dhe gjerë me dt.25.10.2021, rreth orës 14:00, në vilat “G. A” në f. R. K. P., përdor armën me gaz të lartcekur në kundërshtim me nenin 4 par.1 pika 1.1.9 (Ligji nr.05/L-022), në atë mënyrë që, përderisa i pandehuri ishte duke qëndruar në vendin e lartcekur, i njëjti ka përdorë armën duke shtëne me te njëjtën, me ç’rast nga ana e policisë gjatë kontrollit sipas urdhrit të GJPP janë gjetur gëzhoja të armës së lartcekur përgjatë oborrit të shtruar me kubëza si dhe përball hyrjes së vilave, ashtu që, 2 (dy) gëzhoja janë gjetur në veturën me targa ..-...-.. sipas dëshmisë #2, 5(pesë) gëzhoja në hapësirën e jashtme të motelit sipas dëshmisë #5,6,7,8,9, si dhe 14 (katërmbëdhjetë) gëzhoja brenda vilës nr. . sipas dëshmisë #11,12,13, 4(katër) gëzhoja sipas dëshmisë #14,15,16 dhe 2(dy) gëzhoja sipas dëshmisë #18,19, më pastaj

2 (dy) gëzhoja sipas dëshmisë D#25 tek hyrja e vilës nr. ., dhe një (1) gëzhojë tek banjo e vilës nr. . sipas dëshmisë #26 dhe kutia e armës sipas dëshmisë D#28 dhoma nr. .,

-Me çka ka kryer veprën penale “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari I.M.: më parë dhe gjerë me datë 25.10.2021, rreth orës 14:00, në vilat “G. A” në f. R. K. P., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par. 1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll të paautorizuar, dhe atë: një pistoletë të llojit “..... ..”, kA.bër ....mm, me nr. serik ..... së bashku me një karikator të zbrazët, në atë mënyrë që, ditën kritike pas një kontrolli të ushtruar nga ana e policisë sipas urdhrit të GJPP, i pandehuri përderisa ishte duke qëndruar në vilën nr. . nga aty me të vërejtur prezencën e Policisë në oborrin e vilave në fjalë, i njëjti hedh nga dritarja pistoletën cal. 6 mm, e cila ishte duke u mbajtur në pronësi në mënyrë të paautorizuar nga këtu i pandehuri.

-Me çka ka kryer veprën penale “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari I.M.: Më parë dhe gjerë me datë 25.10.2021, rreth orës 14:00, në vilat “G. A” në f. R. K. P., përdorë armën e lartcekur në kundërshtim me nenin 5 par.1 të

Ligjit për Armë (Ligji nr.05/L-022), në atë mënyrë që, përderisa i pandehuri ishte duke qëndruar në vendin e lartcekur, i njëjti ka përdorë armën duke shtënë me të njëjtën, me ç’rast nga ana e policisë gjatë kontrollit sipas urdhrit të GJPP janë gjetur gëzhoja të armës së lartcekur përgjatë oborrit të shtruar me kubëza si dhe përball hyrjes së vilave, ashtu që, dy gëzhoja janë gjetur sipas dëshmisë #4 dhe #21 tek hapësira e jashtme e motelit, një gëzhojë brenda vilës nr.. sipas dëshmisë #17, një gëzhojë në hapësirën e jashtme të motelit mes vilës . dhe . sipas dëshmisë#22.

Me çka ka kryer veprën penale “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Të akuzuarit I.M. dhe M.I.e pranuan fajësinë secili veç e veç për veprën penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari M.I.ka pranuar fajësinë edhe vepër penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së. Për këto vepra penale gjykata nuk do të lëshohet në arsyet e aktgjykimit.

Të akuzuarit nuk e pranuan fajësinë për veprën penale “trafikim me njerëz” nga neni 165 par.1 të KPRK-së ndërsa i akuzuari I.M. nuk e pranoi fajësinë për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së.Në vazhdim gjykata do të paraqet arsyet e aktgjykimit vetëm sa i përket këtyre dy veprave penale.

#### *Fakte jo kontestuese*

Gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk u kontestuan faktet: se i akuzuari J. kishte shkuar në M. e kishte marrë të dëmtuarën me automjetin e tij pas një bisede me snap, nuk u kontestua i akuzuari J. ishte me dëshmitarin A.M.dhe në një hotel në M.kishin pas marrëdhënie seksuale që të dytë me të, nuk u kontestua se e kishin dërguar në vila në Gj., nuk u kontestua nuk u kontestua dërgimi i të dëmtuarës te vilat G. A në R..



### *Fakte kontestuese*

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nga të gjithë të akuzuarit u kontestua kryerja e veprës penale të trafikimit. U kontestuan të gjitha faktet rreth marrjes së të dëmtuarës nga të akuzuarit dërgimi i saj kundër vullnetit tek vilat G.-, u kontestua detyrimi i të njëjtës për të kryer marrëdhënie

seksuale, u kontestuan faktet rreth dhënies së marihuanës të dëmtuarës dhe të gjitha faktet e tjera lidhur me këtë veprë penale të përshkruar si në dispozitivin e parë të aktakuzës.

Nga i akuzuari I. u kontestuan po ashtu të gjitha faktet lidhur me përdorimin e armës tek vilat G.-. si në dispozitivin e pestë të aktakuzës.

### *Provat që vërtetojnë gjendjen faktike*

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u kontestua koha përkatësisht data e kryerjes së veprës penale dhe vendi i kryerjes së veprës penale, mirëpo gjykata i vlerësoj zyrtarisht dhe nga provat e administruara veçanërisht nga deklaratat e të dëmtuarës dhe raporti i vendit të ngjarjes fotodokumentacioni, gjë që rezulton se vepra penale u vërtetua se është kryer nga dt.12.10.2021 e gjer me dt.16.10.2021 në vendin Vilat G.-. në f. R. K. P..

Nga deklaratave të dëmtuarës K.G.të dhënë para gjykatës dhe në procedurë paraprake në polici me datë 22.10.2021 si dhe në prokurori me datë 17.11.2021 u vërtetua se e njëjta ishte njoftuar me të akuzuarin J.A.nëpërmes telefonit snap-chat. E njëjta kishte lënë takim me të njëjtin ku dhe i akuzuari J. kishte shkuar dhe e kishte marrë të njëjtën me dt. 11.10.2021 në vendbanimin e saj në f. L. K. e M., i njëjti kishte shkuar bashk me dëshmitarin A.. E njëjta kishte qenë me vëllain e saj i cili ishte i moshës së mitur, nuk kishte pas telefonin me vete. Pasi që e kanë marrë janë e kishin dërguar në një vilë-hotel në M., i akuzuari J. e paguan vilen dhe ka kryer marrëdhënie seksuale me të. J. e kishte kërcënuar se nëse i tregon policisë ke me qenë e vdekme. Nga deklaratat e saj u vërtetua se i akuzuari J. e kishte dërguar tek të akuzuarit I. dhe M.I.dhe kur të njëjtën e kishin marrë në automjet me ta kishte qenë edhe E.. dhe gjatë rrugës ishin ndal diku dhe kishin përdorë narkotik dhe kësaj E. i kishin dhënë për të pirë marihuan dy tima bari dhe e njëjta ishte trulluar. Pastaj të njëjtën e kanë dërguar në Vilat G.-. në f. R.. E njëjta ishte e lirë me dal, kishte qenë e kërcënuar nga M. dhe I. M. e madje një herë e kishte goditur me shuplak. Kur kishin dal për të shkuar te L. e kishte E. me vete dhe A. dhe kur ka shkuar në banjo E. i kishte shkuar pas, do të thotë e ka ruajt. M. i ka thënë nëse del të rrahim.

Një herë M. ia ka djeg duar me cigare kur nuk ka pranuar të ketë marrëdhënie seksuale me dikun. Gjatë asaj kohe sa ka qëndruar në vila të akuzuarit M., I. por edhe E. dhe M. kanë siguruar klient dhe kanë detyruar të ketë marrëdhënie seksuale me ta. Gjatë asaj kohe ka pasur marrëdhënie seksuale me disa persona të cilët kanë paguar nga 50 deri 100 euro këtë dhe kur ishte në grup deri në 200 euro dhe ato iu dorëzoheshin Ismeiti dhe M.. U vërtetua po ashtu se E. ju siguronte klient nëpërmes të telefonit dhe ajo kishte lidhje dashurie me I. ndërsa M. përveç se siguronte klient edhe vetë kryente marrëdhënie seksuale. Telefoni përmes të cilit siguroheshin klientët-përsona të ndryshëm dhe po ashtu kryenin edhe shërbimet e tjera ka qenë i M. por me të janë shërbyer të gjithë do të thotë se përveç M. e ka përdor edhe E., I. dhe M.. I akuzuari I. e kishte shfrytëzuar edhe seksuA.sht dhe pa dëshirën e saj. E njëjta kishte pi hapa pi për me shku sa më shpejtë në shtëpi e kjo kishte ndodhur me dt.16 kur edhe kishte pasur marrëdhënie edhe me I..

E dëmtuara pas denoncimit të rastit është kërcënuar nga familjarë të akuzuarve dhe atë të akuzuarve I. dhe M. duke i thënë me hek denoncimin dhe ka sjell provat.

Në të gjitha këto pjesë të deklaratave e dëmtuara- dëshmitare K.G.kishte deklaruar në mënyrë të njëjtë si me rastin e dhënies së deklaratës në polici në prokurori dhe para gjykatës. Andaj gjykata këto pjesë të deklaratave i mori për bazë dhe ia fA. besimin.

E dëmtuara kishte mospërputhje të deklaratave me rastin e dhënies së deklaratës në prokurori nga deklarata e dhënë para gjykatës dhe në polici. E njëjta në prokurori ndër të tjera ka theksuar se ..nga Gj. J. e ka dërguar të shtëpia e tij ku pastaj i njëjti me vëllain e tij Sh. e kishin dërguar sërish në Gj., ku e kishin lënë në një vend të pompa H. dhe pastaj kishte shkuar në stacion, pastaj e njëjta ishte marrë serish nga i akuzuari J. dhe të akuzuarit e tjerë I., M. dhe G...., para gjykatës thekson se J. nuk ka qenë fare në Stacion të autobusëve në G. dhe nuk e di se si I., M. dhe E. ta kenë ditë se ka qenë aty, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici e njëjta kishte theksuar se nga Vilat ku e kishin lënë në Gj. kur ka ardh koha me e leshu vilen ka dal vetë ka shkuar deri te H. petrol ku ka hy ka pi ujë dhe pastaj ka vazhduar për stacion të autobusëve dhe aty në rrugë është takuar me I., J. M. dhe G. dhe i kanë thaën hajde me neve se po të qojna në shpi, kam hyp në kerr kemi vazhdu rrugën dhe jemi ndal në një mal edhe kanë dhez bari kanë pi të katërtit, G. ia ka afru dhe i ka dhnë merri ngehy nja dy tima dhe pasi që i kam pi jam trollu dhe pasi që jam zgju me ka ardh vetëdija dhe e ka pa vetën në disa villa ....Për rrethanat se a kishte shkuar e dëmtuara apoo jo tek shtëpia e të akuzuarit J. nëse kishte shkuar, Kjo pjesë nuk ishte relevante. Nga se relevante ishte çfar kishte bërë i akuzuari J., ku e kishin dërguar dhe a kishte njohuri se çfar po ndohdte me të. Kjo u vërtetua nga deklarata e të dëmtuarës dhe vetë të akuzuarve ku të njëjtji pranojnë se kanë qenë M., I., J. dhe E. të gjithë në një automjet kur të dëmturaen e kanë dërguar të vilat G.-. edhe pse japin një version ndryshe për rrethanat e dërgimit të dëmtuarës në vilat G.- A. Se J. ka qenë prezent kur e kanë dërguar në vilat G. – të dëmtuarën e vërteton edhe deklarata e të akuzuarës M. e cila thekson se “kur e kanë pru K. në Vila J. ka thënë merreni boni çka të doni me të”. Në anën tjetër e dëmtuara në një moment në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se nuk i kujtohet fare se çark ka deklaruar në prokurori edhe pse qëndron pranë të njëjtës.

Marrë parasysh të gjitha provat e administruar deklarimit të dëmtuarës gjykata ia fA. besimin, nga se e njëjta në të gjitha deklaratat përshkruan njëjtë sidomos ngjarjen prej kur i kanë përdorur substancë narkotike dhe e kanë dërguar në Vilat G.-. dhe qëndrimin në ato vila

-Nga deklarata e dëshmitarit H. J. të dhënë para gjykatës vërtetohet se punonte në L. dhe i kishte ardhur mesazhi nga firma L. duhet me shku te vila G. nr. 6 në R. ku ka shkuar. Një djalë kishte shkuar para veturës së tij i ka thënë a bon me dërgu në M., ky i ka thënë jo se i përfundon orari i punës. E ka njoftuar bazën dhe ata i kanë thënë prano pasagjerin deri në bazë dhe tani e merr tjetri shofer e qon deri në M. për shumën prej 35 eruo. Pra nga kjo deklaratë e dëshmitarit u vërtetua se të dëmtuarën e kishte marrë nga vilat G.- . në R. dhe e kishte dërguar deri te baza, e njëjta ishte ndihmuar nga dy vajza të tjera.

-Nga dëshmia e dëshmitarit P. H. e dhënë në polici me datë 27.10.2021, si dhe në prokurori me datë 16.12.2021 dhe para gjykatës u vërtetua sy ky për të akuzuarit kishte kryer shërbimi duke ju dërguar bukë dhe duke i dërguar atje ku ju kanë thënë sipas kërkesës së tyre. Me dt.16.10.2021 e kishte marrë M.n te vilat G. bashkë me dy jaza me A. dhe një tjetër, ndërsa të dëmtuarën e ka marr në bazë dhe kërkesa e M.t ka qenë me dërgu këtë vajzën në M.. E dëmtuara dukej si e

mërzitur ku i njëjti decidivisht thekson “gjendja e vajzës nuk dukej shumë e mirë dukej e mërzitur më tepër nuk dinë”. E ka dërguar vajzën te vilat

në periferi të M.. Edhe M. dukej nervoz dhe se M. kishte thënë se jam kanë tu ia pa sherrin ta dërgojmë deri në M..( Lidhur me këtë dëshmitari ishte pyetur në mënyrë të tërthorta lidhur me video incizimet te baza e L. T. ku Prokurorja e pyet: se në vido-incizimet shihet se ju keni pranuar një vajzë... gjë që nuk ishte kontestuese se e ka pranuar të dëmtuarën për ta dërguar në M.).

Gjykata deklaratës së këtyre dëshmitarëve ua fA. besimin dhe e mori për bazë pasi ishte në përputhje me deklaratat e tyre të dhëna më parë dhe nuk ishte kontestues as fakti se e dëmtuara ishte marrë nga vilat G.-. ishte dërguar deri te Baza e L. t.pastaj ishte dërguar të disa vila në M.dhe se gjendja e të dëmtuarës nuk ishte e mirë.

-Nga dëshmia e dëshmitarit A. M.. vërtetohet se ishte pronar i vilave T. dhe me dt.16.10.2021 L. T. kishte hyrë dhe shkuar te dhoma nr., nga se vilat janë me garazhda. Aty ishte lënë e dëmtuara dhe se njëjta nuk kishte letërnjoftim, e ka thirr L. T. dhe me kërkesën e tij të njëjtit janë kthyer dhe me një taksit tjetër e kanë marrë të dëmtuarën dhe përveç shoferit të taksit me të ka qenë edhe një djalë. Shofer i taksit tjetër ishte dëshmitari R.. Gjykata dëshmisë së këtij dëshmitari ia fA. besimin meqë është në përputhje edhe me provat e tjera materiale dhe vërtetohet se e dëmtuara ishte lënë e vetme në Vilat T. në M..

-Nga dëshmia e dëshmitarit R.B. gjykata ka vërtetuar se ishte me profesion taksist dhe e kishte marrë të dëmtuarën nga Villat T. dhe e kishte dërguar në f. Ll., ku paraprakisht dy persona kishin shkuar e kishin pyetur për çmimin dhe ju kishte thënë se kushtonte pesë euro, të njëjtën e kishte dërguar deri aty ku i kishte thënë.

-Nga deklarata e dëshmitarit L.G. që është vëllai i të dëmtuarës vërtetohet se e dëmtuara në shtëpi nuk kishte qenë për katër ditë e kishin kërkuar te shoqet e kanë kërkuar nëpër M., por pas katër ditëve nuk e ka pa kush e ka sjell por ka trokit në derë dhe kur ka dal e ka pa rat në tokë, gjendja e saj ka qenë si pa vetëdije dhe nuk ka mundur as me fole, nuk ka mundur me u qu me hi brenda. E ka shti brenda e ka thirre policinë ata i kanë thënë dërgoje në emergjencë ku dhe e kanë dërguar për ndihmë mjekësore, po ashtu u vërtetua se familjarët e të akuzuarve kishin dërguar njerëzë me qellim të ndikimit në të dëmtuarën për ndrrimin e deklaratës dhe u kishin ofruar të holla. Gjykata dëshmisë së këtij dëshmitari ia fA. besimin dhe se ishte e njëjtë po thuajse në të gjitha deklaratat e dhëna më parë.

-Nga deklarata e dëshmitares J. K. e dhënë në polici me datë 02.11.2021 e të lexuar në shqyrtim gjyqësorë vërtetohet se e njëjta e njihte K.G.j dhe e kishte takuar te vilat G. . kur edhe e kanë dërguar për M., të njëjtën e njihte me emrin V. e ka dëgjua se është nga M.. Kjo ka qenë me M. dhe A. si dhe taksisti me emrin P. kur e kanë dërguar K. në M.. Taksi ka qenë L.. E njëjta gjatë kohës sa ka ndej në taksi nuk ka fol ka pi cigare dhe ka qenë si e pit. Kur kanë shkuar në M. kanë shkuar te do vila me taxi kanë hy në garazh dhe M. ka dal i ka ndihmu me dal pasi ajo menxi delke se ishte si e pitë. E kanë lon aty dhe janë nis për P., pas 5 ose 10 minuta taksistin e ka thirr baza i ka thanë kthehu me marr atë qiken qe e keni lanë në vila. M. dhe P. kanë dal e kanë shti në një taksi dhe i kanë thanë me dërgu të shtëpia e vet. Gjatë qëndrimit në vila nuk ka pa persona të tjerë përveç personit që i ka pastru.

Gjykata këtë pjesë të deklaratës e mori për bazë dhe nga kjo u vërtetua se gjendja e të dëmtuarës nuk ishte e mirë dhe se kjo me M. dhe A. kishin qenë me të kur e kanë dërguar për

M.. Në këtë pjesë deklarata e kësaj dëshmitares përputhet edhe me provat e tjera të administruara. Pjesën tjetër ku e njëjta thekson se nuk ka pa njerëz të tjerë në vila G. në R., gjykata nuk e mori për bazë pasi që e njëjta deklaroj se ka qëndruar në vila ka dy deri në tri orë dhe në anën tjetër me provat e tjera të administruara u vërtetua e kundërta.

-Nga deklarata e dëshmitarit H.S. e dhënë në polici me datë 26.10.2021, si dhe në prokurori me datë 15.12.2021 dhe së fundi në gjykatë, vërtetohet se Vilat G.- i kishte marrë me qera nga pronari V.A. e kanë pas si biznes familjarë, kanë qenë funksionale vetëm vilat ,,.,,.. Veturat të cilat kanë ardhur në vila i kanë regjistruar vetëm targat e tyre, i njëjta I.M. dhe M.I. dhe M.Xh. ndërsa J. A. dhe E.Z. i ka njohur vetëm me i pa por emrat nuk ua dinte, i ka pa meqë ky ka punuar në reception dhe kur ata kanë paguar qoft vilat dhe kur kan marrë pije. I. e ka marrë vilen .. ose ., M. vilen nr. ., ndonjë herë ka paguar Imeti ndonjëherë e ka dërguar atë vajzën E., dy tri ditë I. e ka marrë edhe një dhomë tjetër, M. e ka paguar villen për 24 orë 15 eruo, I. kur ka ardhur vetëm në mbrëmje e ka paguar 10 euro. M. ka qëndruar në villen numër . me dy vajza,. Vërtetohet se M., E. dhe ajo vajza me flokët të zeza ka qenë e lirë me dalë dhe ka ndodhë ndonjëherë M. dhe I. nuk kanë qenë aty dhe M. ka kërkuar para ka shkuar në P. dhe është kthyer.

-Nga deklaratave dëshmitares M. S. e dhënë në polici me datë 03.11.2021, si dhe në prokurori me datë 15.12.2021 dhe së fundi para gjykatës vërtetohet se punonte rreth tri orë në vilat G. dhe atë kur bashkëshorti i saj kishte shkuar për të pushuar. Villat me qera i kishte marrë disa I. dhe disa të tjera i kishte marrë M., se vilat i kanë paguar I. dhe M.. Ndërsa kanë qenë edhe të akuzuarit E. dhe M. të cilave ju drejtohet “si vajzat”nuk e di se a kanë paguar.

Gjykata ia fA. besimin pjesërisht deklaratave të dëshmitarve H. S. dhe M. S. pjesërisht siç u cek më lartë nga se u vërtetua se vilat G.-. ishin marrë me qera nga i akuzuari I. dhe i akuzuari M., dhe bashkë me të njëjtit në vila qëndronin edhe të akuzuarat E. dhe M..

Dëshmisë së dëshmitarit H. dhe M.S.nuk ua fA. besimin në pjesë ku theksojnë se nuk ka pa persona të tjerë në vila, madje dëshmitari H. deklaroi se nuk e ka pa as të dëmtuarën K.G., pasi që nuk ishte në përputhje me provat e tjera të administruar. Sepse të njëjtit ishin mbikëqyrës të vilave kujdeseshin për pastrimin dhe çdo automjet që vinte kalonte nëpërmes rampës gjë që ka pas mundësi me pa së paku kA.min me automjeteve. E në anën tjetër me deklaratën e K.G.dhe provave të tjera u vërtetua në mënyra të pa kontestuar se e dëmtuara K.G.ishte në vila përafërsisht rreth katër ditë dhe se pronarët kishin njohuri, madje u vërtetua se kishin njohuri edhe mosmarrëveshjet që kishin ndodh në mesë të dëshmitarit B. dhe të akuzuarve I. dhe M. dhe pronari u kishte thënë se do tua thirri policinë, këtë e konfirmuan e dëmtuara K. dhe e akuzuara M..

-Nga deklarata e dëshmitarit B.T. të dhënë para gjykatës, në polici me datë 01.11.2021, si dhe në prokurori me datë 16.12.2021, vërtetohet se bashkë me nipin e tij V. O. ka biseduar në telefon me M., kanë shkuar te vilat G. në R. e ka paguar vilen 10 euro, kanë qëndruar 10-15 minuta ku kishte ardhur M. me një shoqe në këtë rast e konfirmon se është e dëmtuara K. dhe nipi i tij i ka thënë asaj shoqes se mundesh me u largu se je e mitur, dhe se nipi i tij ia kishte dhënë M. 200 euro për të kryer marrëdhënie seksuale në grup, pastaj ishte larguar M. dhe nuk ishte kthyer, ky ka

dal dhe ka pa M. duke hyrë në një vil dhe ka shkuar ka trokitur aty kanë dalë bashkëfshatarët e tij, me të cilët ishin fjalosur. M. ka pas një brisk të cilin nipi i tij ia kishte marrë dhe janë larguar nga aty.

Gjykata dëshmisë së këtij dëshmitari ia fA. besimin dhe ishte në përputhe me provat e tjera administruara. Ky dëshmitar gjatë deklarimit të tij në seancë kishte disa mospërputhje mirëpo pas ballafaqimit me deklaratën e tij i njëjti qëndron pran deklaratës që ka dhënë në polici dhe prokurori.

-Nga dëshmitë e dëshmitarit A.M.të dhëna në polici me datë 26.10.2021, si dhe në prokurori me datë 10.12.2021 dhe së fundi para gjykatës u vërtetua se i njëjti të akuzuarit J., I. dhe M. ndërsa M. dhe E. nuk i ka njohur. Nga dëshmia e tij u vërtetua e njëjti të dëmtuarën K.G.dhe kishte qenë me J. kur kishin shkuar në M. dhe e kishin marrë dhe se ishin ndal te një vill ku J. kishte kryer marrëdhënie me të ndërsa edhe ky kishte pas marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën.

-Nga raporti i ekspertimit me numër .../....-..../-.... i datës 31.01.2023, i cili ka të bëjë me ekzaminimin bA.stike, dëshmia e evidentuar D#1 është një pistoletë .... model .... e kA.brit .mm me gas me numër serik .....-....., po ashtu dhe një karikator i zbrazët për pistoletat me gaz .... dhe dëshmitë e evidentuara D#2,D#5, 6,7,8,9, D#11,12,13,14, 15,16,18,19, 25, 26 janë tridhjetë gëzoja pjesë të fishekëve të kA.brit .mm me gas, të shkrepura .... model .... do të thotë nga dëshmia-ama D#1. Kanë të bëjnë me të akuzuarin M.I., andaj nuk u lëshua në elaboratin e tyre meqë e ka pranuar fajësinë.

-Nga ekspertiza .../....-..../-....i datës 31.01.2023 vërtetohet se Dëshmitë e evidentuara D#4,D#17,D#21,D#22 janë katër gëzhoja pjesë të fishekëve të kA.brit ....x..mm janë gjuajtur-shkrepur nga pistoletat C. Z. kA.bër ....x..mm me numër Serik ..... e sjellë si dëshmia D#20. Dëshmia e evidentuar D#10 është një plumb i dëmtuar pjesë e fishekut të kA.brit ....x..mm është gjuajtur-shkrepur nga pistoletat Ceska Zbrojovka, kA.bër ....x..mm me numër Serik C81859 e sjellë si dëshmia D#20. E në dëshminë D#20 janë të evidentuara një pistoletë Ceska Zbrojovka Vzor 50 e kA.brit ....x..mm me numër serik ..... dhe një karikator i zbrazët me kapacitete prej tetë fishekëve i dizajnuar për pistoletat C. Z. V. ... Arma është funksionale dhe nuk është zbuluar përputhshmëri me rast të tjera të Hapura.

-Nga Procesverbal mbi kontrollin e shtëpisë, banesës, lokaleve tjera dhe personave i datës 25.10.2021, lista e armëve të konfiskuara i datës 25.10.2021, vërtetohet se me dt.25.10.2021 Në vilën nr. . ku kanë qenë duke fjetur I.M. dhe E.Z., I t i është sekuestruar një armë pistoletë c. Z. cal .... mm me nr. Serik ..... dhe një karikator i zbrazët. Ndërsa në vilën nr. . ku kanë qenë duke fjetur M.Xh. dhe A. B., A. i është sekuestruar një sasi e vogël e marihuanes Bari rreth ... gram.

-Nga lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës me nr. ....-....., dhe fotografit vërtetohet se dëshmitë e gjetura në venin e ngjarjes përfshirë armën C. Z. cal .... mm me nr. Serik ..... dhe një karikator i zbrazëtë përgjatë oborrit te shtruar me kubëza si dhe përball hyrjes së vilave, ashtu që, dy gëzhoja janë gjetur sipas dëshmisë #4 dhe #21 tek hapësira e jashtme e motelit, një gëzhojë brenda vilës nr. . sipas dëshmisë #17, një gëzhojë në hapësirën e jashtme të motelit mes vilës . dhe . sipas dëshmisë #22.

Nga të gjitha këto vërtetohet se i akuzuari I.M. kishte përdor armën e cekur duke shtënë me armë në oborrin e vilave ku edhe janë gjetur dëshmitë të cilat i përkisnin armës që posedonte i akuzuari

I.M., andaj të gjitha pretendimet e të akuzuarit dhe mohimit të fajësisë për veprën penale të përdorimit të armës e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë të pa bazuara.

-Nga raporti i ekspertimit me numër .../....-...i datës 05.05.2021 i cili ka të bëjë me ekzaminimin e telefonave të sekuestruara nga ana e të pandehurve M. Xh., J.A.dhe I.M., i cili raport ka të bashkangjitur edhe raportet e oficerëve sa i përket të gjeturave nga ky ekzaminim, vërtetohet se dëshmia D#2 telefon IPHON . P., ngjyrë e zezë me numër të ....-.....kodi i qasjes në pajisje ..... i cili posedon Sim kartel me numër Srik ..... në pronësi të M. Xh.. Dëshmia D#1 Telefoni IPHON . p. ngjyrë e bardhë, me numër të I....-....., kodi i qasjes në paisje .... i cili posedon SIM kartel me numër serik ..... në pronësi të dyshuarit I.M. dhe D#3 telefon IPHON . ngjyrë e bardhë me numër të .....-....., kodi i qasjes në paisje ..... nuk posedon SIM Kartel në pronësi të dyshuarit J. A. i kanë dërguar për Ekzaminim në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, në bazë të urdhërësës të Gjykatës Themelore në P. Departamenti i Krimeve të rënda me numër UGJK.nr.164/2021. Nga ekspertiza rezulton dëshmia D#1 IPHON . p. nuk është ekzaminuar sepse ka qenë i mbrojtur

me paskod të panjohur dhe pajisjet e tyre që ata i kanë në përdorim nuk kanë arritur ta tejkalojnë këtë masë sigurie. Gjithashtu edhe Sim Kartela Ipko ka qenë e mbrojtur me pin-kod të panjohur për ta dhe nuk është ekzaminuar. Dëshmia D#2 sipas ekspertizës rezulton të jetë IPHONE . p. model ..... me numër serik me numër të ....-.....e jo siç është shënuar IPHONE ., është ekzaminuar dhe ka rezultuar me të gjetura si kontakte thirrje SMS mesazhe, foto-imazhe audio dhe video fajlla, kurse nga aplikacionet e instaluara si viber dhe Instagram nuk ka të gjetura komunikime. Sim kartela nuk ishte ekzaminuar sepse ka qenë e mbrojtur me pin-kod të panjohur dhe nuk kanë arritur ta tejkalojnë kodin e sigurisë me pajisjet e tyre që i kanë në përdorim. Dëshmia nr. 3 Ihone . është ekzaminuar dhe ka rezultuar me të gjetura si kontakte, thirrje .., mesazhe, audio dhe video fajlla, kurse nga aplikacionet e instaluar si tik-tok dhe Wats App ka të gjetura komunikime, ndërsa aplikacionet të cilat kanë qenë të instaluara në telefon si Viber, Instagram dhe Facebook Messenger nuk kanë qenë aktive. Të gjeturat janë ruajtur si dëshmi.

Në telefonin e evidentuar si dëshmi D#2 kishte komunikime të shumta telefonike përmes rrjeteve sociale që kryesisht bisedat janë me persona të ndryshme telefoni për qasje në paisje është me emër e M. apo shira ..... Në telefon është gjetur një foto që paraqet bisedën në mes të dyshuarve J.A.dhe njërit nga të akuzuarit M.I.apo I.M. sepse shifet se biseda bëhet me person të gjinisë mashkullore të bërë në rrjetin social Wats App e bërë screenshot “pamje na Ekran” biseda shifet se është nga numri i telefonit ..... numër ky në posedim të akuzuarit J. A.. Biseda fillon: nga telefoni i M.s: “*stbojnë keq jaranat*”, “*tkallxova*”, pastaj përgjigja nga numri i J. A.: “*si diçka mane naj ditë bone naj pare e qoni en M.*”, nga telefoni i M.: “*po de ashtu ka dojm*”, nga numri i J. Ahmagjekaj: “*nshpirt kuj ki gjall e dekun babb mos i boni naj sen*”, “*se mfik bab*”, nga telefoni i M.: “*mos t han k., sikur përveti, s”mendoj kurr met bo keq, shlir rri*”, nga numri i J. A.: “*Si diçka bab veq qoni en m. mos u merrni me too*”, nga telefoni i M.:” *po de, u ba pra nihem*”.

Nga kjo vërtetohet se i akuzuari J. kishte biseduar me të akuzuarit M. apo I. nga se i ishte drejtuar me “bab “ gjë që kuptohet se kishte komunikuar me person të gjinisë mashkullore e që këtë telefon te M.s e përdornin përveç të akuzuarat M. dhe E. edhe të akuzuarit M. dhe I., ku përgjigja i kthehet se “nuk të bajnë keq jaranat që bab” kuptohet se ishte duke biseduar me të akuzuarit. Pra i akuzuari J. kishte dijeni për qëllimin e dërgimit të dëmtuarës në vila nga se ju thotë “majeni boni ndonjë pare pataj dërgojeni në M.”.

-Nga raporti i hetuesit A. P. i datës 12.07.2022 i cili konkretisht ka sqaruar të gjeturat e ekzaminimit të telefonit i cili ka qenë i evidentuar në emër të M.Xh., vërtetohet se kishin anA.zuar material. e nxjerrë nga ekzaminimi telefonik të cekura më larët, ku përshkruan se kishin hasur në materiale të ndryshme mesazhet e lartcekura, pastaj biseda me klienten ku në këmbim të marrëdhënieve seksuale kishin kërkuar substancë narkotike, si dhe disa foto ku shihen persona me substancë të bardhë e cila dyshohej se ishte kokainë. Mirëpo kjo nuk ishte objekt shqyrtimi.

-Nga raporti i oficerit A. P. i datës 27.05.2022 i cili i është dorëzuar Gjykatës si dëshmi të presionit dhe komunikimeve kontakteve që u kanë bërë familjes së të dëmtuarës nga familjarët e M.I., dhe dëshmitë të cilat janë dorëzuar nga ana e të dëmtuarës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 21.11.2022 e të cilat janë konstatuar në faqen 6 për 13 kur është dhënë fjala hyrëse e palëve dhe atë një porosi me zë, foto e siguruar nga rrjet snap-chat të bisedës gjegjësisht të mesazheve të dërguara, konstatohet se nga të akuzuarit nëpërmes familjarëve të tyre e sidomos nga familjarët e të akuzuarit M. është bërë presion me qëllim të ndërrimit të deklaratave.

-Nga raporti mjekësor në emër të K.G.e datës 16.10.2021 i lëshuar nga QKMF në M., vërtetohet se e njëjta kishte gjendje të rënduar shëndetësore për çka edhe i kishin dhënë ndihmën mjekësorë.

-Nga raporti mbi ekzaminimin e dëmtuarës nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore M...-... i datës 04.11.2021 vërtetohet se e dëmtuara ishte dërguar për tu ekzaminuar lidhur me substancat narkotike me mostra të gjakut, mirëpo anA.za e tillë pemës mostrës së gjakut sipas eksperteve nuk është e përshtatshme substancat e tilla metabolizohen dhe eliminohen shpejtë dhe në këtë rast kishin kaluar afër 20 ditë. I ishte bërë testi me urinë dhe kishte rezultuar negativ, ndërsa i është marr mostra e flokut dhe i është dorëzuar zyrtarit policorë pasi anA.za e tillë nuk kryhej në Institutin e mjekësisë ligjore.

Sipas njoftimit të zyrtarit policorë të dt.08.11.2021 ekzaminimi i fijes së flokut nuk ishte bërë nga se nga zyrtarët e Agjencisë së Kosovës për Forenzik janë njoftuar se nuk ky ekzaminim nuk mund të bëhet pasi nuk bënë kesi lloj ekzaminimi.,

-Nga foto e shkëputur nga moteli T. si evidencë e hyrje-dalje të taksit L. të datës 16.10.2021 dhe deklarata e të miturës L.K e dhënë në polici me datë 25.10.2021, vërtetohet se e njëjta ishte dërguar dhe ishte lënë në vilat T. në M., me çka vërtetohen deklaratat e të dëmtuarës dhe dëshmitarëve A. M., dhe P. H..

-Vërtetimet 1,2,3 mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të cilat nuk përmbajnë datë, raporti i oficerit B. M. #... i datës 26.10.2021, vërtetohet se të njëjtëve u ishin konfiskuar telefonat e cekur si më lartë dhe automjetet.

-Nga raporti i datës 25.10.2021 bëhet një përshkrim veprimet hetimore nga zyrtari policorë A.P. në drejtim të zbulimit të rastit.

-Nga foto dokumentacioni si pjesë e shkresave të lëndës vërtetohet vendi se ku kishin qëndruar të akuzuarit dhe provat që ju janë gjetur. Si dhe gjendjen përkatësisht pamja e të dëmtuarës dhe gjendja e saj në të cilën ishte si dhe disa lëndime në dorë, për të cilat nuk kemi ndonjë raport të eksperti mjeko ligjor.

-Nga Raporti i oficerit A. P. i datës 27.05.2022, dëshmitë të cilat janë dorëzuar nga ana e të dëmtuarës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 21.11.2022 kur është dhënë fjala hyrëse e palëve dhe atë një porosi me zë, foto e siguruar nga rrjeti snap-chat të bisedës gjegjësisht të mesazheve të dërguara, vërtetohet se nga të akuzuarit ishte ndikuar në të dëmtuaren me qëllim të ndërrimit të deklaratave gjë që u vërtetua edhe nga dëshmitari L.G. vëllai i të dëmtuarës.

*Provat-dëshmitë që gjykata nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes së kësaj çështje*

-Gjykata vlerësoj deklaratën e dëshmitarit P.T. të dhënë para gjykatës dhe në polici me datë 01.11.2021, si dhe në prokurori me datë 16.12.2021, ku ka dëshmuar për një borxh që i njëjti ia kishte I. pasi i kishte blerë disa dru, parat i kishte dërguar në vila te G. .. Gjykata vlerëson se është jo relevante, i njëjti edhe mund ti ketë pasur borxh, por kjo rrethanë nuk vërtetohet ndonjë fakt të rëndësishëm për këtë çështje, andaj nuk e mori për bazë.

Gjykata ka vlerësuar deklaratën e N. Gj. A. e cila ishte njerka e të akuzuarit J. dhe ka deklaruar se e dëmtuara kishte shkuar në shtëpinë e tyre, mirëpo kjo rrethanë për gjykatën nuk është relevante, a kishte qenë e dëmtuara apo jo në shtëpinë e të akuzuarit J. apo si kishte shkuar, relevante ishte sa çfarë kishte bërë i akuzuari J. me të dëmtuarën ku e kishte dërguar, rrethana këto për të cilat dëshmitarja N. nuk kishte njohuri, pasi që deklaroi se J. nuk ishte kthyer atë natë deri vonë dhe as të nesërmen nuk e kishte pyet. Andaj edhe gjykata vlerësoj si jo relevante dhe nuk e mori për bazë me rastin e vendosjes së kësaj çështje.

-Gjykata e vlerësoj deklaratën e dëshmitares A. B. dhënë në polici me datë 25.10.2021, e të lexuar në shqyrtim gjyqësor dhe e njëjta nuk e mohon që ka qenë në vila mirëpo mohon të ketë parë të dëmtuarën apo persona të tjerë. Andaj gjykata dëshmisë së të njëjtës nuk ia fA. besimin meqë nuk e tregonte të vërtetën dhe ishte në kundërshtim me provat e tjera të administruara.

Gjykata ka vlerësuar edhe deklaratën e dëshmitares L. K. e dhënë në polici me dt.25.10.2021 e lexuar në shqyrtim gjyqësorë dhe ka vlerësuar se e njëjta është jo relevante, pasi që ka deklaruar se nuk e njeh të dëmtuarën e cila i është treguar në fotografi, nuk ka shkuar në vila krejt dy tri herë me M. pasi që ishte në lidhje me të.

*Vlerësimi i mbrojtës së të akuzuarve*

Gjykata ka vlerësuar mbrojtën e të akuzuarve secilit veç e veç në raport me provat e administruara dhe deklaratat e tyre të mëparshme të dhëna në procedurë paraprake.

- E akuzuara M. Xh. para gjykatës ka dhënë deklaratë dhe ka mohuar fajësinë me pretendim se ka qenë e trafikuar edhe kjo nga i akuzuari M. dhe ka qenë e kanosur. Numri

i saj i telefonit ka qenë i shfrytëzuar nga grupi M. E. dhe të tjerët. Nuk e mohon faktin se e dëmtuara është detyruar të kryej marrëdhënie sukale me persona të ndryshëm, mirëpo jo nga kjo dhe mohon të ketë siguruar klient. E njëjta në polici me datë 25.10.2021, si dhe në prokurori me datë 14.01.2022 nuk është deklaruar ka shfrytëzuar të drejtën e heshtjes, vetëm se ka deklaruar se nuk e ndjen vetën fajtoje.

Gjykata e vlerësoj mbrojtjen e të njëjtës dhe mbrojtjes së saj nuk ia fA. besimin meqë ishte në kundërshtim me provat e administruara. Deklarimi se edhe kjo ka qenë e trafikuar e bënë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, nga se e njëjta ka qenë e lirë të dal. Sikur e njëjta të ketë qenë e detyruar të kryej marrëdhënie seksuale me presona të tjerë ka pas mundësin e largimit



dhe të lajmërimet. Është fakt se edhe vetë e akuzuara M. ka kryer marrëdhënie seksuale me persona të ndryshëm gjë që u vërtetua në shqyrtim gjyqësor por e njëjta nuk ka qenë e detyruar por këtë e ka bërë me vullnetin e saj. Kjo vërtetohet e nga dëshmia e dëshmitarit B. ku M. kishte marrë të hollat prej 200 euro dhe nuk kishte kryer marrëdhënie seksuale, nga se kishin kërkuar në grup dhe nuk kishin pranuar të kenë marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën nga se u dukej e re. Nga kjo kuptohet se e njëjta nuk ka mundur të detyrohet të ketë marrëdhënie dhe se kishte shkuar të akuzuarit I. dhe M. dhe të njëjtit ishin dal dhe ishin konfrontuar me dëshmitarin dhe të pastaj ishin larguar. Se e njëjtat kryerjen e marrëdhënieve seksuale me pagesë e bënte vullnetarisht e vërteton edhe fakti se e njëjta ka disa raste ku është dënuar për kundërvajtje për shkak se në vende të ndryshme është hasur me persona të ndryshëm ku për shërbimin seksual kishte marrë pagesë, këto vendime janë pjesë e shkresave të lëndës si dhe ka dhe raste të tjera dhe kontaktet me persona të ndryshëm i kishte reA.zuar vetë.

-I akuzuari I.M. si para gjykatës ashtu edhe në deklaratat e dhëna në polici me datë 25.10.2021, si dhe në prokurori me datë 12.02.2022 e ka mohuar fajësinë. I njëjti nuk pranon se e ka trafikuar të dëmtuarën dhe nuk e pranon as veprën penale të përdorimit të armës. I njëjti në deklaratat e tij bie në kundërshtim me vetë vetën dhe provat e tjera të administruara në shqyrtim gjyqësorë.

I akuzuari I. nuk e mohon se ka qëndruar në vila G.-, mirëpo pretendon se aty ka qëndruar vetëm kur ka shkuar për të pushuar, pasi që është kthyer nga mA. ki ka pre dru, ka qëndruar me E., ndërsa për K. mohon ta ketë detyruar të ketë marrëdhënie seksuale me të, përveç që se si e ka pru i akuzuari J. me babin e saj, në rrugë ku e kishte lënë nafti afër pompës A. G., dhe përshkrimet se si kanë dashur ta dërgojnë në shtëpi por ajo nuk ka pranuar dhe e kanë kthyer e ka lënë në vila me të akuzuarin M. ndërsa vetë ka vazhduar e ka dërguar J.n për në shtëpinë e vetë. Por gjykata e ka vlerësuar se mbrotja e të akuzuarit I.ë është tërësisht e pa bazuar. Nga se nga deklarata e të dëmtuarës u vërtetua e kundërta, meqë e dëmtuara deklaroi se parat për shërbimet seksuale ia ka dhënë të akuzuarit M. dhe I. dhe së të njëjtit e kishin kërcënuar. Madje edhe vetë i akuzuari I. kishte kryer marrëdhënie seksuale me të. Po ashtu edhe pretendimi se nuk ka qendura në vila vetëm kur ka shkuar për të pushuar nuk qëndron nga se u vërtetua se me rastin e shkuarjes së dëshmitarit B.T. në vila i akuzuari kishte qenë aty dhe ishin konfliktuar me të, pasi kishin paguar 200 euro për shërbimet seksuale edhe nuk kishin kryer shërbimet seksuale, të hollat nuk u ishin kthyer. E këtë fakt i akuzuari I. e quanë rastësi. Pastaj me rastin e shkuarjes së policisë dhe kontrollimit të vilave me dt.25.10.2021 në ora rrethe orës 14:10 i akuzuari I. kishte qenë aty dhe ishte duke fjetur në vilen nr.7.

I akuzuari I. është në kundërtënie me deklaratën e te akuzuarit J.A.te dhënë në gjykatë ku J. ka deklaruar : “po kam pyetur I.n për K. kur e kam pa në

katund dhe i njëjti i ka thënë se mirë është”, po ashtu edhe në polici me datë 26.10.2021 i akuzuari J. ka deklaruar se me I. kam fol me e vet se a është mirë ajo vajza dhe a ka shku në shtëpi apo ku ishte, ku I. me tha se këtu është dhe mirë është dhe kaq”, gjersa i akuzuari I. në gjykatë me datë 08.06.2023 ka deklaruar se: “jo”, gjersa në prokurori e ka deklaruar te kundërtën: “po është e vërtetë që me ka thirr” (J.). Pra kjo vërteton se i akuzuari I. qëndronte në vila dhe dinte për K.. I akuzuari I. është në kundërtënie me deklaratën e te akuzuarit M.I.te dhënë në gjykatë lidhur me atë se a kanë shkuar në male së bashku i njëjti është është përgjigjur: “ndonjëherë kam shkuar me I.n dhe ndonjëherë kam shkuar edhe vetëm”, gjersa i akuzuari I. në gjykatë duke u përgjigjur në pyetjen se a keni shkuar ndonjëherë në mal me M.?”, i njëjti ka deklaruar: “jo kurrë, veç unë kam shkuar në mal”.

I akuzuari lidhur me veprën penale të përdorimit të armës, ku i njëjti para gjykatë nuk e mohon faktin se ka përdorur armën në male, mirëpo e mohon se ka përdorur te vilat. Mirëpo nga provat e administruara raportet policore për vendin e ngjarës, fotografitë mbi dëshmitë e gjetura, vërtetohet se gëzhojat janë gjetur në oborrin e vilave e jo siç pretendon i akuzuari.

Marrë parasysh kundërthëniet e cekura dhe faktet e vërtetuara nga provat e administruara gjykata mbrojtën e të akuzuarit I.M. në tërësi nuk e mori për bazë meqë ishte në tërësi në kundërshtim me provat tjera të administruara, po ashtu edhe me deklaratat e të akuzuarve të tjerë.

-E akuzuara E.Z. me rastin e dhënies së deklaratës në prokurori me datë 13.02. 2022 ka shfrytëzuar të drejtën e heshtjes, para gjykatë dhe polici me datë 25.10.2021 është deklaruar

dhe e ka mohuar fajësinë. E njëjta ka kundërthënë me vetë deklaratat e saj dhe të akuzuarve të tjerë. Në polici e njëjta kishte deklaruar se K. e kishte takuar për herë të parë në D., ndërsa para gjykatës thotë se J. e ka prurë K. nuk thot se ku dhe e njëjta fare nuk përmend se J. ishte me babain e tij siç pretendon i akuzuari I. E njëjta pretendon se K. kur kanë dashur ta dërgojnë në MA.shev nuk ka dashur të shkoj ka thënë se do me ndej me J.n. Ndërsa në shqyrtim thotë se K. ka thënë se du me nejt me ju. E njëjta bie në kundërshtim me të akuzuarin I. rreth asaj se sa kohë më parë ishin n lidhje , ku e akuzuara thekson se njiheshin që 4 muaj ndërsa i akuzuari I. thotë që 2 muaj. E akuzuara E. mohon të ketë pas telefon dhe të ketë përdorur telefonin me numër të M. që ishte në vila e nëpërmjet të tij të siguronte klient. Mirëpo nga deklarata e të dëmtuarës u vërtetua e kundërta, e po ashtu edhe nga vetë e akuzuara M. u theksua se telefoni ishte përdorur nga të gjithë grupi.

Marrë parasysh kundërthëniet e cekura dhe faktet e vërtetuara nga provat e administruara gjykata mbrojtjes së të akuzuarës E.Z. vlerësoj se nuk duhet falë besimin andaj edhe nuk e mori për bazë me rastin e vendosjes së kësaj çështje.

-I akuzuari M.I.në deklaratë e dhënë para gjykatës, në polici me datë 25.10.2021 si dhe në prokurori me datë 12.02.2022 nuk e mohon që ka qëndruar tek vilat G. A dhe që i njeh te pandehurin I. dhe J., është rrit me ta si dhe përafërsisht qe 3 vjet i njeh edhe te pandehurën M.Xh. dhe E.Z.” po ashtu ka pohuar se ka marrë një vilë për 24h si dhe në raste edhe një vilë tjetër për E., ka pohuar se në këto vila ka qëndruar edhe e pandehura M., gjersa e mohon ta ketë detyruar K. që të ketë marrëdhënie seksuale me persona të ndryshëm e po ashtu mohon ta ketë kërcënuar. Mohon qe ka zbritur me K. tek vilat “G. .” ashtu siç ka deklaruar i akuzuari I. e akuzuara E. dhe i akuzuari J..

Ndërsa sa i përket dërgimit te të njëjtës në M.me taxi “L.” e pohon si te vërtetë, mirëpo kjo ka qenë me kërkesë te I., gjë që i akuzuari I. e ka mohuar një gjë të tillë.

Në deklaratën e tij në gjykatë dhe në prokurori mohon të ketë pas kontakt me B. duke theksuar se i njëjti ka biseduar i njëjtin me M., e ka pa tek vilat por me të ka biseduar vetëm shoqnisht. Pra i njëjti e mohon konfliktin me dëshmitarin B.T. gjë që është në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit B.T., te akuzuarit I.M., te akuzuarës M.Xh., te akuzuarës E.Z.. I akuzuari M. është kundërthënës me deklaratat e tij të dhëna para gjykatës në prokurori dhe në polici edhe sa i përket arsyes së dërgimit të K. në M.në vilat T.. Para gjykatës dhe në prokurori thekson se e ka dërguar “me kërkesën e I.” i cili i kishte thanë se nuk është mirë dhe a po e dërgon në M., ndërsa në polici thekson se e kam “pa se është e budallme dhe e kam dërguar në M.”.

Marrë parasysh kundërthëniet e shumta në deklaratat e të akuzuarve dhe marrë parasysh faktet e vërtetuara nga provat e administruara, gjykata mbrojtjes së të akuzuarit M.I.nuk ia fA. besimin dhe nuk e mori për bazë me rastin e vlerësimit të kësaj çështje.

-I akuzuari J.A.ka dhënë deklaratë para gjykatës në polici me datë 26.10.2021, si dhe në prokurori me datë 13.02.2020. I njëjti thekson para gjykatës se arsyeja e takimit me K. ka qenë me dal me u njoftu, dhe se dëshmitari A. ka qenë me te për ta shoqëruar. Lidhur me këtë rrethanë ku dëshmitari A. ka kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuari i akuzuari J. bie në kundërshtim me vetë vetën dhe deklaratën e të dëshmitarit A. dhe të dëmtuarës. I njëjti para gjykatës ka theksuar *...se kanë shkuar në vilë bashkë me K. dhe A. kanë pushuar 5 minuta apo 10 A. ka dal në garazh dhe ky ka kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën dhe pastaj e ka thirr A. me hy brenda për mos me lan vetëm, ka hy A. dhe ai ka kryer marrëdhënie seksuale me të... . Pastaj në polici thekson.... se unë me K. dhe A. kemi hy në të njëjtën dhomë dhe kemi kryer marrëdhënie seksuale të dytë me të....* ndërsa dëshmitari A. ka deklaruar se *... ka hi J. ka kryer marrëdhënie seksuale me të dhe pastaj kam fol me J.n edhe unë me kry marrëdhënie seksuale me të dhe i kam thënë kurgja me zor, J. ka thënë qe po foli me të, dhe ky ka hy ka fol me të dhe ka kry marrëdhënies seksuale... ndërsa J. ka qëndruar jashtë....ndërsa në polici dëshmitari ka deklaruar se që të tretë kanë hy në dhomë dhe kanë kryer marrëdhënie seksuale.(Shtrohet pyetja si ka dal me u njoftu me një vajzë shkon në hotel kryen marrëdhënie me të lejon personin që e shoqëronte dhe ai kryen marrëdhënie seksuale me të?)*

I akuzuari J. nuk e mohon se e ka thirr I. për me ardh me marrë K. por pretendon se ka qen me qëllim me dërgu në M.dhe janë kthyer pasi K. kinse nuk kishte dashur të shkonte dhe janë ndal në R. ku edhe e kanë lënë K. me M.,” i njëjti po ashtu ka pohuar numri i tij ka qenë *.../...-....*, si dhe ka pasur te instaluara rrjetet sociale si *snap, whatsapp*. Por, mohon të ketë shkruar mëzash duke pretenduar se K. nuk ka dashur të shkoj në shtëpi. Deklarimi i tij është në kundërthënie me provat e administruara siç janë deklaratat e të dëmtuarës dhe po ashtu edhe mesazhi që është siguruar nga ekzaminimi i telefonave i datës 01.07.2022, ku thekson “merreni majeni ndonjë ditë boneni ndoj pare dhe qojeni në M.vërteton të kundërtën e pretendimeve të tij. Këtë e konfirmon edhe e akuzuara M. ku thekson se J. ka qenë të Vilat G. . kur e kanë sjell K. dhe ka thënë “boni qaka të doni me të”. I akuzuari J. para gjykatës deklaroi se nuk i ka njohur te akuzuarat M. dhe E. ndërsa të njëjtat deklaruan se i kanë njohur të akuzuarin J..

Prandaj, marrë parasysh të gjitha kundërthëniet e lartcekura dhe faktet e vërtetuara nga provat e administruara gjykata mbrojtës së të akuzuarit J.A.nuk ia fA. besimin meqë ishte në kundërthënie me provat e administruara.

Gjykata vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit M.I.të dhëna në shqyrtim gjyqësor lidhur ekzaminimin e telefonave dhe nxjerrjes së bisedave, dhe ka vërtetuar se të njëjtat janë të pa bazuara. Pasi që ekzaminimi i telefonave ishte bërë me urdhër të gjyqtarit të procedurës parapake UGJK.nr. 164/21 dt.02.11.2021 me të cilën ishte urdhëruar ekzaminimi i telefonave. E që konform nenit 113 të KPPRK-së nuk mundë të përdorën si dëshmi vetëm bisedat telefonike të personave-dëshmitarëve të cilët janë të liruara nga obligimi për të dëshmuar.

Bazuar në këto dhe kundërthënie të tjera, gjykata mbrojtën e të akuzuarve dhe pretendimet e mbrojtësve të tyre se nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që u vihen në

barrë, e vlerësoj të pabazuar dhe të bërë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale dhe nuk e mori për bazë me rastin e vendosjes së kësaj çështje.

### *Vlerësimi ligjor*

Gjykata duke analizuar dhe vlerësua të gjitha faktet e vërtetuara nga provat e administruara në raport me elementet e veprave penale që ju vihen në barrë të akuzuarve, ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve M.Xh., I.M., E.Z., M.I., J.A.janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz nga neni 165 par. 1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së të rikuA.fikuara si në fjalën pëfundimtare të prokurores. Meqë u vërtetua se e dëmtuara ishte mashtruar nga i akuzuari J. e kishte derguar tek të akuzuarit e tjerë, duke iu thënë “*merreni boneni ndoj pare dërgojeni në M.*”. Të akuzuarit e kishin strehuar të dëmtuarën tek vilat G. -. ku po qëndronin edhe vet dhe e kishin siguruar klient- persona të ndryshëm dhe e kishin detyruar të dëmtuarën të kryej marrëdhënie seksuale kudër dëshirës së saj. E njëjta ishte shfrytëzuar nga se të akuzuarit kishin përfituar nga shërbimet seksuale të saj, personat e ndryshëm kishin paguar për marrëdhëniet seksuale të kryera me të dëmtuarën prej 50-100 euro apo kur ishte në grup edhe deri në 200 euro. Të hollat e fituara janë përdorur për nevoja të akuzuarve. Nga provat e administruara u vërtetua se e dëmtuara K.G.nuk ishte e lirë të dal dhe ishte kanosur dhe rrahur kur nuk ka pranuar të ketë marrëdhënie seksuale. E njëjta për të arritur qëllimin për tu larguar nga aty e për të shkuar në shtëpi, kishte konsumuar 20 tableta qetësimi.

Në veprimet e të akuzuarve janë plotësuar edhe elementet e bashkëkryerjes të parapara nga neni 31 të KPRK-së nga se të njëjtit njiheshin në mes vete, secili kishte kryer veprimet e përshkruara si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi. Po ashtu u vërtetuan edhe elementet e veprës në vazhdimësi të parapara me nenin 77 të KPRK-së, nga se kemi të bëjmë me viktimën e njëjtë, kryerësit e njëjtë, vendi i njëjtë, shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore dhe dashja e njëjtë e kryesve dhe se vepra ishte kryer nga dt.12.10.2021 e gjerë me dt.16.10.2023 në vilat G.- . në f. R. K. P., ku gjatë kësaj periudhe në mënyrë të vazhdueshme e dëmtuara ishte detyruar të kryente marrëdhënie seksuale me persona të ndryshëm.

Nga provat e administruara u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit I.M. janë përmbushur edhe elementet e veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 167 par. 1 të KPRK-së. Edhe pse i njëjti pretendon se ka shtënë me armë në male e jo të vilat, në shqyrtim gjyqësor u vërtetua e kundërta sepse gëzhhojat nga arma e të akuzuarit I. ishin gjetur në oborr të vilave gjë që vërtetohet nga dëshmitë e cekura si më lartë. E në bazë të pranimit të fajësisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës u vërtetua se i akuzuari I.M. është fajtor edhe për veprën penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuari M.I.është fajtor edhe vepër penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjatë tërë procedurës penale nuk është paraqitur asnjë rrethanë e cila do të përjashtonte apo do të zvogëlonte përgjegjësinë penale të akuzuarve për çka nga gjykata konsiderohet se të njëjtit janë personA.sht përgjegjës.

### *Vendimi mbi dënimin*

Vendimi mbi llojin dhe lartësinë e dënimit u mor konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, me ç’rast gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat për dënimin.

-Për të akuzuarën M.Xh. si rrethana lehtësuese mori parasysh se është e pa martuar është nënë ka fëmijë-të vegjël që kujdest, për të akuzuarën E.Z. gjykata po ashtu si rrethanë lehtësuese e mori parasysh se është e divorcuar është nënë e tre fëmijëve që kujdeset. Nga rrethanat rënduese M.Xh. dhe E.Z. gjykata po ashtu si rrethanë rënduese e mori parasysh shkallën e lartë të dashjes. Të akuzuarat përveç që siguronin persona të ndryshëm për marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën, e akuzuara M. kishte venë në dispozicion numrin e saj të telefonit për të shërbyer për sigurimin e klientëve. Ndërsa e akuzuara E. përveç që siguronte klient e ruante të dëmtuarën që të mos ketë kontakt me persona të tjerë kur dilnin jashtë vilave.

-Për të akuzuarin M.I. nga rrethanat lehtësuese pranimin e fajësisë për veprë penale të armëmbajtjes dhe përdorimit të armës. Ndërsa nga rrethanat rënduese ka gjetur se më parë ka qenë i dënuar sipas aktgjykimeve: P.nr.43/2019 dt.20.05.2019 për veprë penale të sulmit nga neni 184 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, P.nr.46/2020 të dt.30.10.2020 për veprë penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së, P.nr.142/2019 të dt.13.11.2020 për veprë penale të vjedhjes së pyllit nga neni 349 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, PKR.nr.121/21 të dt.13.08.2021 për veprë penale mundësim apo detyrim në prostitucion nga neni 348 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, pastaj shkallën e lartë të dashjes dhe pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale të trafikimit, ngase ishte personi që i janë dorëzuar të hollat që kanë paguar personat e ndryshëm për marrëdhëniet seksuale me të dëmtuarën, pastaj ka kanosur dhe rrahur të dëmtuarën, pastaj faktin se përmes familjarve të tij bënë presion në të dëmtuarën dhe familjarët e saj me qëllim të ndërrimit të deklaratës.

Për të akuzuarit I.M. gjykata nga rrethanat lehtësuese pranimin e fajësisë për veprë penale të armëmbajtjes. Nga rrethanat rënduese mori parasysh se më parë ka qenë i dënuar me aktgjykim PKR.nr.185/21 të dt.11.10.2022 për vepra penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së dhe Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, me aktgjykim P.nr.209/2021 dt.28.01.2023 për veprë penale posedim i paautorizuar të narkotikëve substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, pastaj shkalla e lartë e dashjes dhe e pjesëmarrjes dhe bashkë me të akuzuarin M. kanë qenë personat që i janë dorëzuar të hollat për kryerjen e marrëdhënieve seksuale nga e dëmtuara, pastaj si rrethanë tjetër rënduese është fakti se edhe vetë i akuzuari I. kryer marrëdhënie seksuale me të, ku më pas e dëmtuara ka konsumuar 20 tableta leksilium, faktin se përmes familjarve ka bërë presion në të dëmtuarën dhe familjarët e saj me qëllim të ndërrimit të deklaratës.

Për të akuzuarin J.A.gjykata si rrethana lehtësuese nuk ka gjetë asgjë. Nga rrethanat rënduese ka gjetur se ka në zhvillim procedurën penale sipas aktakuzës PP/II.nr.2123/21 të dt.04.11.2021 për veprë penale posedim i paautorizuar i narkotikëve nga neni 269 par.2 të KPRK-së, pastaj shkallën e lartë të pjesëmarrjes ku i njëjti në një mënyrë ka shkel besimit nga e dëmtuara fakti se ka qenë personi i parë që ka ra në kontakt me të dëmtuarën duke e mashtruar me qëllim të takimit për njohje dhe më pas përveç që kryen marrëdhënie seksuale, ia vënë në dispozicion edhe dëshmitari A.M., pastaj e dërgon të dëmtuarën tek të akuzuarit e tjerë.

Bazuar në rrethanat lehtësuese për të akuzuarat M.Xh. dhe E.Z. gjykata ka përcaktuar dënimin nën minimumin e paraparë konform nenit 71 dhe 72 të KPPRK-së.

Me rastin e vlerësimit të këtyre rrethanave dhe matjes së dënimit të shqiptuar, gjykata ka përcaktuar dënimet e shqiptuara me bindjen se me këto dënime të shqiptuara do të arrihet qëllimin i ndëshkimit dhe i konsideron adekuate me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera e në përpjesëtim të drejt me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve.

Gjykata konsideron se do të ndikoi pozitivisht në ndërgjegjësimin e tyre në të ardhmen si në drejtimin e preventivës individuale dhe të asaj gjenerale, si qëllim i këtij dënimi në kuptim të dispozitës së nenit 38 të KPK-së.

*Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit dhe masës së arrestit shtëpiak*

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit dhe masës së arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar u mor konform nenit 79 të KPPRK-së.

Të akuzuarit *I.M.*, *M.I.* dhe *J.A.* janë nën masën e paraburgimit sipas aktvendimit mbi caktimin e paraburgimit DKR.PP.nr.186/21 të dt.27.10.2021 dhe aktvendimet mbi vazhdimin e paraburgimit. E që për të akuzuarit *I.M.* dhe *M.I.* llogaritet nga dt.25.10.2021 do të thotë data e ndA.mit e tyre e tutje. Për të akuzuarin *J.A.* llogaritet nga dt.26.10.2021 kur edhe i njëjti është ndaluar e tutje.

E akuzuara *M.Xh.* ka qëndruar në arrest shtëpiak DKR.PP.nr.186/21 të dt.27.10.2021 që llogaritet nga dt.25.10.2021 e gjer me dt.15.07.2022 kur edhe i është ndërprera masa e arrestit shtëpiak me aktvendim PKR.nr.47/22 të dt.15.07.2022. Pastaj ka qëndruar nën masën e paraburgimit sipas aktvendimit PKR.nr.47/22 të dt.01.02.2023 ku dhe i është vazhduar dhe ka qëndruar në masën e paraburgimit gjer me dt.28.04.2023, pastaj i është ndërprerë masa e paraburgimit dhe i caktuar masa e arrestit shtëpiak me aktvendim PKR.nr.47/22 dt.28.04.2023 dhe i është vazhduar masa e arrestit shtëpiak me aktvendim PKR.nr.47/22 dt.27.05.2023 ashtu që masa e arrestit ka zgjatë gjerë me dt.27.06.2023 dhe ka përfunduar me skadim të masës pa marr ndonjë aktvendim.

E akuzuara *E.Z.* ka qëndruar në masën e paraburgimit sipas aktvendimit mbi caktimin e paraburgimit DKR.PP.nr.186/21 të dt.27.10.2021 që i llogaritet nga data e ndA.mit të saj 25.10.2021 e gjerë me dt.23.11.2021 kur dhe i është ndërprerë masa e paraburgimit dhe i është zëvendësuar me masën e arrestit shtëpiak me aktvendim DKR.PP.nr.186/21 dt.23.11.2021. Masa e arrestit shtëpiak ka zgjatur deri sa i është ndërprerë me aktvendim PKR.nr.47/22 dt.15.07.2022.

*Vendimi mbi konfiskimin*

Vendimi mbi konfiskimin për të akuzuarit *I.M.* dhe *M.I.* si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u mor konform nenit 366 par. 3 të KPPRK-së.

*Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike*

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontest civil gjykata e mori konform nenit 462 të KPPRK-së, meqë gjykata nuk pati kërkesë të precizuar nga e dëmtuara apo mbrojtësja e viktimave në shqyrtim gjyqësorë.

*Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës*

Vendimi mbi shpenzimet e gjyqësore dhe paushallin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u mor konform nenit 450 të KPPR të Kosovës.

*Vendimi për kompensimin e viktimave*

Vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit u mor konform nenit 39 par.1,2,3 nen par.3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

*Vendimi mbi vazhdimin e paraburgimit*

Vendimi mbi vazhdimin e paraburgimit me rastin e shpalljes së aktgjykimit për të akuzuarit I.M., M.I.dhe J.A.është marrë konform nenit 366 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së dhe arsyet për vazhdimin e paraburgimit janë dhënë në aktvendim të veçantë PKR.nr.47/2022 të dt.24.07.2023.

Andaj nga sa u tha më lartë e në bazë të dispozitave të lartë cituara ligjore dhe konform nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE P. DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,  
2021:240246, 22.09.2023**

**Kryetarja e trupit gjykues**

---

Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.